



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë
“Master Profesional në Ekonomi” me dy profile
“Kontabilitet Financë “ dhe “Menaxhim Biznesi”.**
i
**Institucionit të Arsimit të Lartë
Kolegji Universitar “I Biznesit”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. PhD Klodian Muço
2. Dr. Rinald Muça

Dhjetor/2020

Për Programin e studimit: Master i Profesional në “Ekonomi me dy profile: "Kontabilitet Financë" dhe "Menaxhim Biznesi"”, ofruar nga
Kolegji Universitar “I Biznesit”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “I Biznesit”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Menaxhimit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Profesional në “Ekonomi me dy profile: "Kontabilitet Financë" dhe "Menaxhim Biznesi"”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 651, datë 14.09.2011
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Shkresë MASR Nr. 5473/1, datë 21.06.2019
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	UMASh Nr. 500 datë 18.10.2012
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit / 2 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	5 PAE / 3 PAK
18	Numri i studentëve:	17
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM TE PROGRAMIT

Përshkrim përmbledhës 200 - 400 fjalë

Kolegji Universitar i Biznesit, në zbatim të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit të programit Master Profesional në "Ekonomi" me profile: "Kontabilitet Financë" dhe "Menaxhim Biznesi", nëpërmjet shërbimit në AMS. Për këtë proces vlerësimi janë përzgjedhur si ekspertë të jashtëm: PhD. Klodian Muço dhe Dr. Rinaldo Muça të cilët, për realizimin e procesit të vlerësimit, u mbështetën në një seri dokumentash dhe kërkesash të ndryshme në lidhje me standartet dhe mënyrën e funksionimit të të gjithë strukturave të Kolegjit Universitar të Biznesit. Burim i rëndësishëm për vlerësimin e jashtëm shërbyen dokumentacionet e ndryshme të ngarkuara nga KUB në portalin e ASCAL, si dhe vizitat që u realizuan pranë KUB, takimet me drejtues të këtij institucioni si: shqyrtimi i dokumentacionit bazë mbi të cilën organizohet i gjithë programi i studimit, etj. Ekspertët e jashtëm, të asistuar edhe nga specialistja e ASCAL, znj. Juna Mengri, pasi shqyrtuan me vëmendje gjithë dokumentacionin e duke marrë në konsideratë takimet e ndryshme të bëra në KUB, arritën në konkluzionin se KUB nuk ka plotësuar plotësisht rekomandimet nga akreditimi i mëparshëm (vendimi i KA nr. 364, datë 17.09.2012 “për akreditimin e programit 90 ECTS në “Kontabilitet Financë” dhe “Menaxhim Biznesi”). KUB disponon një infrastrukturë të mirë materiale për të realizuar suksesshëm mësimdhënien dhe avancimin akademik në programin e aplikuar për akreditim. KUB ka një staf pedagogësh që në masën më të madhe e njohin mirë praktikën dhe janë profesionistë me eksperiencë, të nevojshme këto për një master profesional. KUB ka lidhje të mira me organizata dhe kompani publike e private për të stimuluar punëzënien e studentëve dhe rritur profesionalizmin e tyre përmes praktikave mësimore. Nga ana tjetër ekspertët e jashtëm kostatuan se KUB nuk bën studime të mirëfillta tregu për të kuptuar saktë pozicionin e tij dhe rrjedhimisht përgatitur e implementuar një vizion në linjë me kushtet aktuale dhe të pritshme. KUB nuk është transparent në planet e veta financiare për të mbështetur dhe përmirësuar programet e studimit. KUB përdor literaturë të vjetëruar në përgatitjen e studentëve për programin e aplikuar për akreditim. KUB nuk është i kujdesshëm në respektimin e kërkesave zyrtare për akreditim të këtij programi, specifikuat të hartimit me përgjegjësi dhe saktësi të dokumenteve të përditësuara dhe relevante. KUB ka një aktivitet të vakët sa i përket dimensionit kërkimor-shkencor si dhe KUB nuk i kushton shumë rëndësi syllabuseve. Nga analiza e dokumentacionit dhe takimet e bëra në institucion Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon: të bëhen studime tregu parësore (nga vetë institucioni) për të kuptuar konkurrencën, identifikuar avantazhet e disavantazhet dhe rritur shanset për sukses; të rritet transparenca e planeve financiare dhe të përcaktohen prioritetet për alokim fondesh, në përputhje me prioritetet akademike dhe ato administrative; të financohen me prioritet kërkimi shkencor, mësimdhënia nga pedagogët sipas ligjeve në fuqi dhe përditësimi i literaturës së detyrueshme dhe asaj të rekomanduar.

SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Ekspertët e jashtëm Dr. Klodian Muço dhe Dr. Rinald Muça, të asistuar edhe nga specialistja e ASCAL, znj. Juna Mengri, pasi shqyrtuan me vëmendje gjithë dokumentacionin e duke marrë në konsideratë takimet e ndryshme të bëra në KUB, arritën në konkluzionin se KUB nuk ka plotësuar plotësisht rekomandimet nga akreditimi i mëparshëm (vendimi i KA nr. 364, datë 17.09.2012 “për akreditimin e programit 90 ECTS në “Kontabilitet Financë” dhe “Menaxhim Biznesi”). Më konkretisht:

-në akreditimin është konstatuar se nevojiten studime më të argumentuara shkencore mbi nevojat e tregut të punës në të ardhmen e afërt në Shqipëri, gjë kjo që nuk është realizuar. Përsëri ekspertët e jashtëm konstatuan se KUB nuk bën studime të mirëfillta tregu për të kuptuar saktë pozicionin e tij dhe rrjedhimisht përgatitur e implementuar një vizion në linjë me kushtet aktuale dhe të pritshme.

-Në akreditimin e parë është konstatuar po ashtu probleme me dokumentimin më të mirë të auditimit të jashtëm financiar dhe raportimin në mënyrë më të detajuar të treguesve të efijencës së shfrytëzimit të fondeve, veçanërisht të përfituara nga tarifa e studentëve në këtë program. Të dyja këto konstatime janë evidentuar përsëri nga ekspertët e jashtëm. Ekspertët e jashtëm konstatuan përsëri po ashtu se KUB nuk është transparent në planet e veta financiare për të mbështetur dhe përmirësuar programet e studimi; KUB duket se nuk ka me prioritet kërkimi shkencor e si konsekuencë duket se nuk e financon mjaftueshëm atë.

-KUB nga ana tjetër ka bërë hapa para përse i përket marrdhënieve të bashkëpunimit me institucionet homologe jashtë vendit.

Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm; 200 fjalë

Grupi i vlerësimit të jashtëm, për realizimin e procesit të vlerësimit, u nis nga aneksi nr.9, i cili përmban Vendimin e KA nr. 364, datë 17.09.2012 “për akreditimin e programit 90 ECTS në “Kontabilitet Financë” dhe “Menaxhim Biznesi”, për të verifikuar nëse janë plotësuar rekomandimet sugjeruara nga akreditimi i mëparshëm. Në vijim konsultoi me rigorozitet të gjithë dokumentacionin e ngarkuar në portalin e ASCAL nga Kolegji Universitar i Biznesit, për të vazhduar me vizitat në institucion. Përgjatë vizitave u realizuan takime me drejtues të institucionit, me drejtues të departamenteve, grupin e vlerësimit të brendshëm, stafin pedagogjik, studentë, sekretarinë mësimore, administratën, arkivin, etj. Gjithashtu u bë një vizitë në mjediset mësimdhënëse të këtij institucioni, në bibliotekën e IAL, në sallën informatike, etj. Në verifikimin e të dhënave u përdor metoda e marrjes së mostrës, duke nxjerrë në mënyrë të rastësishme kampionët për verifikim. Kjo metodë u përdor në verifikimin e të dhënave lidhur me cilësinë e studentëve, procedurave të rregjistrimit të studentëve në sekretari, me dosjet e stafit akademik dhe me procesverbalet e provimeve. Gjithashtu gjykimi i grupit të punës u mbështet në intervistat e marra nga palët e ndryshme të interesit.

Më datë 27.10. 2020, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 57/16 Prot., datë 27.10.2020, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, më datë 03.11.2020, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 435/1 Prot., datë 03.11.2020, përcjell komentet mbi Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. GVJ, pasi shqyrtoi me seriozitet komentet e IAL, shprehet si vijon:

Ne shkallen e permbushjes se rekomandimeve nga akreditimi Pare, ne DVRJ faqe 3, shkruhet "Ekspertet e jashtem pasi shqyrtoan me vemendje gjithe dokumentacionin e duke marre ne konsiderate takimet e ndryshme te bera ne KUB, arriten ne konkluzionin se KUB nuk ka plotesuar plotesisht rekomandimet nga akreditimi i meparshem (vendimi i KA nr. 364, date 17.09.2012 "per akreditimin e programit 90 ECTS ne "Kontabilitet Finance" dhe "MenaxhimBiznesi"). - Lidhur me kete pike kemi nje objeksion per pasaktesi pasi ne RVB ne faqen 6-8 kemi pershkruar me detaje permbushjen e rekomandimeve te shprehur nga akreditimi i pare ne VKA 364/2012, ku nder te tjera theksohen ne menyre te detajuar permbushja e pikes a) lidhur me infrastrukturen e permiresuar ne aspektin e madhesis (nga nje godine ne 2012, ne dy godina tani) ne aspektin e cilesise se infrastruktures ne funksion te mesimdhënies oder vite, per stafrn, studentet, bibliotekat, labororet etj; permbushja e pikes b). dhe c). lidhur me rritjen e punes 1 2 shkencore dhe botimeve nga stafi i angazhuar tashme KUB ndër vite (2012-2020) ku në RVB detajohen 10 konferenca shkencore të realizuara (5 kombëtare dhe 5 ndërkombëtare) si dhe botimin e dy numrave te Revistes shkencore KUB me ISSN përkatëse duke u përfshirë dhe angazhuar me risurse akademike në punën kërkimore shkencore në funksion të procesit mësimor si dhe në të mirë të ekonomisë së vendit. Gjithashtu, lidhur me këte nuk është marre në konsideratë shkresa e IAL KUB (Aneks nr.10 në RVB) mbi plotësimet e rekomandimeve të mëparshme. Lidhur me këtë ka një pasaktësi pasi në RVB janë vënë në dispozicion në tabelat përmbledhëse në aneks (Tab. Nr. 16 - Mjediset e IALP: "KOLEGJI UNIVERSITAR I BIZNESIT").

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pasi lexoi me vëmendje vendimin e KA nr. 364, datë 17.09.2012 “për akreditimin e programit 90 ECTS në “Kontabilitet Financë” dhe “Menaxhim Biznesi”. Arriti në konkluzionin se nuk janë përmbushur 100% rekomandimet e akreditimit të parë. Këtë gjë GVJ e bazon në faktin se edhe në akreditimin e parë është kostatuar se nevojiten studime më të argumentuara shkencore mbi nevojat e tregut të punës në të ardhmen e afërt në Shqipëri, gjë kjo që nuk është realizuar nga KUB. Përsëri GVJ kostatuan se KUB nuk bën studime të mirëfillta tregu për të kuptuar saktë pozicionin e tij dhe rrjedhimisht përgatitur e implementuar një vizion në linjë me kushtet aktuale dhe të pritshme. Pra KUB ka një analizë tregu por është e përgjithshme dhe jo në funksion të programeve studimore. Ky observacion nuk mund të merret në konsideratë, grupi i ekspertëve i qëndron vlerësimit në draft RVJ.

* * * * *

në faqen 3 të DVRJ shprehet se “nevojiten studime më të argumentuara shkencore mbi nevojat e tregut të punës në të ardhmen e afërt në Shqipëri, gjë kjo që nuk është realizuar”?! Lidhur me këtë ka një pasaktësi pasi në anekset e RVB (aneksi nr.19 faqe 85) është depozituar dhe studimi i tregut për Programin MPTHE në MB dhe KF.

GVJ afirmon se studimi i tregut është i përgjithshëm dhe jo në funksion të programeve të studimit nuk deklaron apsolutisht që mungon. Ky observacion nuk mund të merret në konsideratë, , grupi i ekspertëve i qëndron vlerësimit në draft RVJ.

* * * * *

Standardi I.3 – Programet e studimit “Master profesional” synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij. - Kriteri 2. (fq.8) – GVJ shprehet se “Megjithatë nisur nga analiza e tregut të punës (aneksi 19) vërehet se ajo është e përgjithshme dhe nuk ka informacion mbi profesionet më të kërkuara apo mbi profilet që aktualisht nuk gjejnë dot punë. Po ashtu duke ju referuar (aneksit 19) vërehet se kjo analizë tregu është bërë në muajin Maj 2020 pra mbas hapjes së programit të studimit. Kjo analizë tregu më tepër se njohuri se çfarë ka pas nevojë tregu në të kaluarën mund të japi se çfarë 3 nevoje ka tregu sot. Pra nuk ka pasur një bazë informacioni se si ka qënë tregu i punës në momentin e hapjes së programit”. Në këtë rast theksojmë se analiza e tregut të punës pavaresisht nga data (Maj 2020) është fryt i studimesh ndër vite që nga

akreditimi i parë i këtij program. Ndër të tjera, riorganizimi i këtyre programeve është bërë në përputhje me ndryshimet e kërkuara në LAL 2015 dhe në vijim riorganizimit të masterave profesional në 60/120 ECTS.

Analiza e tregut ngelet e përgjithshme dhe është e bazuar pjesërisht në studime të bëra nga ndërmarrje private që nuk kanë lidhje me KUB. Ky observacion nuk mund të merret në konsideratë, grupi i ekspertëve i qëndron vlerësimit në draft RVJ.

* * * * *

Kriteri 3. (fq.8) - GVJ shprehet se “Objektivi kryesor i programit të ciklit të dytë të studimit Master profesional i Thelluar në Ekonomi, profili “Menaxhim Biznesi” (aneksi 16 neni 3) është t’u japë

studentëve njohuri të thella ligjore, profesionale dhe kulturore në fushat e veprimatise së Shërbimeve Inteligjente dhe atyre Policore në Sistemet demokratike. Ky master synon dhënien e një tërësie njohurish rreth mjeteve dhe metodave bashkëkohore që përdorin ekonomistët dhe biznesit”. Në këtë rast theksojmë se nga vizita e Gvj në institucion kemi pranuar një lapsus nga ana jonë sa i takon Rregullores së Programit referuar në aneks 16 neni 3, dhe për këtë është pranuar nga GVJ duke vijuar nga ana jonë rregullimi dhe rishikimi i menjëhershëm i nenit në fjalë gjë që mund t’jua vëmë ne dispozicion menjëherë bashëngjitur kësaj shkrese. - Konstatojme se vlerësimi i GVJ i shkallës së përmbushjes “KRYESISHT” të standardi I.3 duke vlerësuar pozitivisht 6 nga 8 kriteret dhe ndërkohë sqarimit të “mospërmbushjes” së dy kriterëve në fjalë, është i pasaktë dhe jokohorent në këndvështrimin e në vlerësimi të balancuar. Eshte e nevojshme te ndryshohet vleresimi.

Ky koment pranon gjetjet e ekspertëve dhe nuk ngre ndonjë objeksion për vërtetësinë e vlerësimit të tyre. Rrjedhimisht nuk ka lëndë për t’u marrë në konsideratë.

GVJ kishte për detyrë të bënte vlerësimin RVJ, mbështetur në dokumentet e vëna në dispozicion dhe nuk e gjykoj si lapsus një afirmim të tillë “t’u japë studentëve njohuri të thella ligjore, profesionale dhe kulturore në fushat e veprimatise së Shërbimeve Inteligjente dhe atyre Policore në Sistemet demokratike”. GVJ gjykoj që të vlerësonte standartin I.3 “Kryesisht” për arsye të mungesës së analizës së tregut specifike dhe për për objektivin kryesor që ka ky program i ciklit të dytë studimor. Grupi i ekspertëve i qëndron vlerësimit në draft RVJ për këtë kriter.

* * * * *

Standardi I.4 - Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion. Kriteri 1 (fq.10) GVJ shprehet se “referuar aneksit 20 mbi syllabuset dhe të dhënave të KUB mbi stafin e brendshëm dhe të jashtëm [GVJ arriti në këtë konkluzion pasi pa se sa lëndë mbuloheshin nga lektorë të jashtë dhe sa nga lektorë të brendshëm. GVJ gjykon se përlllogaritjet e orëve janë bërë gabim pasi 60 kredite formative janë vetëm 420 orë frontale.](http://kub.edu.al/stafi-akademik/duke_analizuar_Syllabuset_e_programeve_të_studimit_“Menaxhim_Biznesi”_rezulton_se_62%_e_lëndëve_mbulohen nga lektorë të jashtëm dhe vetëm 38 % nga lektorë të brendshëm e njëjta gjë ndodh edhe me drejtimin “Kontabilitet-Financë” 62 % e programit mbulohet nga lektorë të jashtëm dhe 38% nga lektorë të brendshëm”. Për këtë konstatojmë një pasaktësi pasi GVJ i është referuar vetëm planit mësimor (aneks 20) në vlerë nominale duke mos marrë parasysh orët e realizimit të praktikës mësimore (60 orë) realizuar nga staf i brendshëm por dhe orëve të mbrotjes së diplomës (330 orë) realizuar nga staf i brendshëm dhe vlerësimin në mënyrë të kryqëzuar të informacionit në tabelat përmbledhëse në raport (Tabela nr. 4 – ngarkesa e personelit akademik / Tabela nr.12- Plani mësimor lidhur me personelin akademik). Duke rillogaritur saktë dhe në mënyrë të kryqëzuar këtë të dhëna të vëna në dispozicion rezulton se raporti PAE/PAK në mbulimin e programit nuk është 38%/62% por saktësisht raporti PAE/PAK është 63%/37% (PAE orë total = 390+60+330 = 780 orë nga 1230 orë total të programit. 780/1230=63 %).</i></p></div><div data-bbox=)

* * * * *

- Në vlerësimin final të GVJ kontestojmë me argumentet si më sipër shkallën e përmbushjes “Kryesisht” të dhënë nga GVJ për Fushën I - “OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT”. Pasi

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

7

nga 5 standarde që ka kjo fushë janë vlerësuar plotësisht 3 prej tyre, ndërkohë që vetëm 3 kritere (për të cilat kemi kontestime pasaktësisë si më sipër) penalizojnë përmbushjen e 26 kritereve në total që përmban kjo fushë në vlerësim. Mbështetur në objeksionet dhe komentet tona është e nevojshme të ndryshohet vlerësimi për këtë fushë.

GVJ e vlerëson si deficiet të madh që në syllabuse të përdoret literaturë tjetër për tjetër, që argumentat e trajtuar të mos jenë në koherencë me objektivin e modulit/disiplinës (nga verifikimi i matërialeve të dorëzuar në portalin e Ascal nga IAL KUB rezultoi se të paktën 2 module/disiplina kishin probleme të rënda në këtë aspekt prandaj GVJ gjykoj që fushën I ta vlerësonte “Kryesisht”. Për këtë arsye grupi i ekspertëve i qëndron vlerësimit në draft RVJ për këtë kriter.

* * * * *

II. Lidhur vlerësimet e GVJ rreth fushës së dytë “ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL”, bëjmë disa konstatime dhe objeksione sipas kritereve dhe vlerësimit të përmbushjes së tyre si më poshtë: Standardi II.2 – Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi. Kriteri 3 (fq.16) – GVJ përsëri shprehet se “Gjithashtu rezultoi se 62% e lëndëve mbulohen nga lektorë të jashtëm dhe vetëm 38 % nga lektorë të brendshëm e njëjta gjë ndodh edhe me drejtimin “Kontabilitet-Financë” 62 % e programit mbulohet nga lektorë të jashtëm dhe 38% nga lektorë të brendshëm”. Konstatojmë se ky vlerësim i GVJ është I pasaktë në mënyrë të përsëritur!! (Shiko sqarimin që kemi bërë për observacionin e kriterit 1 fq. 10) - Konstatojmë se ky vlerësim i GVJ është I pasaktë në mënyrë të përsëritur!! (Shiko sqarimin i shkallës së përmbushjes “KRYESISHT” të standardi II., duke vlerësuar pozitivisht 6 nga 7 kriteret dhe ndërkohë sqarimit të pasaktësisë së vlerësimit së njërit prej kritereve, është i pasaktë dhe jokohorent në këndvështrimin e një vlerësimi të balancuar. Mbështetur në objeksionet dhe komentet tona është e nevojshme të ndryshohet vlerësimi

Vlerësimi “Kryesisht” për standartin II është i bazuar dhe mbështetur arsyeshëm në dokumentet e konsultuara, faktet e ofruara dhe analizat e kryera, rrjedhimisht vlerësimi për fushën nuk ndryshon.

* * * * *

Standardi II.3 – Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë. Kriteri 1 (fq.18) – Dhe pse në vlerësimin përfundimtar GVJ ka vlerësuar përmbushet “Plotësisht” këtë standard, në përmbajtjen e këtij kriteri GVJ shprehet “GVJ kostatoi gjithashtu nga materialet e dorëzuar nga IAL KUB (Syllabusi i MB, fq.32-36) se lënda qeverisje korporatash kishte si literaturë kryesore të njëjtën gjë që kishte edhe lënda kontabilitet kosto drejtimi. Lënda taksim i avancuar (fq. 38-42) ka si literaturë bazë atë të lëndës taksim bazë po ashtu edhe temat janë të taksimit bazë). Për këtë problematikë takimin me përgj. e departamenteve GVJ u njoh me një gabim lidhur me ngarkimin e matërialeve në version të skanuar duke pranuar dhe konstatuar më pas që syllabusi Qeverisje Koorporatash nuk kishte probleme literature. Ndërsa për lëndën Taksim i Avancuar GVJ i është referuar literaturës dytësore që normalisht mund të ketë në përmbajtje dhe tekste të taksimit normativ. Nga takimi me stafin GVJ u sqarua në mënyrë të drejtpërdrejtë me pedagogun e lëndës si autor full time në FE kub i dy teksteve mësimore bazë lidhur me literaturën e Taksimit Normativ në nivel Bachelor dhe atij pozitiv në nivel master.

Ky koment pranon gjetjet e ekspertëve dhe nuk ngre ndonjë objeksion për vërtetësinë e vlerësimit të tyre. Rrjedhimisht nuk ka lëndë për t'u marrë në konsideratë.

Syllabuset janë përgjegjësi e lektorit titullar të lëndës, në vijim ato pranohen nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe aprovohen nga ai i njësisë kryesore. GVJ nuk e gjykon thjeshtë një lapsus që syllabuset të kenë probleme të tilla edhe pse kalojnë në disa filtra.

* * * * *

Standardi II.4 – Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës. 5 Kriteri 6 (fq.21) – GVJ shprehet “nga vëzhgimi i syllabuse kostatoi se literatura e përdorur është shumë e vjetër në disa lëndë. Kostatoi po ashtu se në programin e studimit në Ekonomi profili menaxhim biznesi kishte lëndë të ndryshme që përdorin literaturë të njëjtë (Kontabilitet Kosto-Drejtimi me Qeverisje Korporatash) apo lëndë që përdorin literaturë jo të përshtatshme për studime të thelluara (Lënda Taksimi i avancuar përdor literaturë të Lëndës Taksim)”. Konstatojme se ky vlerësim i GVJ është I pasaktë në mënyrë të përsëritur!! (Shiko sqarimin që kemi bërë për observacionin e kriterit 1 fq. 18) - Konstatojme se vlerësimi i GVJ i shkallës së përmbushjes “KRYESISHT” të standardi II.4 duke vlerësuar pozitivisht 8 nga 9 kriteret, nuk është proporcional me metodologjinë e vlerësimit (me 88 % të vlerësimit plotësisht) ndaj dhe i pasaktë dhe jokohorent në këndvështrimin e një vlerësimi të balancuar. Mbështetur në objeksionet dhe komentet tona është e nevojshme të ndryshohet vlerësimi.

GVJ nuk mendon se është i pasaktë, GVJ Ju referua syllabuseve të karikuara në portalin e Ascal se lënda qeverisje korporatash kishte si literaturë bazë të njëjtë me lëndën Kontabilitet, Kosto-Drejtimi, Lënda Taksim i avancuar kish si literaturë bazë atë të lëndës taksimi dhe në argumentat e trajtuara ishin koncepte bazë.

* * * * *

Standardi II.5 – Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit. - Konstatojme se vlerësimi i GVJ i shkallës së përmbushjes “KRYESISHT” të standardi II.5 duke vlerësuar pozitivisht 5 nga 5 kriteret, nuk është proporcional me metodologjinë e vlerësimit (me 100 % të vlerësimit plotësisht) ndaj dhe vlerësimi është krejtësisht i pasaktë dhe jokohorent në këndvështrimin e një vlerësimi të balancuar. Mbështetur në objeksionet dhe komentet tona është e nevojshme të ndryshohet vlerësimi. Në vlerësimin final të GVJ kontestojmë me argumentet si më sipër shkallën e përmbushjes “Kryesisht” të dhënë nga GVJ për Fushën II - “ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL”, pasi nga 6 standarde që ka kjo fushë janë vlerësuar nga GVJ si plotësisht 3 prej tyre, ndërkohë që vetëm 3 kritere (për të cilat kemi kontestime pasaktësisë si më sipër) penalizojnë përmbushjen e 39 kritereve në total që përmban kjo fushë në vlerësim. Mbështetur në objeksionet dhe komentet tona është e nevojshme të ndryshohet vlerësimi total për këtë fushë.

GVJ sugjeron të shihni komentet më lartë për syllabuset dhe temat e trajtuara në disa prej moduleve/disiplinave. GVJ gjykon me bindje të arsyeshme se niveli më i përshtatshëm i përmbushjes së këtij standardi nga KUB mund të jetë më pranë “Kryesisht”.

* * * * *

III. Lidhur vlerësimet e GVJ rreth fushës së tretë “MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT”, bëjmë disa konstatime dhe objeksione sipas kriterëve dhe vlerësimit të përmbushjes së tyre si më poshtë:

Standardi III.4 – “Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit”. Kriteri 4 (fq.30) – GVJ shprehet se: “nga analiza e CV të stafit akademik (aneksi 29) kontrolli i dosjeve në zyrën e burimeve njerëzore dhe nga lista e publikimeve kostatoi se stafi akademik i FE të KUB ka punuar shumë pak përse i përket kërkimit shkencor. Gjithë stafi kishte bërë shumë pak publikime në 4 vitet e fundit. Për këtë konstatojmë një pasaktësi pasi GVJ i është refruar vetëm kontrollit të zyra e burimeve njerëzore ndërkohë që KUB ka mbështetur aktivisht eventet shkencore sikundër organizimin e seminareve dhe simpoziumeve shkencore (të përmendura dhe të evidentuara më sipër 10 6 konferenca, 2 botime të Revistes Ndërkombëtare KUB) për të nxitur praninë e stafit të saj për nevojat e kualifikimeve periodike. Pjesa më e madhe e punës kërkimore të stafit akademik, referate, ligjërata, studime janë publikuar rregullisht në revistën shkencore të KUB, “Proceedings”, e cila disponon ISBN, si dhe janë mbështetur promocionet dhe promovimet e këtyre botimeve. Aktualisht promovimi i punimeve kërkimore-shkencore të stafit akademik të Institucionit realizohet edhe nëpërmjet profilit individual të cdo pedagogu në Google Scholar ëbsite. Të gjitha këto dokumentohen fizikisht në librarinë e KUB ose dhe në ëeb për të cilat jemi shprehur me referime dhe në RVB.

GVJ vlerëson në bazë të dokumentave të dorëzuar nga IAL KUB, megjithatë në një staf akademik të përbërë nga 21 veta 10 konferenca shkencore përsëri konsiderohen shumë pak. GVJ nuk ka arsye pse të kontrollojë Google Scholar.

* * * * *

Kriteri 5 (fq.30) - GVJ shprehet se: “nga inspektimi i dokumentacionit të karikuar nga IAL KUB në portalin e ASCAL, nga vizita në institucion, takimet me personelin akademik dhe administrativ nuk kostatoi se stafi ishte trajnuar për implementimin e metodave të reja në vitet e fundit”. Për këtë konstatojmë një vlerësim evaziv dhe aspak përcaktues lidhur me metodat e reja të viteve të fundit, pasi GVJ nuk i raporton se cilat janë dhe çfarë mungon nga ana jonë. Ndërkohë sic jemi shprehur në raport njësitë përgjegjëse të KUB kanë marrë pjesë sa here është kërkuar në trajnimet me ASCAL duke dhënë dhe kontribut në miratimin e Kodit të Ri të cilësise miratuar në 2018.

Nga varifikimi i dokumentacionit të karikuar në portalin e Ascal nga IAL KUB, GVJ nuk hasi ndonjë dokument që dëshmonte diçka ndryshe.

* * * * *

Kriteri 6 (fq.30) - GVJ shprehet se: “Siç u përmend më lartë GVJ nuk kostatoi se personeli akademik apo ai ndihmës akademik kish bërë trajnime në vitet e fundit për implementimin e metodave të reja.”. Për këtë përsëri konstatojmë një vlerësim evaziv dhe aspak përcaktues lidhur me metodat e reja të viteve të fundit, pasi GVJ nuk i raporton se cilat janë dhe çfarë mungon nga ana jonë.

Nga varifikimi i dokumentacionit të karikuar në portalin e Ascal nga IAL KUB, GVJ nuk hasi ndonjë dokument që dëshmonte diçka ndryshe.

* * * * *

Kriteri 7 (fq.31) - GVJ shprehet se: “GVJ përtej procesit të mësimdhënies online përgjatë pandemisë Covid-19 nuk kostatoi se testoheshin metoda të reja në mësimdhënie apo të analizoheshin efektet e pritshmërisë në raportimet peridodike”. Për këtë përsëri konstatojmë një vlerësim evaziv dhe të pasaktë ndërkohë që në periudhën e COVID – 19 KUB ka vepruar në mënyrë “smart” dhe të unifikuar në zhvillimin e mësimdhënies online përmes platformës google classroom/meeting unifikuar në portalin e KUB. Kjo procedure u konstatua për efikasitetin e saj dhe nga demonstrimi që ju bë në ambjentet tona GVJ për funksionimin e saj. Ndërkohe që dhe më herët në raport GVJ është shprehur pozitivisht për vlerësimin e kësaj praktike innovative në këtë periudhë pandemie. - Konstatojmë se vlerësimi i GVJ i shkallës së përmbushjes “KRYESISHT” të standardi III.4 duke vlerësuar pozitivisht 4 nga 4 kriteret, dhe ndërkohë sqarimit të pasaktësisë së vlerësimit të 4 prej kriterëve, është i pasaktë dhe jokohorent në këndvështrimin e një vlerësimi të balancuar. Mbështetur në objeksionet dhe komentet tona është e nevojshme të ndryshohet vlerësimi.

Ju lutem të rilexoni me vëmendje komentet e bërë në paragrafët e mëparshëm.

* * * * *

Kriteri 2 (fq.32) - GVJ shprehet se: “Për vlerësimin e këtij kriteri, GVJ iu referua rregulloreve të programeve të aplikuara për akreditim (aneksi 15 & 16), intervistave me pedagogët, studentët, si edhe tentoi të konsultojë aneksin mbi rregulloren e provimeve dhe atë mbi platformat online (anekset 35 & 36 të depozituara në ASCAL). Dokumentet shkresore të konsultuara i referoheshin anekseve 35 & 36, por këto dokumente mungonin në setin e dokumenteve të depozituara në ASCAL”.

Për këtë konstatojmë një pasaktësi dhe mosinformim nga ASCAL lidhur me dokumentacionin e ngarkuar, pasi anekset e cituara nr. 35 “Rregullorja për Procedurat e Provimeve” janë ngarkuar dhe referuar dhe në dokumentarin e dokumenteve mbështetëse të RVB në Aneksin F - Dosja Kryesore, e Akreditimit Institucional – KSLP. Po kështu dhe aneksi Nr. 36 - “Rregullore për procesin mesimor përmes platformes online COVID-19” janë ngarkuar dhe referuar dhe në dokumentar në Aneksin K - Dosja Covid-19, AI KSLP). Këto dokumente sipas këshillave në trajnimin mbi procesin e akreditimit me ekspertin e ASCAL, Znj. Renata Qatibi, për të mos ngarkuar në mënyrë të përsëritur dokumente janë ngarkuar dhe dërguar në dosjet e mëdha (Aneksi F dhe K) të cilat do të shërbenin dhe eksperteve të akreditimit pjesor Institucional dhe të KSLP të cilët përkuan në të njëjtën periudhë vizitash në KUB. Dokumentet të konsideruara nga GVJ si

mungesë jo vetëm janë depozituar dhe referuar dhe ne RVB por dhe ish-in të disponueshme dhe kur GVJ bëri vizitën në KUB dhe që mund të viheshin dispozicion nga ne në çdo kohë.

Grupi i ekspertëve të jashtëm kishte për detyrë të bënte vlerësimin RVJ, mbështetur në dokumentet e vëna në dispozicion. Nga dokumentet e vëna në dispozicion në bazën elektronike të ASCAL për ekspertët e jashtëm, këto dokumente ish-in ngarkuar vetëm si kopertinë, por jo si përmbajtje! Po kështu, edhe në faqen online të KUB, ku këto dokumente duhet të ish-in prezente, nuk u gjetën. Lidhur me vënien në dispozicion të këtyre dokumenteve gjatë vizitës në terren, grupi i ekspertëve thekson se në vizitën një-ditore të kryer në subjekt, nuk mund të konsultohen dokumente të tilla, nen për nen, direkt në subjekt. Grupi i ekspertëve i kërkoi stafit të KUB të korrigjonte lapsuset, gabimet dhe ringarkonte dokumentet e nevojshme për një vlerësim sa më të plotë dhe të suksesshëm, gjë që nuk u reflektua në platformën online të ASCAL dhe as përmes postës elektronike. Po kështu, në grupin e ekspertëve vlerësues ka qenë e pranishme edhe një përfaqësuese e ASCAL, e cila ka studiuar dhe bashkëpunuar në hartimin e draft RVJ-së. Përfaqësuesja e ASCAL konfirmon se dokumentet e sjella nga KUB në rrugë fizike, i përkasin akreditimit të një njësie kryesore dhe jo programit aktual për të cilën ish-in angazhuar ekspertët. Po kështu, në dosjen fizike nuk gjendet asnjë shënim që këto dokumente mund/duhet të përdoren, duke u vënë në dispozicion të ekspertëve për vlerësimin e këtij programi studimi.

Në këto kushte, kur: a) subjekti duhet të kishte reflektuar kërkesën e ekspertëve gjatë vizitës në terren, b) për transparencë duhet t'i ketë publike këto dokumente në faqen e tij në Internet dhe, c) ekspertëve nuk iu vunë në dispozicion dokumentet fizike të depozituara në ASCAL për një akreditim tjetër, ky observacion nuk mund të merret në konsideratë.

* * * * *

Kriteri 3 (fq.33) - GVJ shprehet se: “Për vlerësimin e këtij kriteri, grupi i ekspertëve tentoi t’i referohej rregullores për zhvillimin e provimeve (aneksi 35), e cila, sikurse u citua në kriterin më lart, nuk gjendet në dokumentacionin e ngarkuar nga institucioni në ASCAL”. Për këtë rikonstatojmë një pasaktësi dhe mosinformim nga ASCAL lidhur me dokumentacionin e ngarkuar, pasi aneksi i cituar nr. 35 “Rregullorja për Procedurat e Provimeve” është ngarkuar dhe referuar dhe në dokumentarin e dokumenteve mbështetëse të RVB në Aneksin F - Dosja Kryesore, e Akreditimit Institucional – KSLP. Këto dokumente sipas këshillave në trajnimin mbi procesin e akreditimit me ekspertin e ASCAL, Znj. Renata Qatibi për të mos ngarkuar në mënyrë të përsëritur dokumente janë ngarkuar dhe dërguar në dosjet e mëdha (Aneksi F) të cilat do të shërbenin dhe eksperteve të akreditimit pjesor Institucional dhe të KSLP të cilët përkuan në të njëjtën periudhë vizitash në KUB. Dokumentet të konsideruara nga GVJ si mungesë jo vetëm janë depozituar dhe referuar dhe ne RVB por dhe ish-in të disponueshme dhe kur GVJ bëri vizitën në KUB dhe që mund të viheshin dispozicion nga ne në çdo kohë.

Grupi i ekspertëve të jashtëm kishte për detyrë të bënte vlerësimin RVJ, mbështetur në dokumentet e vëna në dispozicion. Nga dokumentet e vëna në dispozicion në bazën elektronike të ASCAL për ekspertët e jashtëm, këto dokumente ish-in ngarkuar vetëm si kopertinë, por jo si përmbajtje! Po kështu, edhe në faqen online të KUB, ku këto dokumente duhet të ish-in prezente, nuk u gjetën. Lidhur me vënien në dispozicion të këtyre dokumenteve gjatë vizitës në terren, grupi i ekspertëve thekson se në vizitën një-ditore të kryer në subjekt, nuk mund të konsultohen dokumente të tilla, nen për nen, direkt në subjekt. Grupi i ekspertëve i kërkoi stafit të KUB të korrigjonte lapsuset, gabimet dhe ringarkonte dokumentet e nevojshme për një vlerësim sa më të plotë dhe të

suksesshëm, gjë që nuk u reflektua në platformën online të ASCAL dhe as përmes postës elektronike. Po kështu, në grupin e ekspertëve vlerësues ka qenë e pranishme edhe një përfaqësuese e ASCAL, e cila ka studiuar dhe bashkëpunuar në hartimin e draft RVJ-së. Përfaqësuesja e ASCAL konfirmon se dokumentet e sjella nga KUB në rrugë fizike, i përkasin akreditimit të një njësie kryesore dhe jo programit aktual për të cilën ishin angazhuar ekspertët. Po kështu, në dosjen fizike nuk gjendet asnjë shënim që këto dokumente mund/duhet të përdreshin, duke u vënë në dispozicion të ekspertëve për vlerësimin e këtij programi studimi.

Në këto kushte, kur: a) subjekti duhet të kishte reflektuar kërkesën e ekspertëve gjatë vizitës në terren, b) për transparencë duhet t'i ketë publike këto dokumente në faqen e tij në Internet dhe, c) ekspertëve nuk iu vunë në dispozicion dokumentet fizike të depozituara në ASCAL për një akreditim tjetër, ky observacion nuk mund të merret në konsideratë.

* * * * *

Kreteret 4, 5, 6, 8 (fq 33-34) – GVJ citon mungesën e rregullores së provimeve Aneksi nr. 35, të cilën sipas shpjegimeve të përsëritura e kemi vënë në dispozicion por dhe mund ta vinim në dispozicion gjatë vizitës së GVJ që nuk e trajtoi aspak si mungesë apo e kërkoi atë.

Sikurse theksuar më lart, subjekti kishte një tërësi lapsusesh, gabimesh dhe mungesash në dokumentacion. Ekspertët i kërkuan KUB të ndërmerre hapat e nevojshëm për t'i korrigjuar ato, në mënyrë që vlerësimi të ishte i plotë. Po kështu, në grupin e ekspertëve vlerësues ka qenë e pranishme edhe një përfaqësuese e ASCAL, e cila ka studiuar dhe bashkëpunuar në hartimin e draft RVJ-së. Përfaqësuesja e ASCAL konfirmon se dokumentet e sjella nga KUB në rrugë fizike, i përkasin akreditimit të një njësie kryesore dhe jo programit aktual për të cilën ishin angazhuar ekspertët. Po kështu, në dosjen fizike nuk gjendet asnjë shënim që këto dokumente mund/duhet të përdreshin, duke u vënë në dispozicion të ekspertëve për vlerësimin e këtij programi studimi.

Në këto kushte, kur: a) subjekti duhet të kishte reflektuar kërkesën e ekspertëve gjatë vizitës në terren, b) për transparencë duhet t'i ketë publike këto dokumente në faqen e tij në Internet dhe, c) ekspertëve nuk iu vunë në dispozicion dokumentet fizike të depozituara në ASCAL për një akreditim tjetër, ky observacion nuk mund të merret në konsideratë.

* * * * *

Konstatojme se vlerësimi i GVJ i shkallës së përmbushjes “PJESËRISHT” të standardi III.6 është krejtësisht I PASAKTË pasi nuk ka konsultuar dokumentacionin e ngarkuar sipas kështillimit dhe të ekspertëve të ASCAL.

Sikurse theksuar më lart, subjekti kishte një tërësi lapsusesh, gabimesh dhe mungesash në dokumentacion. Ekspertët i kërkuan KUB të ndërmerre hapat e nevojshëm për t'i korrigjuar ato, në mënyrë që vlerësimi të ishte i plotë. Po kështu, në grupin e ekspertëve vlerësues ka qenë e pranishme edhe një përfaqësuese e ASCAL, e cila ka studiuar dhe bashkëpunuar në hartimin e draft RVJ-së. Përfaqësuesja e ASCAL konfirmon se dokumentet e sjella nga KUB në rrugë fizike, i përkasin akreditimit të një njësie kryesore dhe jo programit aktual për të cilën ishin angazhuar ekspertët. Po kështu, në dosjen fizike nuk gjendet asnjë shënim që këto dokumente mund/duhet të përdreshin, duke u vënë në dispozicion të ekspertëve për vlerësimin e këtij programi studimi.

Në këto kushte, kur: a) subjekti duhet të kishte reflektuar kërkesën e ekspertëve gjatë vizitës në terren, b) për transparencë duhet t'i ketë publike këto dokumente në faqen e tij në Internet dhe, c) ekspertëve nuk iu vunë në dispozicion dokumentet fizike të depozituara në ASCAL për një akreditim tjetër, ky konstatim nuk mund të merret në konsideratë.

* * * * *

GVJ shprehet se “Nga sa më lart, referuar të dhënave të përmbajtura në aneksin 20, rezulton se programi i studimit realizohet përmes një literature që përdoret gjerësisht në nivelin Bachelor, ndërkohë që programi është i nivelit Master Profesional. Në mjaft raste, dokumentet e ngarkuara në ASCAL mbartnin gabime materiale dhe të përhapura në informacionin që jepnin për syllabuset. Duke iu referuar anekseve 15 & 16, objektivi i programeve sipas dokumenteve përkatës formulohej si: “ ... t’u jepen studentëve njohuri të thella dhe specifike ... në fushat e veprimtarisë së Shërbimeve Inteligjente dhe atyre Policore në sistemet demokratike ” (kreu II, neni 3, pika 1). Në vijim: “ ... programi synon dhënien e një tërësie njohurish ... në kuadër të parandalimit të krimit transnacional dhe përballimin me sukses të sfidave ndaj krimit të organizuar ” (kreu II, neni 3, pika 2). Së fundmi: “Programi synon ... aftësimin e specialistëve për vazhdimin e studimeve të mëtejshme të ciklit të tretë në të njëjtën fushë.” (kreu II, neni 3, pika 3). Duke iu referuar aneksit 19, studimi i tregut është realizuar me të dhëna dytësore, pra studim i një kompanie të pakontraktuar nga IAL-ja dhe në nivel makro, pra jo për nevojat specifike të IAL-së. Ky studim nuk prononcohet për përzgjedhjen e programeve të studimit në mënyrë të tillë që të argumentojë thellimin e njohurive në disiplina të caktuara dhe zhvillimin e aftësive profesionale në përputhje me tregun. Në programe të tilla si këto për të cilat ka aplikuar institucioni për akreditim, testi i vërtetë i dijes është tregu. Referuar aneksit 54, Kolegji Universitar i Biznesit pohon se 90% e studentëve të tij janë të punësuar, pra njohuritë e ofruara nga këto programe garantojnë zhvillimin e aftësive në përputhje me tregun. Në përfundim, literatura e përdorur për thellimin e dijeve dhe zhvillimin e aftësive profesionale është e vjetër, e papërditësuar, e përkthyer ose importuar nga libra të huaj dhe deri diku e përshtatur me realitetin shqiptar.” Për këtë rishprehim dhe njëherë kontestimin e argumentuar më herët lidhur me literaturën e ndonjë lënde për shkak të lapsusit të ngarkimit në version skan në sistem (psh Lënda Qeprisja e Korporatave dhe Kontab. Kosto Drejtimi) apo dhe llojit të literaturës lidhur me lëndën Taksimi i Avancuar. Këto u trajtuan dhe u sqaruan dhe me takimin e GVJ me stafin ku dhe sic pranohet nga vlerësimi i GVJ ishte mjaft pozitiv dhe shterues. Po kështu, lidhur me referimin e Aneksit 16 (Kreu II, neni 3, pika 3) e sqaruar dhe më lart se nga vizita e Gvj në institucion kemi pranuar një lapsus nga ana jonë sa i takon Rregullores dhe për këtë është pranuar nga GVJ duke vijuar nga ana jonë rregullimi dhe rishikimi i menjëhershëm i nenit në fjalë gjë që mund t’jua vëmë në dispozicion menjëherë bashëngjitur kësaj shkrese. Referuar konstatimit të GVJ lidhur me nivelin makro të studimit të tregut, rithkesojmë se nevoja e tregut për këto profile të riorganizuara në 2018 është ende në kolaudim dhe orientim me këtë zhvillim të ri të riorganizimit të masterave profesionale dhe ndaj kjo logjikë u pranua dhe gjatë vizitës së GVJ.

Ky koment pranon gjetjet e ekspertëve dhe nuk ngre ndonjë objeksion për vërtetësinë e vlerësimit të tyre. Rrjedhimisht nuk ka lëndë për t’u marrë në konsideratë.

* * * * *

GVJ shprehet se: “Gjithashtu, nga intervistat me stafin drejtues pohohet se lëvrohen edhe tema të veçanta nga profesorë të huaj, ndonëse në tabelën 20, fq. 19 të aneksit mbi tabelat përmbledhëse

shkruhet se numri i leksioneve/seminareve me profesorë të huaj në vitet e fundit (pa specifikuar konkretisht periudhën) është 0 (zero).” Për këtë rast sqarojmë se raportimi ynë në lidhje me nr. e lektorëve të huaj është i saktë pasi nuk kemi, ndërkohë stafit gjatë vizitës I referohet leksioneve të hapura që kemi patur ndër vite si dhe të referuara dhe me linkun përkatës në Ëeb.

Ky koment pranon gjetjet e ekspertëve dhe nuk ngre ndonjë objeksion për vërtetësinë e vlerësimit të tyre. Rrjedhimisht nuk ka lëndë për t’u marrë në konsideratë.

* * * * *

GVJ shprehet se: “Nga konsultimi me aneksin 37 (urdhër për konkurset studentore në KUB) konstatohet se institucioni ka tentuar të organizojë në vitin 2019 (semestri I) dy konkurse: një letraro-artistik dhe një i titulluar “Kërkimi im”, por pa specifikuar fushën e konkursit. Ndonëse KUB ka dy fakultete në përbërje të tij, atë të ekonomisë dhe drejtësisë (statuti institucional, neni 10) është e paqartë se pse institucioni organizon konkurse letraro-artistike, të cilat promovojnë aftësi jashtë misionit institucional. Gjithsesi, nga takimi me studentë u pohua se vetë ata nuk kishin marrë pjesë në aktivitete të tilla, por kishin dijeni që ishin organizuar. Në dosjen e ASCAL nuk u gjetën nga ekspertët dokumente që vërtetonin kryerjen me sukses të këtyre aktiviteteve dhe shpërndarjen e çmimeve që parashikoheshin për fituesit, si formë e mbështetjes financiare.” Nga konstatimi I GVJ lidhur me konkursin “Kërkimi im” sqarojmë se ishte një konkurs për ide inovative në teknologji informatike në përdorim të studentëve të ekonomisë si dhe atyre të informatikës së biznesit. Lidhur me komeentin e GVJ për konkurset me tematikë letraro-artistike nuk shohim problematikë pasi rëndësia e zhvillimit të kapitalit njerëzor përmban dhe vlerësimin apo dhe motivimin e shpirtit artistik të studentëve. Gjithashtu, cmimet janë të trajtuara me fasha në aneks nr 37 ndërsa urdhrat e pagesave lidhur me cmimet janë të disponueshme në zyrat e finances KUB, por konstatojmë se ato nuk na u kërkuan gjatë vizitës së GVJ.

Pavarësisht mirëkuptimit të komentit për zhvillimin e shpirtit artistik të studentëve për ekonomi dhe jurisprudencë, grupi i ekspertëve vijon të gjykojë se ato dalin jashtë objektivave institucionale në përgjithësi dhe këtij programi në veçanti, për përgatitjen e studentëve për tregun e punës. Po kështu, promovimi i studentëve që kanë shpirt të pasur artistik, ndërkohë që studiojnë për ekonomik apo juridik, mund të konsiderohet si përdorim fondesh institucionale pa efektivitet. Lidhur me urdhër-pagesat për çmimet, ato mund të ishin ngarkuar në setin e dokumenteve në ASCAL, sikurse ishin ngarkuar broshurat për marketing të institucionit, ndonëse edhe këto nuk u kërkuan nga grupi i ekspertëve. Ky observacion nuk mund të merret në konsideratë.

* * * * *

GVJ shprehet se: “Nga dokumentacioni i konsultuar vërehet se KUB ka marrëveshje të shumta, por termat specifike të këtyre marrëveshjeve në dobi të studentit nuk na u vunë në dispozicion. Studentët, në intervistat me ta, u shprehën se janë në dijeni të studentëve të tjerë që kanë përfituruar shkëmbim eksperiencash, duke vizituar institucione të huaja akademike, por asnjë prej tyre nuk kishte përfituruar direkt nga ky mobilitet. Nga të dhënat e tabelës 20, fq. 19 në aneksin e tabelave përmbledhëse (dok. nr, 4 në dosjen e ngarkuar në ASCAL për këtë program studimi) numri i mobilitetit të studentëve nga dhe prej programit të studimit në vitet e fundit (pa specifikuar konkretisht periudhën) është 0 (zero)”. Konstatojmë se sic jemi shprehur dhe gjatë vizitës se GVJ për këtë çështje, këtë vit KUB përmes zyrës së shkencës dhe projekteve ka filluar nënshkrimin e

marrëveshjeve për mobilitet ersamus + për stafin dhe studentet, por faza e implementimit të tyre maturohet këtë vit apo dhe vitet në vijim.

Ky koment pranon gjetjet e ekspertëve dhe nuk ngre ndonjë objeksion për vërtetësinë e vlerësimit të tyre. Rrjedhimisht nuk ka lëndë për t'u marrë në konsideratë.

* * * * *

Konstatojme se vlerësimi i GVJ i shkallës së përmbushjes "PJESËRISHT" të standardi III.7 dhe ndërkohë sqarimit të pasaktësisë së vlerësimit të 5 prej kritereve, është i pasaktë dhe jokoherent në këndvështrimin e një vlerësimi të balancuar

Sa i përket këtij konstatimi final të subjektit për të këtë standard, grupi i ekspertëve thekson se: a) standardi ka 10 kritere vlerësuese në përbërje të tij; b) nga këto 10 kritere, KUB ka bërë komente për 4 prej tyre (jo 5) dhe nuk sqaron pasaktësi në vlerësimin e 3 prej tyre, madje i pranon gjetjet e ekspertëve në to; c) së fundmi, nisur edhe nga manuali e trajnimi i bërë në ASCAL për ekspertët vlerësues, kriteret nuk kanë peshë të barabartë apo një sistem të deklaruar pikëzimi se si ponderohen në vlerësimin final. Në këto kushte, duke e riparë vlerësimin në draft raport me pozitivitet dhe meqënëse në vlerësimin fillestar KUB ishte midis nivelit "pjesërisht" dhe "kryesisht" për këtë standard, grupi i ekspertëve gjykon me bindje të arsyeshme se niveli më i përshtatshëm i përmbushjes së këtij standardi nga KUB mund të jetë më pranë "Kryesisht"

* * * * *

GVJ shprehet se: "Nga aneksi nr. 52 (model tip raport praktike mësimore) nuk mund të konkludohet me bindje të arsyeshme se procesi ezaurohet në praktikë, vetëm që ai parashihet shkresërisht në dokumentacionin institucional". Për këtë sqarojmë pasaktësi në vlerësimin e GVJ lidhur me zhvillimin e praktikave mësimore ku në aneks sic pranohet kemi dhënë modelin tip të procedurës që përmban një dosje model, ndërkohe që nga vizita e GVJ në sekretari nuk kemi dijeni që kanë kerkuar për të parë një dosje të plotësuar të zhvillimit kornkret të praktikës.

Grupi i ekspertëve, sikur është theksuar më lart, i ka kërkuar përfaqësuesve të KUB të plotësojnë dokumentacionin për vlerësim, i cili përmbante gabime, mungesa dhe pasaktësi. Kësaj kërkesë, KUB nuk iu përgjigj, për sa kohë u hartua draft RVJ. Po kështu, në ditën e inspektimit në terren, grupi i ekspertëve e ezauroi kohën në dispozicion me çështje të tjera, të cilat edhe ato kishin mangësi në dokumentacion apo gabime. Pikërisht për të shmangur inspektimin e çdo dokumenti në terren, KUB mund të kishte ngarkuar në platformën e ASCAL, ku ekspertët kishin akses, një dosje shembull për ndjekjen e praktikës e cila tek e fundit e përmban edhe modelin e vlerësimit që aty (në platformën e ASCAL) është ngarkuar. Për sa kohë një kampion dosjesh të tilla nuk u konsultuan nga grupi i ekspertëve, jo për mungesë vullneti të tyre, ky vlerësim nuk mund të ndryshojë dhe për rrjedhojë komenti nuk mund të merret në konsideratë.

* * * * *

GVJ shprehet se: "Ndonëse RVB i është referuar Rregullores Institucionale (nenet 102-107) dhe rregulloreve të departamenteve përkatëse në plotësimin e këtij kriteri, GVJ nuk i gjeti këto dokumente në dosjen e ASCAL, as në kërkimet ekstra shkresore në prezencën online të institucionit

në adresën <http://kub.edu.al/>. Dokumentet e konsultuara parashikojnë hartimin e procedurës dhe bërjen publike të saj, por GVJ nuk iu vu në dispozicion një praktikë konkrete realizimi nga struktura e KUB.. Edhe një herë konstatojmë mosinformim dhe pasaktësi të vleresimit të GVJ lidhur me nenet e referuara të rregullores së KUB (neni 102-107) pasi sic jemi shprehur me lart ato janë të depozituara në Aneksin 17 që sipas këshillave në trajnimin mbi procesin e akreditimit me ekspertin e ASCAL, Znj. Renata Qatibi për të mos ngarkuar në mënyrë të përsëritur dokumente janë ngarkuar dhe dërguar në dosjet e mëdha (Aneksi B) të cilat do të shërbenin dhe eksperteve të akreditimit pjesor Institucional dhe të KSLP të cilët përkuan në të njëjtën periudhë vizitash në KUB. Dokumentet të konsideruara nga GVJ si mungesë jo vetëm janë depozituar dhe referuar dhe në RVB por dhe ishin të disponueshme dhe kur GVJ bëri vizitën në KUB dhe që mund të viheshin dispozicion nga ne në çdo kohë. Sa i takon nivelin e pyetjeve formuese dhe nivelin e informimit për diplomimin e studentëve kemi trajtuar gjërësisht në RVB ku japim dhe linkun përkatës në ëeb ku gjenden paketa udhëzuese për procedurat e diplomimit si dhe pyetjet me karakter formues në shërbim të studentëve diplomat. Ndërkohë që GVJ gjate vizites në sekretari nuk kërkoi material plotësues lidhur me kete.

Grupi i ekspertëve të jashtëm kishte për detyrë të bënte vlerësimin RVJ, mbështetur në dokumentet e vëna në dispozicion. Nga dokumentet e vëna në dispozicion në bazën elektronike të ASCAL për ekspertët e jashtëm, këto dokumente ishin ngarkuar vetëm si kopertinë, por jo si përmbajtje! Po kështu, edhe në faqen online të KUB, ku këto dokumente duhet të ishin prezente, nuk u gjetën. Lidhur me vënien në dispozicion të këtyre dokumenteve gjatë vizitës në terren, grupi i ekspertëve thekson se në vizitën një-ditore të kryer në subjekt, nuk mund të konsultohen dokumente të tilla, nën për nen, direkt në subjekt. Grupi i ekspertëve i kërkoi stafit të KUB të korrigjonte lapsuset, gabimet dhe ringarkonte dokumentet e nevojshme për një vlerësim sa më të plotë dhe të suksesshëm, gjë që nuk u reflektua në platformën online të ASCAL dhe as përmes postës elektronike. Po kështu, në grupin e ekspertëve vlerësues ka qenë e pranishme edhe një përfaqësuese e ASCAL, e cila ka studiuar dhe bashkëpunuar në hartimin e draft RVJ-së. Përfaqësuesja e ASCAL konfirmon se dokumentet e sjella nga KUB në rrugë fizike, i përkasin akreditimit të një njësie kryesore dhe jo programit aktual për të cilën ishin angazhuar ekspertët. Po kështu, në dosjen fizike nuk gjendet asnjë shënim që këto dokumente mund/duhet të përdoren, duke u vënë në dispozicion të ekspertëve për vlerësimin e këtij programi studimi.

Në këto kushte, kur: a) subjekti duhet të kishte reflektuar kërkesën e ekspertëve gjatë vizitës në terren, b) për transparencë duhet t'i ketë publike këto dokumente në faqen e tij në Internet dhe, c) ekspertëve nuk iu vunë në dispozicion dokumentet fizike të depozituara në ASCAL për një akreditim tjetër, ky observacion nuk mund të merret në konsideratë.

* * * * *

Në vlerësimin final të GVJ kontestojmë me argumentet si më sipër shkallën e përmbushjes “Kryesisht” të dhënë nga GVJ për Fushën III - “MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT”, pasi nga 9 standarde që ka kjo fushë janë vlerësuar nga GVJ si plotësisht vetëm 4 prej tyre, ndërkohë që penalizohet pasaktësisht përmbushja e 65 kritereve në total që përmban kjo fushë në vlerësim.

Grupi i ekspertëve gjykon se, duke u nisur nga fakti që nga 9 standardet që ka kjo fushë: a) 4 përmbushen “plotësisht”, b) 4 përmbushen “kryesisht” (përfshirë edhe standardin III.7 të ndryshuar), dhe c) 1 përmbushet “pjesërisht”, sikurse edhe nga përgjigjet e dhëna për kriteret rast

pas rasti, vlerësimi “Kryesisht” për fushën III është i bazuar dhe mbështetur arsyeshëm në dokumentet e konsultuara, faktet e ofruara dhe analizat e kryera, rrjedhimisht vlerësimi për fushën nuk ndryshon.

* * * * *

Kur GVJ flet për problematikat lidhur me kontratën e punës me orët javore të punonjesit dhe kohezgjatjen e punës për 6 dite në javë, sqarojmë se këto trajtime dhe qendrime të pershkuara në kontratat individuale me punonjesit e KUB janë ndertuar të tilla për shkak të vecorise që ka realizimi i procesit mesimor në arsimin e lartë. Kemi parasysh këtu realizimi i procesit mesimor, jo vetëm për bachelorin që realizohet nga e hena në të premte për 5 dite, por edhe edhe për masterat të cilat realizohen pasdite nga e merkura në të shtunë. Për këto arsye është dokordësuar edhe me stafin akademik që duke mos tejkaluar orët javore të punës të shtrihet java e punës jo në 5 por në 6 dite.

Komenti risjell në vëmendje të grupit të ekspertëve një çështje tërësisht të shterruar në analizën për kriterin 2 të këtij standardi në draft RVJ, duke mos sjellë asnjë referencë të re ligjore apo interpretim të ndryshëm, që të kontestojë analizën e ekspertëve. Në këto kushte, komenti nuk sjell asgjë të re për t’u marrë parasysh.

* * * * *

Lidhur me vlerësimet e GVJ për ngarkesën mesimore për stafin e KUB, sqarojmë se kompetenca lidhur me përcaktimin e ngarkesës mesimore të stafit të diferencuar kjo sipas niveleve dhe gradave dhe titujve të stafit, është në kompetencën e Senatit Akademik dhe organeve të tjera të KUB si institucion jopublik mbështetur dhe në LAL 80/2015 Neni 59, pika 8, Paragrafi I fundit ku theuhet “Në institucionet jopublike ngarkesa përcaktohet nga vete institucioni). Megjithatë, niveli I ngarkesës mesimore të stafit akademik të KUB nuk është me I lartë nga ajo në institucionet publike tek të cilat shitesat mbinorme behen me qellime shperblimi.

Analiza e grupit të ekspertëve, së cilës i referohet ky koment, e ka cilësuar në mënyrë eksplicite se është Senati Akademik dhe organet e tjera që përcaktojnë ngarkesën mesimore. Pra komenti është në një linjë me konstatimet e analizës. Por qëllimi dhe konkludimi i analizës së ekspertëve në draft RVJ lidhen me mënyrën e paqartë se si KUB dizendon politikën e punësimit dhe implementon atë të shpërblimit financiar për punën e kryer. Pra komenti nuk sqaron mangësinë e konstatuar nga ekspertët në këtë drejtim, por vetëm përsërit pjesërisht analizën. Rrjedhimisht, komenti nuk sjell asgjë të re për t’u marrë parasysh.

* * * * *

Kontratat e stafit akademik dhe atij ndihmes në KUB nënshkruhen nga REKTORI.

Ekspertët, sikurse theksuar në draft raport, i janë referuar aneksit 40 të depozituar në platformën online të ASCAL. Nga kontrata tip e punës, shihet qartë që nënshkruar është Administratori dhe jo Rektori. Komenti nuk sjell asnjë referencë, por vetëm një fjali dëftore të pambështetur shkresërisht, rrjedhimisht nuk mund të merret në konsideratë.

* * * * *

Kriteri 3 (fq.43) – Lidhur me kete vleresim GVJ eshte krejtesisht e pasakte pasi “Rregullorja e Marredhenieve te Punes” te ciles GVJ I referohet si e munguar, gjendet ne aneksin 41 te RVB lidhur me aneksin D te Dosjes Kryesore te dorezuar prane ASCAL. Ne raport GVJ se kjo rregullore nuk ju vu ne dispozicion! Nuk kemi asnje indikacion qe kjo rregullore te jete kerkuar dhe most e jete ofruar nga ne.

Sikurse është theksuar në draft raport, aneksi 41 në platformën online të ASCAL, si për programin me 60 kredite, ashtu edhe për atë me 120 kredite të KUB, është ngarkuar vetëm si kopertinë, pa përmbajtje. Gjithashtu, plotësimi i dokumentacionit i është kërkuar subjektit në vizitën në terren. Komenti nuk mund të merret parasysh, për atë kohë sa grupi i ekspertëve nuk kishte akses në informacion.

* * * * *

Kriteri 2 (fq 43) – GVJ vijon te jete e pasakte ne vleresim pasi nenvizojme se ne KUB jane realizuar konferenca shkencore kombetare dhe nderkombetare, 10 te tilla, nga viti 2013-2019, te cituara dhe te referuar dhe ne dokumentin mbeshkets te RVB (publikimet ne Proceedings te tyre jane ne library, arkiv dhe biblioteke dhe ne cdo zyre tonen). Mungesa e pretenduar per GVJ per Aneksin 42 lidhur me Guiden udhezuese per procesin mesimor online, rikonfirmojme se gjendet ne Aneksin – DOSJA Covid-19, AI- KSLP. Informacionet gjoja te munguara lidhur me buxhetin, fondet per kerkimin shkencor, raportet e detajuar te audituesit te jashtem te pasqyrave financiare Grand Thorton si dhe vete pasqyrat financiare jane dokumentacion I publikuar dhe ne faqen eeb te KUB dhe ne Raportin Vjetor Institucional 2018- 2019 si dhe ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB) te cilat jane te aksesueshme per cdo person dhe jane te miratuara me Vendime Senati dhe Bordit te Administrimit te KUB. Megjithate, nenvizojme se, sa I takon aspekteve te natyres financiare dhe te dhenave te detajuara ne terma absolute te treguesve KUB I nenshtrohet inspektiveve te kontrollit te Inspektoriatit tatimor. Kjo perben njekohesisht dhe nje aspect te autonomise financiare te KUB.

Në këtë koment janë përmbledhur disa çështje, të cilat meritojnë përgjigje të veçanta. Konkretisht: a) për konferencat shkencore, sikurse theksohet në draft raport, 10 konferenca i përkasin periudhës 2013-2016 (cituar në bazë të dokumentit referues), ndërkohë që komenti i shtrin këto konferenca për periudhën 2013-2019, pa dhënë referenca konfirmuese për këtë pretendim në vitet 2017-2019. 3 nga 4 konferenca, përtej 10 të sipërcituarave, janë konferenca studentore, pra jashtë fokusit të këtij kriteri. Për 1 konferencë të mbetur nuk mund të konkludohet efekti në kualifikimin e mëtejshëm të stafit që mbulon programin e studimit të aplikuar për akreditim; b) sa i përket guidës së mësimin online, draft RVJ nuk i referohet në asnjë rast për analizën e këtij kriteri. Por gjithsesi, grupi i ekspertëve thekson se kjo guidë gjendet vetëm si kopertinë në dokumentet e depozituara në platformën e ASCAL, pra pa përmbajtje; c) për fondet mbi kërkimin shkencor, nga të gjitha dokumentet e konsultuara, përfshirë raportet e Grand Thorton, nuk jepet asnjë informacion konkret se sa janë fondet për këtë kërkim në KUB. Gjithashtu, përmendja e kontrolleve të inspektoriatit tatimor në koment, gjykojmë se del jashtë fokusit të kriterit për të cilin është ndërtuar analiza e ekspertëve. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për referimin ndaj autonomisë financiare, sepse në këtë rast po vlerësohet financimi i kërkimit shkencor brenda autonomisë që ligji i garanton IAL-së.

Për sa më lart, ekspertët gjykojnë se komentet për këtë kriter kanë prekur edhe çështje jashtë këtij kriteri ose që trajtohen në pjesë të tjera të materialit. Për komentet që i përkasin këtij kriteri (germat

“b” dhe “d” më lart), ekspertët gjykojnë se KUB nuk ka sjellë asnjë referencë të re, informacion shtesë apo analizë që të ndryshojë vlerësimin përkatës. Pra nuk merret në konsideratë.

* * * * *

Kriteri 4 (fq 45) - Për këtë konstatojmë një tjetër pasaktësi pasi GVJ i është refruar vetëm ngarkese në vlerë nominale (nr. personash) duke mos marrë parasysh ngarkesen vjetore orare te stafit te brendshem dhe te jashtem si dhe realizimit e oreve të praktikës mësimore (60 orë) realizuar nga staf i brendshëm por dhe orëve të mbrotjes së diplomës (330 orë) realizuar nga staf i brendshëm dhe vlerësimin në mënyrë të kryqëzuar të informacionit në tabelat përmbledhëse në raport (Tabela nr. 4 – ngarkesa e personelit akademik / Tabela nr.12- Plani mësimor lidhur me personelin akademik). Duke rillogaritur saktë dhe në mënyrë të kryqëzuar këtë të dhëna të vëna në dispozicion rezulton se raporti PAE/PAK në mbulimin e programit nuk është 38%/62% por saktësisht raporti PAE/PAK është 63%/37% (PAE orë total = 390+60+330 = 780 orë nga 1230 orë total të programit. 780/1230=63 %).

Për këtë koment, grupi i ekspertëve thekson se diferenca me 1% e përlllogaritjeve, nuk ndryshon pragun e vendosur nga baza nënligjore e cituar (70%). Rrjedhimisht pranohet si diferencë jorelevante në vlerësimin e kriterit.

* * * * *

Kriteri 1 -5 (fq 50-51) - Ne RVB dhe ne anekse perkatese lidhur me pasqyren e te ardhurave nga burime te ndryshme, ate te kostove sipas perdorimeve te tyre, te raportit vjetor te KUB derguar ne MASR cdo fundviti, te raportit te adituesve te jashtem si dhe pasqyrave financiare vjetore te KUB, te gjitha sebashku japin informacione te mjaftueshme dhe shteruese lidhur me masen e te ardhurave te siguruara nga KUB sipas burimeve te ndryshme ligjore (te ardhura nga tarifat e studenteve, te ardhura nga trajnime, te ardhura nga sherbime tetjera mbeshtetese bar-kafe, shitje librash dhe fotokopje si dhe te ardhura nga pjesemarrja ne projekte). Nderkohe ne keto dokumente te mesiperme jepen informacione te detajuara edhe sa I takon 10 kostove te procesit dhe aktivitetit te KUB lidhur me: (pagat e stafit te brendshem dhe te jashtem, siguracionet, qirate e objekteve te dy godinave, ndricim-uje, investime pajisjesh dhe ngritje dhe plotesim te nevojave te 4 laboratoreve, te koston per kerkimin shkencor, amortizimet e aktiveve/asteve etj.). Keto informacione qe lidhen me hartimin e buxhetin dhe me bilancin vjetor (pasqyrat financiare vjetore) miratohen nga SA KUB dhe BA cdo vit. Eshte e nevojshme te veme ne vemendje se, per asnje moment dhe per cdo nevojte te verprintarise akademike dhe procesit mesimor te KUB, mbeshtetja financiare nuk ka munguar per asnje rast. Perkundrazi IAL KUB në rrethin e institucioneve jopublike te arsimit te larte ka qene dhe mbetet nje model i korrektesise dhe transparences financiare. Sa I takon qendrueshmerise financiare te ketij institucioni gjate gjithë ekzistences se tij, ka qene e sigurt dhe e plote.

Grupi i ekspertëve gjykon se ky koment, ndonëse përpiqet të hedhë dritë mbi kërkesat e kriterëve të standardit IV.6, të cilat në draft RVJ janë theksuar se ka mungesë të plotë informacioni, përsëri nuk e realizon një gjë të tillë. Komenti sërish nuk sjell referenca konkrete ndaj dokumenteve ku ekspertët të kenë akses dhe të krijojnë bindjen e arsyeshme se vërtet institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare dhe mbështetjen e stafit dhe studentëve. Rrjedhimisht, komentit nuk sjell asgjë të re që të ndryshojë qëndrimin e ekspertëve, shprehur në draft RVJ.

* * * * *

Në vlerësimin final të GVJ kontestojmë me argumentet si më sipër shkallën e përmbushjes "PJESERISHT" të dhënë nga GVJ për Fushën IV, pasi penalizohet pasaktësisht përmbushja e të gjitha kriterëve, nderkohe që ne këtu fushë ne konsiderojmë piken me të forte të KUB në raport me IAL e tjera. Mbështetur në objeksionet dhe komentet tona është e nevojshme të ndryshohet detyrimisht vlerësimi i kësaj fushë.

Nisur nga argumentet e ekspertëve ndaj komenteve më lart për këtë fushë, si edhe duke theksuar se transparencja financiare është element kyç në krijimin e bindjes së arsyeshme se burimet njerëzore, financiare, infrastruktura, logjistika, etj., do të vijojnë të mbeten në nivele të qëndrueshme për periudhën e ardhshme të akreditimit, grupi i punës gjykon se vlerësimi për këtë fushë nuk mund të ndryshojë, për sa kohë nuk hidhet dritë mbi aspektet e financimit dhe alokimit të shpenzimeve operative e strategjike.

* * * * *

Kriteri 1, 2, 3, 4, (fq.61) - GVJ në vlerësimin e ketyre kriterëve shprehet pozitivisht sa i takon përmbushjes lidhur me vlerësimin e kriterëve 1-4 të këtij standardi. - Konstatohet se vlerësimi i GVJ i shkallës së përmbushjes "KRYESISHT" të standardi VI.I duke vlerësuar pozitivisht 3 nga 4 kriteret, është i pasaktë dhe jokohorent në këndvështrimin e një vlerësimi të balancuar.

Nga dokumentet e konsultuara, grupi i ekspertëve ka krijuar bindjen se strategjitë dhe politikat për cilësinë janë të përgjithshme. Ato nuk janë të dedikuara dhe janë pjesë e planit strategjik institucional. Rrjedhimisht, vlerësimi "kryesisht" i këtij standardi buron nga vlerësimi pjesor pozitiv i 3 kriterëve dhe vlerësimi jo pozitiv për një kriter. Në këtë këndvështrim, grupi i ekspertëve gjykon se përmbushja "kryesisht" e standardit VI.1 është mëse e justifikuar.

* * * * *

Kriteri 3 (fq 62) – GVJ shprehet se "Nga konsultimi me bazën dokumentare të depozituar në ASCAL nuk gjenden gjurmë të ndonjë metodologjie vlerësimi në këtë drejtim. Mënyra se si përpunohen të dhënat e NjBSC-së për matjen dhe vlerësimin përmes një sistemi vlerësimi të ecurisë së programeve të studimit nuk gjendet as në raportet periodike, siç është ai i përfshirë në aneksin 57. Konkretisht, 7 nga 8 pyetjet e drejtuara studentëve përmes pyetësorëve në të dy semestrat, përgjatë vitit akademik 2018-2019, vlerësojnë vetëm anën logjistike të mësimdhënies dhe vetëm njëra prej tyre (pyetja 3) vlerëson pjesërisht aspektin akademiko- profesional. Në vlerësimin tabelar të përmbledhur në fund nuk i janë dhënë peshat përkatëse pyetjeve dhe as nuk konkludohet me një parametër agregat kundrejt syllabusit specifik, por vetëm kundrejt pyetjes specifike. 11 Gjithashtu, vlerësimet pikësore nuk shoqërohen me analiza, për një vlerësim kuptimor të asaj që është matur." Në këtë rast konstatohet një vlerësim jo korrekt nga GVJ pasi siç jemi shprehur dhe në RVB në përfundim të çdo semestri akademik, të gjithë studentët e programeve të studimit të ciklit të parë dhe të dytë KUB, plotësojnë pyetësorët në lidhje me vlerësimin e pedagogut dhe procesit mësimor për çdo modul/lëndë. Përmbajtja e pyetësorëve është standarde dhe konsiston në vlerësimin nga ana e studentit të 13 përbërësve me një interval nga 1-dobët, 2- mjaftueshëm, 3- mirë dhe 4-shumë mirë. Në aneksin 58 është në dipozicion dhe një pyetësor i plotësuar ku mbështetur në statistiken pershkruese për 13 pyetjet e cila jepet në tabela të vecanta për secilin

pedagog per lendet qe ka mbuluar, me katër rubrika vlerësimi në % (dobët, mjaftueshëm, mirë dhe shumë mirë).

Komenti i subjektit për vlerësimin e këtij kriteri dëshmon për moskuptim të mirë të metodologjisë së vlerësimit për rritjen e cilësisë. Është e vërtetë që KUB përdor pyetësorë për vjeljen e mendimeve të studentëve lidhur me cilësinë, por sikurse është theksuar në draft RVJ, pyetësorët nuk janë të balancuar sa i përket pyetjeve që adresojnë aspektin logjistik të mësimdhënies e mësimnxënies me aspektin akademik. Po kështu, këto pyetje nuk përcaktohen me pesha për rëndësinë që kanë në vlerësimin e cilësisë. Së fundmi nuk bëhen analiza për të kuptuar dhe dhënë informacion tek menaxhimi institucional se cilat janë problemet dhe si mund të adresohet korrigjimi e përmirësimi e situatës. Për sa më lart, grupi i ekspertëve i qëndron vlerësimit në draft RVJ për këtë kriter.

* * * * *

Kriteri 5 (fq.63) – GVJ shprehet se: “Nga konsultimi me dokumentet e mësipërme, nuk gjenden gjurmë të analizave për të kuptuar mangësitë (atje ku ka) dhe identifikuar mënyra për t’i minimizuar apo shmangur ato. Në gjykimin e grupit të ekspertëve, procesi është rutinor dhe jo udhëheqës në ndërtimin e strategjive dhe planeve për të kuptuar dobësitë dhe rritur shanset për sukses”. Në këtë rast theksojmë sic jemi shprehur në RVB se praktikrat e mira për testimin e cilësisë së programit të studimit si dhe të aktiviteteve ndihmëse didaktike, diskutohen në Senat dhe bëhen pjesë e praktikës së detyrueshme të KUB. NjSBC ka bërë propozimet që janë miratuar dhe konkretizuar, me qëllim përmirësimin dhe mbarëvajtjen e aspekteve të veçanta akademike apo administrative, si për: a) formalizimin e takimeve periodike me studentët në kuadër të tutorisë; b) përgatitja e udhëzuesve standard për zhvillimin e praktikave mësimore dhe udhëheqjes së diplomave, c) informimin e studentëve me temat orientuese të diplomave, d) informimin e studentëve rreth pyetjeve formuese përgatitore për diplomimin e provim formues (Cikli I Bsc), e) standardizimin e formatit të raportimit të aktivitetit mësimor-shkencor të pedagogëve, f) unifikimin dhe standardizimin e syllabusit sipas kërkesave të udhëzimeve të LAL - Konstatojme se vlerësimi i GVJ i shkallës së përmbushjes “KRYESISHT” të standardi VI.2 duke vlerësuar pozitivisht 3 nga 5 kriteret, është jokohorent në këndvështrimin e një vlerësimi të balancuar.

Nga përmbajtja e komentit, KUB konteston sërish vlerësimin e ekspertëve si të pabalancuar, duke iu referuar faktit se 3 nga 5 kriteret janë vlerësuar pozitivisht dhe shkalla e përmbushjes është “kryesisht”. Për këtë kontestim, ekspertët gjykojnë se: a) vlerësimi në masën 60% pozitivisht i setit të kriterëve për këtë standard, nuk mund ta kualifikojë KUB për t’u vlerësuar maksimalisht me nivelin “plotësisht”, në çfarëdo lloj sistemi vlerësimi. Prandaj vlerësimi është koherent dhe i balancuar, b) grupi i ekspertëve, lidhur me garantimin e cilësisë për arritjen e objektivave, gjykon se ka më shumë rëndësi përmbajtja sesa forma. Pra KUB vërtet ka një njësi cilësie, vërtet ka letra pune, por procesi nuk është performant në praktikë, pra nuk është faktor përmirësues me peshë në mbarëvajtjen akademike. Për sa më lart, grupi i ekspertëve gjykon se vlerësimi në draft RVJ është koherent, i balancuar dhe dashamirës.

* * * * *

Kriteri 1 (fq 66) – GVJ shprehet se: “Nga konsultimi me prezencën online të institucionit, konstatohet se NjSBC ka një faqe të dedikuar për të, ku janë pasqyruar në mënyrë transparente

raportet e sigurimit të cilësisë ndër vite. Në këtë hapësirë virtuale nuk gjenden dokumente të strategjive dhe politikave në këtë drejtim. Edhe nga dokumentet e depozituara në ASCAL mungon një plan strategjik i mirëfilltë për cilësinë, por elementë të rregullimit të saj gjenden në statut, plan strategjik institucional dhe rregulloren e NJSBC-së.” Në këtë rast theksojmë se politikën në këtë drejtim gjenden në faqen e dedikuar të NJSBC që sic pranohet nga GVJ është e aksesueshme dhe transparente në informacion, ku ndër të tjera në faqen ëeb: <http://kub.edu.al/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise-njsbc/> gjenden dhe strategjitë dhe politikën e cilësisë së NJSBC si: »Aprovimi, monitorimi dhe shqyrtimi periodik i programeve; »Vlerësimi i studentëve; »Sigurimi i cilësisë së stafit mësimdhënës; »Burimet e mësim nxënies dhe mbështetjes së studentëve; »Informimi i publikut.

Duke iu referuar sërish faqes online të KUB, si edhe duke iu referuar kërkesave të kriterit 1, që bën fjalë për politika, strategji, organizim dhe veprimtari për garantimin e cilësisë, ritheksojmë se KUB nuk ka dokumente të strategjisë dhe politikës për cilësinë. Referenca që i bën KUB aktiviteve apo procedurave për garantimin e cilësisë, si: “Aprovimi, monitorimi dhe shqyrtimi periodik i programeve”; “Vlerësimi i studentëve”; “Sigurimi i cilësisë së stafit mësimdhënës”; “Burimet e mësim nxënies dhe mbështetjes së studentëve”; “Informimi i publikut”, nuk janë strategji apo politika. Një strategji përmban objektivat SMART dhe linjat e veprimit për t’i përmbushur ato. Një politikë përmban setin e rregullave sipas të cilave do të implementohen linjat e veprimit të sugjeruara nga strategjia. Aktivitetet e mësipërme në faqen e KUB nuk japin asnjë shpjegim se cilat janë objektivat dhe si do arrihen ato për cilësinë. Janë thjesht *bullet-points* pa shpjegime. Për sa më lart, grupi i ekspertëve gjykon se komenti nuk sjell asgjë të re për t’u marrë parasysh.

* * * * *

Kriteri 3 (fq.67) – GVJ shprehet se: “Nga dokumentet e depozituara, sikurse edhe nga inspektimi online i raporteve, mungon analiza dhe plani i masave për korrektimin e të metave dhe plotësimin e mangësive”. Në këtë rast theksojmë dhe njëherë atë që kemi shprehur por dhe evidentuar në RVB, NJSBC ka bërë propozimet që janë miratuar dhe konkretizuar, me qëllim përmirësimin dhe mbarëvajtjen e aspekteve të veçanta akademike apo administrative, si për formalizimin e takimeve periodike me studentët në kuadër të tutorisë (sidomos në vijim të trajnimeve dhe me grupet e ekspertëve ASACAL); përgatitja e udhëzuesve standard për zhvillimin e praktikave mësimore dhe udhëheqjes së diplomave (të referuara me link dhe fizik); informimin e studentëve me temat orientuese të diplomave (të referuara me link ëeb); informimin e studentëve rreth pyetjeve formuese përgatitore për diplomimin me provim formues (të referuara me link ëeb).

Komenti pohon se NJSBC ka bërë propozime, ndërkohë që grupi i ekspertëve, sikurse është theksuar në draft RVJ, nuk ka gjetur gjurmë të analizave dhe planit të masave që do të buronte natyrshëm dhe logjikshëm prej tyre. Rrjedhimisht komenti nuk sjell asgjë të re për t’u marrë parasysh.

* * * * *

Kriteri 4 (fq.67) – GVJ shprehet se: “Në mungesë të një analize të thelluar dhe plani respektiv masash, nuk mund të sigurohet efektiviteti dhe impakti për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë. Lidhur me këtë kriter sic jemi shprehur dhe në RVB por dhe gjatë vizitës së GVJ, NJSBC përdor mekanizma për të garantuar sigurimin e cilësisë, përmes: Zbatimit me përpikëri i rregullores së

vlerësimin të brendshëm cilësisë në IAL-në e KUB-it;(referuar në aneks); Monitorimin në mënyrë periodike mbi cilësinë brenda KUB (referuar me link në ëeb).

Kriteri 5 (fq.67) - GVJ shprehet se: “Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk gjenden gjurmë të veprimtarive të tilla.” Lidhur me këtë kriter sic jemi shprehur dhe në RVB por dhe gjatë vizitës së GVJ, NJSBC përdor mekanizma për të garantuar sigurimin e cilësisë, përmes hartimit të planit vjetor të realizimit të veprimtarive të vlerësimin të brendshëm në nivel institucioni referuar në aneks nr.62).

Grupi i ekspertëve e ka hartuar draft RVJ-në duke iu referuar bazës dokumentare të depozituar dhe të aksesueshme, sikurse edhe vizitës në terren. Në përmbushje të metodave për vlerësim, nuk u gjenden gjurmë të analizave të cilësisë dhe planit efektiv të masave, sikurse edhe të veprimtarive konkrete për rritjen e cilësisë. Komenti i referohet RVB-së, hartimit të planit vjetor sipas aneksit 62, por nuk sjell asnjë dokument të pakonsultuar më parë nga ekspertët. Rrjedhimisht vlerësimi në draft RVJ vijon të mbetet i njëjti.

* * * * *

Në vlerësimin final të GVJ kontestojmë me argumentet si më sipër shkallën e përmbushjes “Kryesisht” të dhënë nga GVJ për Fushën VI - “SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL”, pasi nga 5 standarde që ka kjo fushë janë vlerësuar nga GVJ si plotësisht vetëm 2 prej tyre, ndërkohë që penalizohet pasaktësisht përmbushja e 32 kritereve në total që përmban kjo fushë në vlerësim.

Duke iu referuar të gjitha përgjigjeve të komenteve më lart, të dhëna përsa i përket kësaj fushe, grupi i ekspertëve gjykon se vlerësimi me nivelin “kryesisht”, dhënë në draft RVJ, është i vlerësuar rigorozisht, me kujdes dhe me bindje të arsyeshme.

* * * * *

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në Ekonomi me dy profile: "Kontabilitet Financë" dhe "Menaxhim Biznesi"

I. OFRIMI PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë "Master profesional" në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Kolegji Universitar i Biznesit është institucion i arsimit të lartë jopublik, i hapur me VKM Nr. 651 datë 14.09.2011, dhe akredituar me Urdhër të MASH Nr. 557 datë 16.11.2012 dhe riakredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 100 datë 10.11.2017. Programi i ciklit të dytë të studimeve "Master Profesional në Ekonomi" me 60 ECTS në 2 profile: "Menaxhim Biznesi" dhe "Kontabilitet Financë" të ofruar nga Fakulteti i Ekonomisë i Kolegjit Universitar i Biznesit (KUB), është master që përputhet me interesat kombëtare dhe është koherent me strategjitë kombëtare të ekonomisë dhe zhvillimit të Arsimit të Lartë në vend. KUB mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 41, datë 04.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë si dhe në Udhëzimin Nr. 31, datë 29.12.2017 "Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionin dhe riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë".
Kriteri 2 Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Objektivat e mësimdhënies së programit të studimit Master Profesional në Ekonomi" me 60 ECTS në 2 profile: "Menaxhim Biznesi" dhe "Kontabilitet Financë" janë: Formimi i specialistëve të Kontabilitetit dhe Menaxherëve të rinj. Ky program studimi synon jo vetëm krijimin e profesionistëve të së ardhmes por edhe të ruajtje kulturore e profesionit të kontabilistit në vendin tonë. Programi i studimit Master Profesional në Ekonomi bazohet në legjislationin në fuqi të Republikës së Shqipërisë. Kjo bën të mundur dhe njohjen e kësaj diplome si nga institucionet publike po ashtu edhe ato private.
Kriteri 3 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) konstaton se Misioni i KUB është t'u japë studentëve një edukim cilësor dhe të qëndrueshëm; t'i shërbejë dijes së shoqërisë shqiptare me anë të mësimdhënies , kontributit në kërkimin shkencor, përdorimin e arritjeve më të mira të dijes dhe shkencës, si dhe partneriteteve me tregun e punës dhe atyre ndërkombëtare. Programi i ciklit të dytë të studimit

	“Master Profesional në Ekonomi në 2 profile: “Menaxhim Biznesi” dhe “Kontabilitet Financë” është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimet e institucionit. Objektivat e mësimdhënies në programin e studimit në fjalë është të formojë specialistë të aftë për tregun e punës duke ruajtur vlerat kulturore kombëtare.			
Kriteri 4 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Për hapjen e programit të studimit “Master Profesional në Ekonomi në 2 profile: “Menaxhim Biznesi” dhe “Kontabilitet Financë”, institucioni ka marrë në konsideratë zhvillimin ekonomik të vendit që të pasohet me një rritje të të punësuarve në profesionin e kontabilitetit dhe menaxherëve. Për hapjen e programit të studimit në fjalë KUB ka tentuar të bazohet në trendin e përgjithshëm të kërkesave për profesionet e kontabilistit dhe menaxherit ndër vite. Nga analiza e tregut (edhe pse kjo e fundit ish pjesërisht e huazuar nga një ndërmarrje private dhe e bazuar në analizat makroekonomike) në kërkesat e biznesit rezultonte një rritje e numrit të të punësuarve në kontabilitet dhe menaxhim si dhe një rritje e preferencës nga ana e bizneseve dhe institucioneve publike për këto 2 profesione.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Institucioni ka hartuar Planin Strategjik të Zhvillimit të KUB dhe programi i studimit Master profesional në Ekonomi në 2 profile: “Menaxhim Biznesi” dhe “Kontabilitet Financë” është në përputhje me strategjinë e institucionit, si dhe duke marrë në konsideratë zhvillimet ekonomiko-sociale të vendit.
Kriteri 2. Statuti dhe rregulloja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Statuti dhe Rregulloja e programit të studimit Master profesional në Ekonomi në 2 profile: “Menaxhim Biznesi” dhe “Kontabilitet Financë” është hartuar duke u bazuar në misionin dhe vizionin e KUB. Aktet rregullative të KUB pasqyrojnë prioritetet akademike dhe shkencore të përcaktuara nga Ligji i Arsimit të Lartë Nr.80/2015 dhe në mbështetje të Urdhrit Nr. 500 datë 18.10.2012 të MAS.
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje	Emërtimi, organizimi, përmbajtja dhe tërësia e dokumentacionit për ofrimin e programeve të studimit Master profesional në ekonomi është në përputhje me fushën dhe drejtimit akademike të institucionit dhe është koherent me kualifikimet përkatëse të

me fushat e drejtimet akademike të institucionit.	stafit. Përmbajtja e programit të studimit Master profesional në ekonomi me 2 profile: “Menaxhim Biznesi” dhe “Kontabilitet Financë” është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Programi në fjalë është në përputhje të plotë me kornizën shqiptare të kualifikimeve.			
Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.	Strategjia kombëtare e vendit tonë kërkon që vendi të pajiset me profile profesionale adaptë për tregun e punës dhe me njohuri për të operuar në një treg global. Programi i studimit Master profesional në ekonomi me 2 profile: “Menaxhim Biznesi” dhe “Kontabilitet Financë” është në përputhje të plotë me kërkesat qëka tregu kombëtar për burime njerëzore me njohuri të thelluara në kontabilitet dhe në menaxhim. Pra institucioni ka marrë në konsideratë zhvillimin ekonomik të vendit i cili do të pasohet me një rritje të numrit të të punësuarve në profesionin e kontabilitetit apo menaxherit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programet e studimit “Master profesional” synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit “Master profesional” kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.	GVJ konstatoi se misioni i KUB është t’u japë studentëve një edukim cilësor të qëndrueshëm dhe t’i shërbejë vendit me përdorimin e mirë të dijes dhe me partneritet me tregun e punës duke garantuar punësimin e studentëve nga një anë por edhe duke u ofruar atyre njohuri mbi atë çfarë kërkon tregu. Objektivat e mësimdhënies së programit Master profesional në ekonomi me 2 profile: “Menaxhim Biznesi” dhe “Kontabilitet Financë” është formimi i specialistëve të kontabilitetit dhe menaxhimit, pajisja e tyre me kompetenca të elementëve kontabël dhe sistemeve kontabël, njohuri mbi pasqyrat financiare të bizneseve dhe të financave personale. Njohuri mbi format e menaxhimit, qeverisjes së korporatave, kompetenca mbi menaxhimin e burimeve njerëzore. Këto njohuri janë në përputhje me kërkesat që ka tregu i punës.
Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet	Programi i studimit Master profesional në ekonomi me 2 profile: “Menaxhim Biznesi” dhe “Kontabilitet Financë” është hartuar duke pasur në konsideratë nevojat aktuale apo perspektive të zhvillimit ekonomik të vendit dhe ka tentuar tu përshtatet kërkesave të ndryshimit të tregut si në ndërmarrjet private po ashtu edhe institucionet publike. Programi është ndërtuar në mënyrë të tillë që lëndët e përfshira, numri i

<p>të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>krediteve dhe natyra e lëndëve (aneksi 20) e pajisin studentin me njohuri të tilla që e bëjnë më të thjeshtë kalimin në tregun e punës. <i>Megjithatë nisur nga analiza e tregut të punës (aneksi 19) vërehet se ajo është e përgjithshme dhe nuk ka informacion mbi profesionet më të kërkuara apo mbi profilet që aktualisht nuk gjejnë dot punë. Po ashtu duke ju referuar (aneksi 19) vërehet se kjo analizë tregu është bërë në muajin Maj 2020 pra mbas hapjes së programit të studimit. Kjo analizë tregu më tepër se njohuri se çfarë ka pas nevojë tregu në të kaluarën mund të japë se çfarë nevojë ka tregu sot. Pra nuk ka pasur një bazë informacioni se si ka qënë tregu i punës në momentin e hapjes së programit.</i></p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathësisë e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p><i>Objektivi kryesor i programit të ciklit të dytë të studimit Master profesional në Ekonomi profili “Menaxhim Biznesi” (aneksi 16 neni 3) është t’u japë studentëve njohuri të thella ligjore, profesionale dhe kulturore në fushat e veprimtarisë së Shërbimeve Inteligjente dhe atyre Policore në Sistemet demokratike. Ky master synon dhënien e një tërësie njohurish rreth mjeteve dhe metodave bashkëkohore që përdorin ekonomistët dhe biznesit.</i> Programi në fjalë kërkon të përgatisë specialistë të aftë për të punuar kryesisht në sektorin publik por edhe atë privat. Masteri profesional në Ekonomi profili “Kontabilitet-Financë” është t’ju trasmetojë studentëve njohuri themelore të shkencave të drejtimit kontabël dhe administrim të bizneseve në nivel rajonal, kombëtar e ndërkombëtar.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>GVJ konstatoi se KUB bashkëpunonte me një sërë institucionesh publike dhe ndërmarrjesh private si dhe kishte bashkëpunime me një numër të madh lektorësh nga universitetet e tjera. Gjithashtu Programi i ciklit të dytë të studimit Master profesional në Ekonomi profili “Menaxhim Biznesi” dhe “Kontabilitet Financë” është relativisht i ngjashëm edhe me programe studimore të tjera të ofruara nga IAL e vendit. Praktikantët e transferimit të studentëve nga IAL-të e tjera apo anasjelltas në një farë mënyre afirmojnë se ky program është i ngjashëm edhe me programe të tjera studimi të ofruara nga universitetet rajonale.</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislativin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Programi i ciklit të dytë të studimeve Master profesional në Ekonomi profili “Menaxhim Biznesi” dhe “Kontabilitet Financë” është hartuar në përputhje të plotë me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe në përputhje të plotë me nivelin 7 të kornizës shqiptare të kualifikimeve. KUB ka firmosur edhe disa marrveshje Erasmus + për shkëmbime studentësh me</p>

praktikat e mira të vendeve evropiane.	universitete të huaja. Edhe pse nuk ka pas mobilitacion të studentëve, firmosja e marrveshjes në një farë mënyre afirmon se programi i studimit në fjalë i përmbahet parimeve të standarteve ndërkombëtare.			
Kriteri 6. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.	Referuar aneksit 20, vërehet se kurrikuala është në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë. Po ashtu programi i studimit Master profesional në Ekonomi me 2 profile “Menaxhim Biznesi” dhe “Kontabilitet Financë” parashikon kryerjen e një praktike profesionale me 6 kredite sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 41 datë 04.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL. Për kryerjen e praktikave profesionale dhe për të stimuluar aplikimin në praktikë të njohurive teorike KUB ka një sërë marrveshjesh bashkëpunimi me një sërë ndërmarrjesh private, institucionesh publike apo shoqata profesionistësh apo ndërmarrjesh.			
Kriteri 7. Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.	Në programin e studimit Master Profesional në Ekonomi me 2 profile, leksionet zhvillohen vetëm në gjuhën shqipe. Nuk ka module apo lëndë që zhvillohen në gjuhë të huaj.			
Kriteri 8. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësisht të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.	Programi i studimit të ciklit të dytë Master Profesional në Ekonomi me 60 kredite është hapur dhe akredituar sipas afateve ligjore të përcaktuara në Ligjin e Arsimit të Lartë. Ku program studimor i ciklit të dytë është hapur dhe funksionon në mënyrë të përhershme.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.4

Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e	Programi i studimit Master Profesional në Ekonomi me 2 profile “Menaxhim Biznesi” dhe Kontabilitet Financë” është i ofruar nga Fakulteti i ekonomisë si njësi kryesore që përbëhet

<p>duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>nga 3 njësi bazë (Departamente). Departamenti i Menaxhimit; Departamenti i Financë-Kontabilitetit dhe Departamenti i Informatikës dhe Ekonomiksit. Dy departamentet e para janë departamentet përgjegjës për ofrimin e programit të studimit në fjalë. Secili prej këtyre departamenteve ka nga 7 pedagogë nga të cilët tre disponojnë grada dhe tituj shkencorë.</p> <p><i>GVJ duke analizuar Syllabuset e programeve të studimit “Menaxhim Biznesi” dhe Kontabilitet-Financë” kostatoi se 67% e programit të studimit mbulohet nga lektorë të brendshëm.</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Referuar aneksit 29 i cili paraqet formimin profesional të lektorëve përgjegjës për modulet dhe lëndët që ofrohen në programin e studimit Master Profesional në Ekonomi me 2 profile “ Menaxhim Biznesi” dhe Kontabilitet Financë” rezulton se stafi akademik i brendshëm dhe i ftuar kanë profilin e duhur dhe kompetencat për të zotëruar modulet dhe lëndët që janë pjesë e kurrikulës në këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Master Profesional në Ekonomi me 2 profile “Menaxhim Biznesi” dhe Kontabilitet-Financë” ofrohet nga njësi kryesore (Fakulteti Ekonomik) dhe 2 njësitë bazë (Departamenti i Menaxhimit dhe Departamenti i Financë Kontabilitetit). Fusha akademike dhe kërkimore e njësisë kryesore dhe fusha specifike e njësisë bazë që janë përgjegjëse për programin e studimit në fjalë janë në koherencë të plotë, gjithashtu përputhen fusha kërkimore e njësisë bazë me fushën e përgjithshme dhe specifike të programit të studimit.</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në Ekonomi me 2 profile “Menaxhim Biznesi” dhe Kontabilitet-Financë” që ofrohet nga KUB mbështetet nga Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”; Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.41, datë 04.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” si dhe Udhëzimin Nr.31, datë 29.12.2017, “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë. Programi i studimit Master profesional në Ekonomi është në koherencë të plotë edhe me</p>

	kriteret e “Kartës së Bolonjës”.			
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	Programi i studimit Master Profesional në Ekonomi me 2 profile “Menaxhim Biznesi” dhe Kontabilitet-Financë” ofrohet nga njësia kryesore (Fakulteti Ekonomik) dhe 2 njësitë bazë (Departamenti i Menaxhimit dhe Departamenti i Financë Kontabilitetit). Njësia kryesore dhe 2 njësitë bazë janë në koherencë të plotë me fushën akademike e kërkimore me atë të programit studimor në fjalë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.5	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	GVIJ përgjatë vizitës në IAL KUB konstatoi se njësia kryesore, Fakulteti Ekonomik me njësitë bazë përkatëse shkëmbejnë në mënyrë të vazhdueshme raporte periodike. Çdo dokument i njësive bazë siglohej nga drejtuesi i njësisë kryesore. Njësitë bazë bashkërendonin detyrat me zyrat e tjera sipas ndarjes së detyrave dhe funksioneve të shprehura edhe në organigramën e KUB në përputhje me rregulloren e përgjithshme. GVIJ konstatoi po ashtu se një pjesë e stafit përgjegjës për programet e studimeve përkatës kishin dhe një sërë funksionesh të tjera.
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Referuar aneksit 38 i cili paraqet Listën e Organizatave Partnere sipas Marrëveshjeve të nënshkruara me KUB vërehet se ky i fundit ka mbi 75 marrëveshje me institucione të ndryshme publike, private apo IAL brenda dhe jashtë vendit, si ajo me Universitetin e Krajovës në Rumani, Universiteti NWES Në Bullgari, Baltic International Academy, Riga, në Letoni etj.
Kriteri 3. Për realizimin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute,	Kolegji Universitar i Biznesit ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me kompani të ndryshme private si Albsig sh.a apo Antea Cement Sh.a. me Shoqata të ndryshme si Shoqata e kontabilistëve të miratuar, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, Biznes Albania etj.

kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.									
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.	Studententët e Masterit Profesional në Ekonomi kanë kryer praktikat e tyre mësimore pranë bizneseve të ndryshme, Bankave të nivelit të dytë apo studiove të ndryshme profesionale, apo kompanive të auditimit. Për realizimin e këtyre praktikave KUB ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi. Megjithatë nuk ka dokumentacion përkatës nëse monitorohet procesi i praktikës profesionale apo jo.								
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	IAL KUB me anë të Institutit për Studime dhe Aplikime në Biznes ofron kurse të tranimit për “Standartet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe të Raportimit Financiar“. KUB ofron një sërë aktivitetesh të edukimit kurrikular dhe ekstrakurrikular. GVJ duke ju referuar aneksit nr.50, Raporti përmbledhës mbi Aktivitetet në KUB për periudhën 2019-2020, kostatoi se IAL KUB organizon një sërë aktivitetesh me interes për studentët si projekti “Kërkimi im fillon këtu”, Sfidat dhe Perspektivat e Bursës Shqiptare të Titujve me CEO e ALSE apo vizita studimore në Bankën e Shqipërisë. Megjithatë organizon e një sërë aktivitete që ndoshta nuk janë të denja për studentë bachelori apo masteri të ekonomisë si konkurse me Ese & Tregime apo punime me dorë.								
Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Fakulteti Ekonomik si njësi kryesore në bashkëpunim me njësitë bazë të saj prodhon një sërë raportesh vjetore siç janë ai i Analizës për FE-në i aneksit nr.53, raporti i punësimit të studentëve në aneksin nr. 54 apo raporti përmbledhës nga analiza e të dhënave për procesin mësimor në aneksin nr. 57.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit Master Profesional në Ekonomi me 2 profile “Menaxhim Biznesi” dhe “Kontabilitet-Financë” kanë filluar si një riorganizim i Masterave Profesional në “Kontabilitet Financë” dhe në “Menaxhim Biznesi” të cilët kanë pasur një kohëzgjatje 1.5 vite dhe studenti fitonte 90 ECTS. I mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë nr. 80/2015, VKM Nr.41 datë 04.01.2018 dhe Udhëzimi nr. 31 datë 29.12.2017, “Për caktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë”. Programi i studimit të ciklit të dytë Master Profesional në Ekonomizgjat 1 vit akademik, studentët që plotësojnë kriteret përkatëse dhe numrin e krediteve 60 ECTS, sipas Ligjit të Arsimit të Lartë të sipërpërmendur dhe udhëzimeve të lëshuara nga MAS lëshohet diploma Master Profesional në Ekonominë “Kontabilitet Financë” dhe “Menaxhim Biznesi”. Veprimtaria mësimore është e organizuar në 1 vit akademik dhe në 2 semestra. Në hartimin e planit-programeve është aplikuar Sistemi Europian i Trasferimit të Krediteve (ETCS). Sipas Sistemit në fjalë 1 kredit në formimin universitar i korrespondon 25 orë mësimore pune të studentit. Në një semestër studenti mund të marrë si rregull 30 kredite, në një vit 60 kredite.
Kriteri 2 Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	Nga analiza e aneksit 16, GVJ konstaton se Programi i studimit Master Profesional në Ekonomi është një zgjerim i njohurive të fituara në ciklin e parë të studimeve. Programi i studimit në fjalë u ofron studentëve të diplomuar në “Bachelor në Ekonomi” por jo vetëm mundësinë e thellimit të studimeve dhe duke i ofruar ata më afër tregut të punës duke u trasmetuar kompetenca të nevojshme për profesionin e kontabilistit, financierit apo menaxherit.
Kriteri 3 Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të	Programi i studimit Master Profesional në Ekonomi me 2 profile “Menaxhim Biznesi” dhe “Kontabilitet-Financë” synon të krijojë specialistë adaptë për tregun e punës me kompetenca të nevojshme për të punuar si kontabilistë apo si menaxherë, kjo realizohet falë trasmetimit të një sërë njohurive specifike që u ofrohen përgjatë leksioneve studentëve të këtij programi studimi.

fushës.	
Kriteri 4 Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	GVJ konstaton se Programi i studimit Master Profesional në Ekonomi me 2 profile “Menaxhim Biznesi” dhe “Kontabilitet-Financë” është i ndërtuar dhe vjen në formë të përshkallëzuar lidhur me njohuritë që studentët marrin në vazhdimësi të studimeve të tyre pas përfundimit të ciklit Bachelor. Kjo u jep mundësinë atyre të thellojnë edhe më tepër njohuritë duke kaluar në një stad më të avancuar të disa moduleve siç mund të jetë drejtimi financiar i avancuar, kontabiliteti i drejtimit i avancuar. Pra studentët perfeksionojnë njohuritë e tyre dhe asimilojnë njohuri më të thelluara për të kuptuar problemet komplekse që mund të lindin përgjatë zhvillimit të punës së tyre në të ardhmen.
Kriteri 5 Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Programi i studimit Master Profesional në Ekonomi me 2 profile “Menaxhim Biznesi” dhe “Kontabilitet-Financë” ka 60 ECTS për 1 vit akademik. Këto kredite ofrohen me anë të 7 moduleve dhe lëndëve të cilat kanë nga 6 deri në 12 kredite dhe mbrojtja finale e diplomës e cila ka 12 kredite. Struktura e programit dhe elementet përbërës të programit në fjalë gjejnë zbatim në të gjitha kërkesat e Ligjit të Arsimit të Lartë nr. 80/2015; VKM nr.41, datë 04.01.2018 si dhe udhëzimit nr. 31, datë 29.12.2017.
Kriteri 6 Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Programi i studimit Master Profesional në Ekonomi me 2 profile “Menaxhim Biznesi” dhe “Kontabilitet-Financë” ka 60 ECTS për 1 vit akademik. Këto kredite janë të ndara në lëndë/disiplina të cilat ndahen sipas kategorive të përcaktuara nga aktet ligjore. <ol style="list-style-type: none"> 1. Lëndët bazë të kategorisë A përmbajnë 10 % të totalit të krediteve. 2. Lëndët karakterizuese të kategorisë B përmbajnë 30 % të totalit të krediteve. 3. Lëndët ndërdisiplinore/integruese të kategorisë C përmbajnë 30 % të totalit të krediteve. 4. Lëndët plotësuese të kategorisë D përmbajnë 10 % të totalit të krediteve. 5. Detyrimet përmbjllësë të kategorisë E përmbajnë 20% të totalit të krediteve.
Kriteri 7 Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim	Programi i studimit Master Profesional në Ekonomi me 2 profile “Menaxhim Biznesi” dhe “Kontabilitet-Financë” ka 60 ECTS për 1 vit akademik parashikon edhe një stazh 3 mujor me 6 kredite. Kjo praktikë mund të zhvillohet në institucionet publike apo private me të cilat KUB ka marrveshje bashkëpunimi. Mbas përfundimit praktika mbrohet para një komisioni të ngritur nga njësia bazë

sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.	përgjegjëse për programin e studimit në fjalë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	GVJreferuar aneksit 1 kostatoi se KUB është një IAL i licensuar si Institucion i Arsimit të lartë me VKM nr.651 datë 14.09.2011. Në aneksin 3 vërehet Urdhri nr. 557 datë 16.11.2012 i MASH “Për akreditimin institucional të KUB” i riakredituar (aneksi 4) me vendi nr. 100 datë 10.11.2017 të Bordit të Akreditimit. Po ashtu janë të akredituar edhe programet e studimit Bachelor në Ekonomi (aneksi 5). Urdhër nr. 500 datë 18.10.2012 të MASH.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Struktura organizative e KUB mbështet plotësimin e misionit të institucionit. Fakulteti ekonomik si njësi bazë që mbulon edhe programin e studimeve “Master Profesional” në Ekonomi me 2 profile është i organizuar në 3 Departamente. Departamentet përgjegjëse për programin e studimit të Masterit Profesional në Ekonomi janë “Departamenti i Financë Kontabilitetit” dhe “Departamenti i Menaxhimit”.
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.	Nga Aneksi 43, fq.14 GVJ kostatoi se secila prej 3 njësive bazë përkatësisht: Departamenti i Financë Kontabilitetit, Departamenti i Menaxhimit dhe Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës kanë në përbërjen e tyre nga 7 lektorë të angazhuar me kohë të plotë, 3 prej të cilëve gëzojnë tituj ose grada shkencore si dhe 67% e programit të studimit mbulohet nga lektorë të brendshëm. Raporti PAE / PAK është 7/15
Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimeve “Master Profesional” në Ekonomi me 2 profile është “Departamenti i Financë Kontabilitetit” dhe “Departamenti i Menaxhimit”. Departamenti i “Financë Kontabilitetit” ka në përbërjen e tij 7 lektorë efektivë nga të cilët një me titull akademik Prof. Dr, 1 me titull akademik Prof.ass.Dr, 1 me gradën shkencore “Doktor shkencash” 1 pedagog në proces për të përfituar gradën shkencore Doktor shkencash dhe 3 të tjerë me diplomë master shkencor. Departamenti i menaxhimit ka në përbërjen e tij 7 pedagogë

	<p>efektivë nga të cilët 4 janë me gradën shkencore “Doktor shkencash” 2 janë në proces për përfitimin e gradës “Doktor shkencash” dhe 3 pedagogë janë me diplomë master shkencor. Këto departamente kanë edhe 15 pedagogë me kontratë të pjesshme të cilët disponojnë kryesisht tituj dhe grada. Gjithashtu vërehet se në Departamentin e Financë dhe Kontabilitet janë 7 pedagogë më kohë të pjesshme nga të cilët 2 Prof. Dr, 1 Prof. As. Dr. 1 Dr dhe 3 Msc, ndërsa në Departamentin e Menaxhimit janë 8 pedagogë me kohë të pjesshme nga të cilët 1 Prof. Dr, 3 Prof. As. Dr. 3 Dr dhe 1 Msc.</p>			
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe nga informacioni i siguruar nga takimet me drejtues të njësisë kryesore dhe njësisë bazë, rezulton se IAL KUB disponon hapësira laboratorike dhe disponon zyrën e Këshillit të karrierës e cila drejtohej nga staf akademik dhe kish si qëllim ndjekjen e procesit të praktikave profesionale nëkompani të ndryshme.</p>			
<p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>GVJ konstaton nga informacioni i siguruar në takimin me përgjegjësit e departameteve se ishin po ata koordinorë të programit të studimit, si dhe njëri prej mbulonte edhe detyrën e përgjegjësit për zyrën e këshillimit të karrierës dhe përgjegjësit për projektet kërkimore dhe kërkimin shkencor.</p>			
<p>Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.</p>	<p>GVJ nga takimet në IAL KUB konstatoi se Koordinator i programit në “Kontabilitet Financë” ishte edhe përgjegjës i njësisë baze ishte edhe Zv. Dekan për procesin mësimor. Ky Koordinator dokumentonte gjithë procesin mësimor dhe informonte në mënyrë direktë drejtuesin e njësisë kryesore, Dekanin e Fakultetit Ekonomik.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.3

Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ nga verifikimi i dokumentacioni dhe nga informacioni i marrë përgjatë takimeve në IAL KUB kostatoi se Njësia kryesore, Fakulteti Ekonomik dhe Njësitë bazë, Departamenti i Menaxhimit dhe ai i Kontabilitet-Financë dispononin informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ nga aneksi nr. 20 i cili përmban planin mësimor dhe syllabuset kostatoi se plani mësimor i Programit të studimit Master Profesional në Ekonomi, është i organizuar sipas VKM-së nr. 41, datë 04.01.2018. Lëndët dhe modulet janë klasifikuar sipas peshës specifike të secilës në kredite dhe në varësi të formimit (bazë, karakterizues, ndërdisiplinor/integrues dhe përmbyllëse).</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në Ekonomi, realizohet me 60 ECTS për një vit akademik. Këto kredite shpërndahen në 2 semestra, dhe 8 lëndë/disiplina të cilat përfshijnë edhe praktikën profesionale dhe mbrojtja e tëmës finale e cila ka 12 kredite dhe mbrohet në fund të ciklit të studimeve.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Program i studimit Master Profesional në Ekonomi, përmban 60 ETCS, çdo ETCS i korespondojnë 25 orë mësimore pune të studentit nga të cilat 7 orë janë frontale në klasë ndërsa pjesa e ngelur është studim individual. Sasia mesatare e punës së kryer përgjatë një viti studimesh universitare nga një student është 60 ETCS që korespondojnë me 1500 orë mësimore pune të studentit. Nga të cilat 420 orë janë në auditorë pjesa tjetër është studim individual. Proçedurat e vlerësimit në Fakultetin e Ekonomisë janë të miratura nga Njësia bazë. Nga diskutimet me studentët në klasë GVJ u informua se pedagogu në momentin e prezantimit të lëndës informon studentët edhe me mënyrën e vlerësimit.</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>GVJ kostatoi se për t'u pranuar në Programin e studimit Master Profesional në Ekonomi, studentët duhet të zotërojnë minimalisht diplomën universitare "Bachelor" dhe të kenë grumbulluar 180 ECTS.</p> <p>Në programet Master profesional pranohen studentët që kanë përfunduar Bachelor në Shkenca Ekonomike apo në programe të ngjashme në Ekonomi ata duhet te dorëzojnë listën e notave, suplementin e diplomës. Po ashtu mund të pranohen studentë që</p>

	<p>kanë përfunduar studimet në fushën ekonomike në një universitet jashtë territorit të Shqipërisë por të ekuivalentuar nga MASR. Pranohen gjithashtu edhe studentë që transferojnë studimet universitare të ciklit të dytë nga IAL të tjera qofshin këto publike apo private por që vërtetojnë me dokumentacion zyrtar këtë gjë.</p> <p>GVJ kostatoi (aneksi 22) se Fakulteti Ekonomik i IAL KUB disponon një komision i cili merret me ekuivalentimit e programeve mësimorë të studentëve që vijnë me transferim.</p>			
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Nga takimi me studentët GVJ kostatoi se çdo student informohet me syllabusin e lëndës i cili është standart sipas VKM 41/2018. Studentëve u vihet në dispozicion programet për çdo lëndë dhe u jepet informacion mbi planin mësimor mbi lëndët që janë të detyrueshme dhe ato që janë me zgjedhje. Studentët afirmuan se marrin gjithmonë informacion në lidhje me programet apo syllabuset dhe formatet e vlerësimit.</p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Nga analizimi i Syllabuseve të lëndëve që përmban programi i ciklit të dytë të studimeve Master Profesional në Ekonomi me 2 dy profile: në “Menaxhim Biznes” dhe ai në Kontabilitet Financë”, GVJ konstatoi se një pjesë e syllabuseve kishin literaturë të vjetëruar. Megjithatë përgjatë takimeve në Institucion me stafin GVJ u informua se ka pasur rishikime të vazhdueshme të lëndëve apo moduleve të cilat ecnin në sinkron me zhvillimet ekonomike të fundit.</p> <p>GVJ kostatoi gjithashtu nga materialet e dorëzuar nga IAL KUB (Syllabusi i MB, fq.14) se lënda qeverisje korporatash kishte si literaturë kryesore të njëjtën gjë që kishte edhe lënda kontabilitet kosto drejtimi.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të nxënies, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me</p>	<p>Ngarkesa e programit të ciklit të dytë studimor Master Profesional në Ekonomi është e strukturuar në leksione seminare dhe praktika profesionale me ngarkesën përkatëse nëpër kredite.</p>

parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Programi në fjalë është konform me kuadrin ligjor në fuqi, Ligjin e Arsimit të Lartë nr. 80/2015 dhe VKM nr. 41/2018.
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve.	Emërtimi i programit të studimit Master Profesional në Ekonomi është në përputhje me nivelin e kualifikimit të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit. Falë programit mësimor dhe emërtimit të qartë të diplomuarit marrin një formim koherent me atë çfarë kërkon tregu i punës dhe e kanë më të thjeshtë gjetjen e një pozicioni pune.
Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të prishme të nxënimit dhe aftësimin profesional.	Hartimi i kurrikulës së programit mësimor të ciklit të dytë të studimeve në Master Profesional në Ekonomi ka vlerësuar me rigorozitet njohuritë që kërkon tregu i punës. Kurrikula është e balancuar dhe ajo i ndanë lëndët në: lëndë të formimit bazë, në lëndë karakterizuese, në lëndë ndërdisiplinore dhe integruese të profilit, në lëndë plotësuese të praktikës profesionale. Si dhe në përgatitjen e diplomës finale. Përfshirja e lëndëve të kontabilitetit të theluar apo përfshirja e praktikës profesionale u jep mundësi studentëve që jo vetëm të marrin njohuritë kryesore të nevojshme që kërkon tregu i punës por e bënë edhe më të thjeshtë integrimin e tyre në tregun e punës.
Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teoripraktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	GVJ nga revizimi i dokumentacionit dhe nga informacioni i marrë nga drejtuesit e njësisë bazë kostatoi se programi i studimit Master Profesional në Ekonomi është fokusuar kryesisht në dhënie të njohurive të nevojshme për tregun e punës dhe për kërkim shkencor. Pjesa dërmuese e stafit akademik në këtë program studimor kishin pas një të kaluar në institucionet publike apo private si specialist apo drejtues, kjo e bën më të thjeshtë kombinimin e njohurive teorike me ato praktike. Si dhe GVJ kostatoi se për të realizuar këtë program studimor drejtuesit e njësisë bazë, Fakulteti Ekonomik i KUB kish përdorur si bazë programe të suksesshme të ofruara nga IAL-të në Shqipëri dhe në vendet e tjera të rajonit.
Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	GVJ referuar aneksit 20 kostaton se plani mësimor është i organizuar në lëndë bazë të programit të studimit, lëndë karakterizuese të programit, lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese lëndë plotësuese dhe detyrime përmbyllëse, ky balancim i planit mësimor u jep mundësi studentëve të marrin një informacion të harmonizuar dhe të plotë në fushat respektive të studimit (Kontabilitet Financë apo Menaxhim Biznesi). GVJ kostatoi se KUB ka një marrveshje aktive erasmus megjithatë asnjë student nuk ka përfituar nga kjo mundësi. Nga takimet me studentët GVJ kostatoi se stafi akademik së bashku me zyrën e këshillimit të karrierës i ndihmojnë ata të alokohen në tregun e punës.

<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p><i>GVJ nga vëzhgimi i syllabuse kostatoi se literatura e përdorur është shumë e vjetër në disa lëndë. Kostatoi po ashtu se nëprogramin e studimit në Ekonomi profili menaxhim biznesi kishte lëndë të ndryshme që përdorin literaturë të njëjtë (Kontabilitet Kosto-Drejtimi me Qeverisje Korporatash).</i></p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë të studimeve Master Profesional në Ekonomi, nëpërmjet njohurive të thelluara dhe duke zgjedhë lektorë me eksperiencë në institucionet publike dhe private e bën të mundur trasmetimin e njohurive dhe aftësive të nevojshme për tregun e punës.</p>			
<p>Kriteri 8. Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë të studimeve Master Profesional në Ekonomi, është i organizuar në mënyrë të tillë që të trasmetojë njohuri të thelluara teorike dhe praktike. Studentët e këtij programi studimor kanë mundësi të marrin një formim të thelluar profesional për kontabilitetin dhe menaxhimin.</p>			
<p>Kriteri 9. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë të studimeve Master Profesional në Ekonomi është i orientuar nga tregu i punës. Ky program u jep mundësinë studentëve të punojnë në zyra kontabile, në instiucionet e administratës publike të cilat kanë në fokus kontabilitetin. U jep po ashtu mundësi të punojnë si menaxherë biznesesh.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi II.5 Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Fakulteti ekonomik ka në përbërjen e tij 3 departamente. Departamentet përgjegjës për programin e studimit të ciklit të dytë Master profesional në Ekonomi janë Departamenti i Financë Kontabilitetit dhe ai i Menaxhimit. I pari ka 7 lektorë efektivë nga të cilët një me titull akademik Prof. Dr, 1 me titull akademik Prof.ass.Dr. 1 me gradën shkencore “Doktor shkencash” 1 pedagog në proces për të përfituar gradën shkencore Doktor shkencash dhe 3 të tjerë me diplomë master shkencor po ashtu ka edhe 7 lektorë të ftuar të cilët disponojne kryesisht tituj akademikë dhe grada shkencore. Departamenti i menaxhimit ka</p>

	<p>në përbërjen e tij 7 pedagogë efektivë nga të cilët 4 janë me gradën shkencore “Doktor shkencash” 2 janë në proces për përfitimin e gradës “Doktor shkencash” dhe 3 pedagogë janë me diplomë master shkencor. Ky departament ka po ashtu edhe 8 pedagogë me kontratë të pjesshme të cilët disponojnë kryesisht tituj dhe grada.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>GVJ në aneksin 29 kostatoi se pjesë e stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme që jep në Masterin profesional në Ekonomi janë të paktën 2 prof.dr (një i brendshëm dhe një i ftuar) dhe 2 prof.ass (një i brendshëm dhe një i ftuar) të cilët përveç titujve akademikë disponojnë dhe kompetenca të rëndësishme nga pikpamaja profesionale. Kjo kostatohet qartë nga cv-të e stafit akademik në fjalëtë cilat gjenden në aneksin 29.</p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>GVJ kostatoi se pjesa dërmuese e lektorëve të Masterit profesional në Ekonomi janë të kategorisë Profesor, Profesor i Asociuar, Doktor shkencash me kontribute në fushën akademike dhe Asistentë lektorë me diplomë Master Shkencor me një eksperiencë të gjatë edhe si specialist në institucionet private apo publike si kontabilist, financierë apo auditues.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ kostatoi se IAL KUB disponon një model raporti për praktikën mësimore (aneksi 52). Gjithashtu nga bisedat me studentët GVJ u informua se studentët që kishin përfunduar edhe Bachelor në të njëjtin IAL ishin djekur për tezën finale nga lektorët e brendshëm të KUB dhe kishin pasur një komunikim të vazhdueshëm me pedagogët. Si dhe IAL KUB ka një sërë marrveshjesh me Institucione publike apo private për të suportuar studentët për praktikat profesionale.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe bashkëpunim me ndihës lektor. Po ashtu kostatoi se KUB</p>	<p>GVJ kostatoi se disa prej lëndëve/moduleve jepeshin në bashkëpunim me ndihës lektor. Po ashtu kostatoi se KUB</p>

garanton angazhimin e personelit ndihmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	dispononte dhe laboratë informatik shumë modern ku u informua nga stafi i KUB se në këta laboratorë studentët ndiqeshin nga persona përkatës të cilët asistonin studentët për orët e caktuara të informatikës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	GVJ nga bisedat e bëra më stafin kostatoi se ata janë në kontakt të vazhdueshëm me shoqata të ndryshme biznesi si IEKA, KKK apo Konfindustria Italiane ne Shqipëri, apo biznese si TITAN Group, Albsig sh.a kompani auditimi etj. Lektorët në varësi të kërkesave të kompanive marrin në konsideratë edhe përditësimet e lëndëve dhe informacionet që u transmetojnë studentëve. MegjithatëGVJ kostatoi po ashtu se literatura e përdorur ishte shumë e vjetër. Kjo gjë deri diku nuk reflektonte afirmimet e tyre.
Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.	GVJ ka kostatur se KUB ka një qeveri studentore http://kub.edu.al/qeveria-studentore/ po ashtu nga statuti i KUB (shkëputur nga faqja online e institucionit) në nenin 17, pika 2, cilësohet se studentët përfaqësohen në senat me 1 anëtar. Ky anëtar vjen nga këshilli studentor, i cili në statut shtjellohet në nenin 73). 1 student me të drejtë votëedhe pjesë e NjësisësëSigurimit të Brendshëm tëCilësisë (aneksi 61, 62). GVJ u informua nga Studentët se ata herë pas herë plotësojnë pyetësorë për cilësinë e mësimdhënies dhe mendimet e tyre merren në konsideratë nga stafi akademik (aneksi 56, 58).
Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.	GVJ nga komunikimet me stafin dhe studentët u informua se KUB ka edhe një zyrëAlumni http://kub.edu.al/alumni-tesuksesshem/ e cila ruan raportet me studentët e diplomuar për të monitoruar procesin e integritetit të tyre në tregun e punës. Po ashtu IAL KUB ka një zyrë këshilli karriere e cila orienton studentët drejt tregut të punës dhe mban statistika rreth punësimit të tyre.

Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi.	KUB përgatit raporte të studimit të tregut për tu orjentuuar kush janë tendencat e reja të punësimit edhe pse GVJ kostatoi se këto raporte ishin në nivel makro dhe të përgjithshëm. GVJ u informua nga stafi drejtues se ata ruanin raporte me istitucione publike dhe private të ndryshme me të cilët diskutonin edhe për argumentet që duhet të trajtonin në master apo kompetenca të reja që duhet të kenë burimet njerëzore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	GVJ përgjatë takimeve në institucion u informua nga stafi akademik se me fillimin e pandemisë Covid-19 ata krijuan paketën udhëzuese për zhvillimin e procesit mësimor online (aneksi 42). Ata po ashtu informuan GVJ-nëse kërkojnë në mënyrë të vazhdueshme të ndryshojnë mënyrën e mësimdhënies dhe ta bëjnë atë sa më tërheqëse për studentin dhe njëkohësisht të nevojshme për të. Po ashtu për vlerësimin e studentëve përdornin edhe detyra kursi të caktuara që stimulonin kreativitetin e studentit.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	IAL KUB ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila bën monitorime të vazhdueshme për cilësinë e mësimdhënies (aneksi 61). NJSBC kontrollon po ashtu procesin e zhvillimit të provimit (aneksi 60). Ky komision merret edhe me monitorimin dhe vlerësimin e procesit mësimor. Pyetësorët e shpërndarë prej tij shërbejnë edhe për të marrë informacion mbi vlerësimin e procesit mësimor nga ana e studentëve për një simestër (aneksi 58). Të dhënat e mbledhura grumbullohen në një raport që gjeneron NJSBC për procesin mësimor përgjatë një viti akademik (aneksi, 57).
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	NJBSC ka në fokus studentin, pjesa dërmuese e raporteve të gjeneruara nga ky komision vijnë pikërisht nga vlerësimet e vazhdueshme që japin studentët për pedagogët, për programin e studimit apo për programet ekstrakurrikulare. KUB edhe përgjatë periudhës kur mësimi u zhvillua online përsëri kishte organizuar një pyetësor për vlerësimin e mësimin online (aneksi 56) me anë të së cilit kërkonte të mblidhte informacion nga studentët mbi korrektësinë e orarit të pedagogëve, mënyrën e shfrytëzimit të kohës etj.
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	GVJ u informua nga drejtuesit e Fakultetit të Ekonomisë se në përfundim të çdo semestri NjBSC gjeneron raportet mbi analizat cilësore dhe sasiore të opinionëve të studentëve, ky raport i paraqitet fillimisht Rektorit e në vijim bëhet publike për të gjithë.
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të	GVJ u informua se rezultatet e NjBSC përdoren edhe si formë për të evidentuar problemet e mësimdhënies e në vijim përdoren për të inkurajuar personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimnxënies.

praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.				
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Nga syllabuset e lëndëve të programit Master Profesional në Ekonomi dhe nga bisedat me studentët, GVJ kostatoi se lëndët janë të balancuara ndërmjet leksioneve (aspektit teorik të mësimdhënies) dhe seminarëve (aspektit praktik). Po ashtu në vlerësimin përfundimtar merreshin në konsideratë dhe detyrat e kursit apo punët në grup. Nga diskutimi me studentët nuk rezultuan të ishin bërë projekte apo ese mbi argumenta të caktuar. Nga rishikimi i listës së aktiviteteve të zhvilluara nga KUB përgjatë vitit akademik 2019-2020 (aneksi 50) vërehet se janë zhvilluar edhe leksione të hapura me personalitete të ndryshme.
Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.	GVJ kostatoi se personeli akademik ndiqte studentët përgjatë punimit të diskutimit final të temës. Nga diskutimi me studentët rezultoi se ata ishin të predispozuar ti ndihmonin dhe ti mbështesnin ata. Megjithatë studentët nuk kishin informacion në lidhje me forma të tjera apo mundësi alternative të mësimdhënies dhe mësimnxënies për studentë më kërkesa të veçanta. Po ashtu studentët afirmuan se: gjatë mësimdhënies përdoren mënyra alternative si Power Point, biseda interaktive me studentët, apo tema të veçanta të sjella nga studentët dhe diskutimi i tyre. Stafit akademik asiston dhe ndihmon studentët në zgjidhjen e problematikave të ndryshme që mund t'ju dalin gjatë zhvillimit të mësimin ose praktikës.
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të	Nga vizita në Institucion GVJ kostatoi se infrastruktura e klasave ishte shumë konforme për të përdorimin e metodave të ndryshme pedagogjike. Laboratorët e informatikës kishin të instaluar programet aplikativ që përdoren gjerësisht në fushën e

mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	kontabilitetit. Nga bisedat me stafin rezultoi se IAL KUB nuk pengonte lektorët në ndjekjen e trajnimeve shkencore. IAL po ashtu herë pas here financonte edhe pjesmarrjen e stafit për pjesmarrjen e konferencave shkencore që ndihmonin stafin për të përmirësuar kompetencat e tyre didaktike.			
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	Nga vizita që pati GVJ te zyra e burimeve njerëzore dhe nga kontrolli kazual i dosjeve të lektorëve, kostatoi se dosjet kishin formatin në rend sipas aneksit 28, pjese e stafit akademik të KUB ishin të mirë arsimuar, me tituj dhe grada dhe me trajnime mbasuniversitare. Stafi afirmoi se në mënyrë të vazhdueshme ata merrnin informacion për metodat më të mira të mësimdhënies. Për të bërë mësimin sa më tërheqës për studentët stafi përdor metoda interaktive mësimdhënie siç janë leksionet e hapura të zhvilluar nga lektorë të ftuar gjatë procesit mësimor.			
Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Pjesa dërmuese e raporteve të gjeneruara nga NJBSC vijnë nga vlerësimet e vazhdueshme që japin studentët për pedagogët, për programin e studimit apo mënyrën e mësimdhënies. KUB edhe përgjatë periudhës kur mësimi u zhvillua online përsëri kishte organizuar një pyetësor për vlerësimin e mësimit online (aneksi 56) me anë të së cilit kërkonte të mblidhte informacion nga studentët mbi mënyrën e shpjegimit organizmit të leksionit etj.			
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	GVJ duke ju referuar aneksit 20, intervistave me pedagogët të cilët janë përgjegjës dhe dorëzojnë syllabuset në KUB, si edhe intervistave me studentët e këtij kolegji, konstatoi se tematikat e prezantuara në syllabuse trajtohen kryesisht sipas metodave tradicionale të mësimdhënies (shpjegim në drasë plus prezantime me ppt).			
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	GVJ duke u bazuar te intervistat me studentët kostatoi se frekuentimi i leksioneve për ta ishte i rëndësishëm, megjithatë ata afirmuan se materialet didaktike mund ti merrnin edhe me anë të emailit në të tilla kushte studentët mund të mësonin edhe në mënyrë autonome një lëndë pa pasur nevojën e ndjekjes së leksionit në klasë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Nga vizita në institucion GVJ kostatoi se IAL KUB ushtron aktivitetin e mësimdhënies në Rr. Vangjel Noti”, nr. 25, Laprakë Tiranë, ambientet ishin të pastra komode dhe funksionale. Klasat ishin të gjitha të pajisura me infrastrukturën e nevojshme didaktike për të zhvilluar leksionet. Ambienti jashtë ndërtesës ishte relativisht shumë i vogël dhe nuk u jepte mundësi studentëve për të ulur dhe diskutuar me njëri-tjetrin megjithatë kish një bar-kafe në ambientet e shkollës i cili kishte hapësira të mjaftueshme për studentët apo stafin akademik.</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.</p>	<p>Nga vizita në institucion GVJ kostatoi se auditorët ishin me hapësira relativisht të mëdha, të gjitha të pajisura me projektorë dhe dërrasë, të pajisura po ashtu me sistem ngrohës-ftohës. Gjithashtu IAL KUB kishte laboratorë informatike me shumë postacione për të zhvilluar leksion për grupe me 20-25 studentë, një bibliotekë ku studentët mund të lexonin dhe të merrnin libra për të studiuar.</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>IAL KUB zhvillon aktivitetin në 2 ndërtesa të cilat ishin afër me njëra tjetrën, te të dyja ndërtesat kishte laboratorë informatike me rreth 25 postacione secili.</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Përgjatë qëndrimit në IAL KUB, GVJ vizitoi edhe bibliotetën dhe ju demonstrua edhe mënyra e kërkimit dhe gjetjes së literaturës në database në formatin elektronik e cila mund të përdorej si literaturë ndihmëse për studimin e tematikave të caktuara që trajtoheshin në auditorë.</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet</p>	<p>Nga vizita në bibliotekë GVJ kostatoi se kishte mjaftueshëm tekste librash të cilat ishin si literaturë bazë në disa prej syllabuseve të programit Master Profesional në Ekonomi.</p>

<p>kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>GVJ përgjatë vizitës në IAL KUB pati mundësinë të shikonte se çdo student kishte akses falas në librarinë elektronike. Biblioketa online po ashtu ishte relativisht shumë e pasur me libra http://kub.edu.al/biblioteka-elektronike/ IAL KUB kishte abonim edhe te biblioteka elektronike questia e cila ishte ne dispozicion të të gjithë studentëve dhe stafit akademik https://www.questia.com/ në të cilën mund të gjendeshin libra dhe artikuj shkencorë si dhe literaturë e përditësuar për argumente të ndryshme ekonomike.</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Nga bashkëbisedimi qëGVJ pati me studentët, ata afirmuan se ishin në dijeni të laboratorëve informatikë dhe se në kompiuterat e këtyre laboratorëve gjendeshin programe aplikativë të cilët ishin të nevojshëm si për përgatitjen e lëndëve të caktuara si për të pasur më tepër mundësi punësimi në të ardhmen. Megjithatëpjesa dërmuese e tyre nuk para i frekuentonin pasi ishin shumë të angazhuar me leksionet ose me punë.</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Me fillimin e pandemisë Covid-19 KUB kishte vënë në funksion portalin KUB. Një portal që jepte mundësi për të zhvilluar mësimin online ku lektorët mund të identifikoheshin dhe të karikonin dhe publikonin leksionet, apo materialet e nevojshme për procesin mësimor. Me anë të platformës Google Meet lektorët dhe studentët kishin mundësi të zhvillonin mësim në distancë dhe të bënin konsultime në distancë.</p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Nga takimet që GVJ pati me studentët dhe stafin akademik rezultoi se të gjithë i përdornin sistemet e komunikimit të brendshëm dhe përdornin dokumentacionin elektronik. Si dhe të gjithë pedagogët kishin hapësirë vetjake të dedikuar virtuale ku ata mund të karikonin materiale të caktuar në funksion të mësimdhënies.</p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>GVJ nga bisedat me studentët kostatoi se personeli akademik ishte shumë bashkepunues përse i përket zhvillimit të temave të diplomave ata jepnin sugjerime si për zgjedhjen e argumentave si për zhvillimin e temave të diplomave.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë nr. 80/2015 (neni 103); VKM nr. 531, dt. 11.09.2018 (Kodi i Cilësisë) dhe statutin institucional (Kreu IX) të KUB, si edhe duke iu referuar aneksit 55 (rregullorja e NjSBC e KUB) konstatohet se është ngritur struktura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë dhe janë parashikuar rregullat e procedurat për funksionimin e saj. GVJ duke ju referuar anekseve nga 55-62 kostatoi një sërë dokumentet tip për marrjen e mendimeve të studentëve për mësimdhënien dhe cilësinë e mësimdhënies megjithatë GVJ e pati të pa mundur të evidentonte nëse realisht raportet e NjSBC përdorshin në vijim në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	GVJ kostatoi përgjatë takimeve me stafin akademik, administrativ dhe studentët se ata komunikojnë në mënyrë të vazhdueshme për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe se stafi akademik komunikonte me studentët për cilësinë e programeve mësimore.
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	GVJ kostatoi se përgjatë pandemisë KUB brenda dy javësh arriti të mundësonte mësimdhënien në distancë. Përtej kësaj GVJ nuk kostatoi ndonjë fakt tjetër për zhvillimin e metodave inovative të mësimdhënies.
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	GVJ nga analiza e CV të stafit akademik (aneksi 29) kontrolli i dosjeve në zyrën e burimeve njerëzore dhe nga lista e publikimeve kostatoi se stafi akademik i FE të KUB ka punuar shumë pak përsa i përket kërkimit shkencor. Gjithë stafi kishte bërë shumë pak publikime në 4 vitet e fundit.
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe	GVJ nga ispektimi i dokumentacionit të karikuar nga IAL KUB në portalin e ASCAL, nga vizita në institucion, takimet me personelin akademik dhe administrativ nuk kostatoi se stafi ishte trajnuar për implementimin e metodave të reja në vitet e fundit.

implementimit të metodave të reja.									
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Siç u përmend më lartë GVJ nuk kostatoi se personeli akademik apo ai ndihmës akademik kish bërë trajnime në vitet e fundit për implementimin e metodave të reja.								
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	GVJ përtej procesit të mësimdhënies online përgjatë pandemisë Covid-19 nuk kostatoi se testoheshin metoda të reja në mësimdhënie apo të analizoheshin efektet e pritshmërisë në raportimet periodike.								
Kriteri 8. Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.	GVJ referuar aneksit 46 (mobiliteti Erasmus), aneksit 34 dhe 38 (marrëveshjeve me institucionet homologe), sikurse edhe intervistave me stafin akademik, rezulton se nuk kish pasur mobilitet të stafit akademik si në hyrje (lektorë të huaj që japin mësim në KUB) si në dalje (lektorët e KUB) që shkojnë si visiting në një Universitet të huaj. Po ashtu GVJ kostatoi se IAL organizon leksione të hapura me ekspertë të fushave për tema të ndryshme duke ndarë eksperiencën e tyre me studentët.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga	GVJ referuar aneksit 16 mbi “Rregulloren e programit të studimit në Master Profesional në Ekonomi në Menaxhim Biznes”, neni 10, fq.4 afirmohet se provimet realizohen në shkrim, me gojë ose në mënyrë të kombinuar. Vlerësimi bëhet me pikë nga 0-100 dhe me notë nga 4 (katër) deri në 10 (dhjetë) pika 3 e nenit 10 afirmon se vlerësimi i përgatitjes akademike të

studentët.	studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm.			
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga takimi me studentët GVJ po ashtu kostatoi se studentët njiheshin me formën e vlerësimit që në ditën e parë që fillonte moduli/lënda. Nga takimi me pedagogët u pohua se syllabusi shpërndahet në masën 100% tek studentët.			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	GVJ kostatoi nga syllabuset e përfshira në programet e aplikuara për akreditim, se vlerësimi në çdo lëndë bëhet me anë me detyrave të kursit për të ballafaquar kompetencat dhe aftësitë e fituara me aplikimin e tyre në praktikë, testim i ndërmjetëm (kolegium) si dhe vlerësim në provimin final.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	<p>Për vlerësimin e këtij kriteri, GVJ iu referuar kryesisht Aneksit 20 të depozituar në ASCAL, intervistave me pedagogët që lëvrojnë syllabuset në KUB, si edhe intervistave me studentët e këtij kolegji. Nga syllabuset e depozituara konstatohet se pothuajse të gjitha lëndët e lëvruara kanë një strukturë vlerësimi:</p> <p>a) 20% frekuentimi; b) 20% testim sezonal dhe detyra kursi; c) testim përfundimtar me shkrim 60%.</p> <p>Nga intervistat me pedagogët dhe studentët u konfirmua verbalisht një sistem i tillë vlerësimi.</p>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të	Për vlerësimin e këtij kriteri, GVJ iu referua rregulloreve të programeve të aplikuara për akreditim (aneksi 15 & 16), intervistave me pedagogët, studentët, si edhe tentoi të konsultojë aneksin mbi rregulloren e provimeve dhe atë mbi platformat online

<p>ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>(anekset 35 & 36 të depozituara në ASCAL). Dokumentet shkresore të konsultuara i referoheshin anekseve 35 & 36, por këto dokumente mungonin në setin e dokumenteve të depozituara në ASCAL.</p> <p>Për të bërë një vlerësim të drejtë dhe objektiv, GVJ iu drejtua faqes zyrtare online të KUB, me synimin për të konsultuar rregulloren e provimeve dhe rregulloren e platformave online. Në këtë faqe nuk u gjet e publikuar rregullorja e provimeve, por statuti institucional (i cili nuk është përfshirë në setin e dokumenteve të depozituara në ASCAL) dhe platforma e mësimdhënies online. Statuti ishte i aksesueshëm, por jo i shkarkueshëm, ndërsa platforma e mësimdhënies online nuk ishte e aksesueshme.</p> <p>Nga intervistat dhe vizita në institucion, u konstatua se infrastruktura hard dhe soft për mbështetjen me sisteme elektronike dhe kompjuterike të mësimdhënies ishte e plotë, përditësuar dhe përmirësuar edhe për shkak të pandemisë. Po kështu edhe studentët u shprehën të kënaqur për cilësinë e përdorimit të këtyre platformave përgjatë pandemisë.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Për vlerësimin e këtij kriteri, GVJ tentoi t'i referohej rregullore për zhvillimin e provimeve (aneksi 35), e cila, sikurse u citua nëkriterin më lart, nuk gjendet në dokumentacionin e ngarkuar nga institucioni në ASCAL dhe nuk u gjet as në faqen zyrtare online të institucionit.</p> <p>Nga shqyrtimi i procesverbaleve të provimeve nësekretarinëmësimore të institucionit, konstatohet se këto procesverbale firmosen vetëm nga një person (titullari i lëndës), përveç firmave procedurale që ishin ajo e dekanit (jo përgjegjësit të departamentit) dhe e sekretares.</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimin të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Për vlerësimin e këtij kriteri, GVJ tentoi të konsultojnë rregulloren e provimeve, por pa sukses (shih më lart), si edhe intervistuan pedagogët, studentët dhe vizituan sallat e provimeve e sekretarinë mësimor. Nga inspektimi në sallat e provimeve u konstatua infrastrukturë e përshtatshme për monitorimin dhe survejimin e testeve. Sallat e provimeve nuk ishin të pajisura me kamera, ndryshe nga mjediset e tjera (si: hollet, sheshet, etj).</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të</p>	<p>Për vlerësimin e kriterit, GVJ u përpoq të konsultonin rregulloren e provimeve, por nuk mundën. Gjithashtu, nga intervistat me studentët u pohua se pedagogët komunikojnë dhe i ndihmojnë në procesin mësimdhënës dhe testues. Nga pedagogët u pohua verbalisht procesi interaktiv i mësimdhënies, sikurse edhe ndihma për të arritur rezultate të larta nga studentët.</p>

nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.									
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Nga takimet me pedagogët dhe vizita në institucion nuk u konstatua disponimi dhe përdorimi i një programi kompjuterik antiplagjiaturë. Për shkak të mungesës së disponimit të rregullorës nga ana e GVJ, nuk u konstatua edhe ekzistenca dokumentare e saj (platformës antiplagjiaturë).								
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Nga intervistat me studentët dhe pedagogët, sikurse edhe vizita në sekretarinë mësimore, procedura e raportimit dhe dokumentimit të vlerësimit në regjistrat përkatës duket e rregullt në pikëpamje kohore.								
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Edhe për këtë kriter, i cili ezaurohet shkresërisht në rregulloren e provimeve, GVJ nuk u njoh me aneksin 35 që duhet të ishte vënë në dispozicion të grupit. Nga takimet me studentët, ata u shprehën se nuk ekzistojnë problematika në lidhje me njohjen e vlerësimit dhe rishikimin e tij sipas kërkesave.								
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Përveç mungesës së rregullore së mësipërme, në dispozicion të grupit nuk u vunë nga pedagogët dhe/ose sekretaria mësimore dosje studentësh që mbartnin trajtimin e çështjeve të tilla.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td>X</td> <td></td> <td></td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		X		
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
	X								

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të	Për vlerësimin e këtij kriteri, GVJ iu referuan anekseve 15 & 16 që përmbanin rregulloren e programeve të aplikuara për akreditim nga ana e institucionit. Po kështu, u konsultua aneksi 19 (studimi i tregut për programet), aneksi 20 (kurrikula, plani mësimor dhe syllabusët e programeve) dhe aneksi 54 (raporti i

studentëve.

punësimi të studentëve). Nga sa më lart, referuar të dhënave të përmbajtura në aneksin 20, rezulton se programi i studimit realizohet përmes një literature që përdoret gjerësisht në nivelin Bachelor, ndërkohë që programi është i nivelit Master Profesional. Në mjaft raste, dokumentet e ngarkuara në ASCAL mbartnin gabime materiale dhe të përhapura në informacionin që jepnin për syllabuset. U konstatuan raste kur një syllabus përmbante si literaturë të detyrueshme libra të një disipline tjetër. Po kështu, disa lëndë që në plan mësimor ishin të kategorisë B ose C, në syllabus klasifikoheshin ndryshe, pra i përkisnin një kategorie tjetër. Po kështu, lëndë të cilat sipas planit mësimor planifikoheshin të realizoheshin në semestrin e I, në syllabus parashiheshin për t'u zhvilluar në semestrin II dhe anasjelltas. Së fundmi, duke iu referuar totalit të krediteve që i përkisnin një kategorie lëndësh (A, B dhe C) u konstatuan mospërputhje midis nivelit minimal dhe maksimal që përcaktojnë aktet nënligjore dhe nivelit të parashikuar në planet konkrete mësimore. Duke iu referuar anekseve 15 & 16, objektivi i programeve sipas dokumenteve përkatës formulohej si: “ ... t’u jepen studentëve njohuri të thella dhe specifike ... në fushat e veprimtarisë së Shërbimeve Inteligjente dhe atyre Policore në sistemet demokratike” (kreu II, neni 3, pika 1). Në vijim: “ ... programi synon dhënien e një tërësie njohurish ... në kuadër të parandalimit të krimit transnacional dhe përbalimin me sukses të sfidave ndaj krimit të organizuar” (kreu II, neni 3, pika 2). Së fundmi: “Programi synon ... aftësimin e specialistëve për vazhdimin e studimeve të mëtejshme të ciklit të tretë në të njëjtën fushë.” (kreu II, neni 3, pika 3). Duke iu referuar aneksit 19, studimi i tregut është realizuar me të dhëna dytësore, pra studim i një kompanie të pakontraktuar nga institucioni dhe në nivel makro, pra jo për nevojat specifike të institucionit. Ky studim nuk prononcohet për përzgjedhjen e programeve të studimit në mënyrë të tillë që të argumentojë thellimin e njohurive në disiplina të caktuara dhe zhvillimin e aftësive profesionale në përputhje me tregun. Në programe të tilla si këto për të cilat ka aplikuar institucioni për akreditim, testi i vërtetë i dijes është tregu. Referuar aneksit 54, institucioni pohon se 90% e studentëve të tij janë të punësuar, pra njohuritë e ofruara nga këto programe garantojnë zhvillimin e aftësive në përputhje me tregun. Në përfundim, literatura e përdorur për thellimin e dijeve dhe zhvillimin e aftësive profesionale është e vjetër, e papërditësuar, e përkthyer ose importuar nga libra të huaj dhe deri diku e përshtatur me realitetin shqiptar. Nga intervistat me pedagogët dhe stafin që ka përgatitur RVB-

	në, keqklasifikimet e mësipërme u pranuan si lapsuse dhe u premtua ringarkimi i dokumenteve të rregullta në ASCAL.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Kurrikula e programeve (aneksi 20) përmban lëndë të disiplinave të ndryshme. Në dokumentet e ngarkuara në ASCAL, programi për “Menaxhim Biznesi” përmban lëndët që i përkasin programit për “Kontabilitet-Financë” dhe anasjelltas. Në takimin me institucionin, GVJ e vunë në dukje një fakt të tillë dhe kërkuan korrigjimin e materialeve të ngarkuara në ASCAL, për një referencë të duhur shkresore. Duke e marrë për të mirëqenë pranimin verbal të ngatërrimit nga ana e institucionit, konstatohet se në mjaft lëndë të të dyja kurrikulave, ku mund të përdoret me përparësi teknologjia e informacionit për aksesim, grumbullim, përpunim, analizim, konkludim, raportim dhe paraqitje vizuale të çështjeve të ndryshme, asnjë temë syllabusesh nuk parashikon një gjë të tillë. Nga intervista me pedagogët dhe studentët u pohua përdorimi i teknologjisë në lidhje me disiplinat kontabile dhe të taksimit. Në gjykimin e GVJ, teknologjia e informacionit mund të përdoret në të gjitha lëndët e të dyja programeve të aplikuara për akreditim. Lëndët e lëvruara ofrojnë një harmoni të mirë sa i përket familjes së cilës i përkasin (sociale, ekzakte, komunikim, etj). Lidhur me përdorimin e gjuhës së huaj, konstatohet nga dokumentacioni i depozituar se ofrohet literaturë e rekomanduar në gjuhë të huaj. Gjithashtu, nga intervistat me stafin drejtues të institucionit pohohet se lëvrohen edhe tema të veçanta nga profesorë të huaj, ndonëse në tabelën 20, fq. 19 të aneksit mbi tabelat përmbledhëse shkruhet se numri i leksioneve/seminareve me profesorë të huaj në vitet e fundit (pas specifikuar konkretisht periudhën) është 0 (zero).
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Nga takimi me pedagogët u pohua se syllabusi lëvrohet në masën 100% tek studentët. Nga takimi me studentët, ky pohim u konfirmua në masën 80%, pra jo i gjithë syllabusi shterrohet në auditor, por niveli minimal i tij, në varësisë të ecurisë së grupit, është afërsisht 80%. Gjithashtu, në syllabuset e përfshura në programet e aplikuara për akreditim, konstatohet vlerësimi me detyra kursi, të cilat nëse kryhen siç duhet, ballafaqojnë kompetencat dhe aftësitë e fituara me aplikimin e tyre në praktikë.
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	Nga konsultimi me aneksin 20, të gjitha syllabuset e depozituara në ASCAL përmbajnë një temë të posaçme (zakonisht temën e fundit të lëndës) për përsëritjen e njohurive dhe orientimin për provimin përfundimtar. Nga takimi me studentët u konfirmua vlefshmëria e një orientimi të tillë.

<p>Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Nga syllabuset e konsultuara, nga takimet me pedagogët dhe studentët, sikurse edhe inspektimi i infrastrukturës teknologjike të institucionit konfirmohet aplikimi i leksioneve të hapura, fizike dhe/ose virtuale për zhvillimet e reja në disiplina të caktuara. Gjithsesi, këto leksione nuk zhvilloheshin jashtë strukturës së programit, por ishin pjesë integrale e tij.</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Nga syllabuset e konsultuara, nga takimet me pedagogët dhe studentët, sikurse edhe inspektimi i infrastrukturës teknologjike të institucionit konfirmohet aplikimi i njohurive në laboratorë dhe praktika profesionale, për aq sa e lejojnë disiplinat e parashikuara për t’u lëvruar. Gjithashtu, stafi akademik i KUB për këto dy programe, përbëhet nga profesionistë të fushave përkatëse, një garanci më tepër kjo se mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash.</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Nga takimet me pedagogët dhe studentët, sikurse detajimi i vlerësimit vjetor në syllabuse, konstatohet aplikimi i punës në grup dhe mbështetja e tij me staf pedagogjik dhe infrastrukturë kompjuterike.</p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p> <p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Programet e marra në shqyrtim nga GVJ i përkasin nivelit “Master Profesional”. Si i tillë, studimet e avancuara kërkimore-shkencore janë më tepër <i>domain</i> i programeve për mastera shkencorë sesa atyre profesionalë. Gjithsesi, nisur edhe nga zhvillimi ekonomik në Shqipëri, pjesa e tregut që mbart KUB në tregun e arsimit të lartë dhe segmenti i studentëve që synon, GVJ konstaton se idetë novatore mund të gjejnë mbështetje akademike, profesionale dhe financiare në një masë modeste nga institucioni.</p> <p>Nga konsultimi me aneksin 37 (urdhër për konkurset studentore në KUB) konstatohet se institucioni ka tentuar të organizojë në vitin 2019 (semestri I) dy konkurse: një letrar-artistik dhe një i titulluar “Kërkimi im”, por pa specifikuar fushën e konkursit. Ndonëse KUB ka dy fakultete në përbërje të tij, atë të ekonomisë dhe drejtësisë (statuti institucional, neni 10) është e paqartë se pse institucioni organizon konkurse letrar-artistike, të cilat promovojnë aftësi jashtë misionit institucional. Gjithsesi, nga takimi me studentë u pohua se vetë ata nuk kishin marrë pjesë në aktivitete të tilla, por kishin dijeni që ishin organizuar. Në dosjen e ASCAL nuk u gjetën nga GVJ dokumente që vërtetonin kryerjen me sukses të këtyre aktiviteteve dhe shpërndarjen e çmimeve që parashikoheshin për fituesit, si formë e mbështetjes financiare.</p>

<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Për këtë kriter, GVJ iu referuan, përveç anekseve të mësipërme, edhe aneksit 46 (mobiliteti Erasmus), aneksit 34 & 38 (marrëveshjeve me institucionet homologe), sikurse edhe intervistave me studentë. Nga dokumentacioni i konsultuar vërehet se KUB ka marrëveshje të shumta. Studentët, në intervistat me ta, u shprehën se janë në dijeni të studentëve të tjerë që kanë përfituar shkëmbim eksperiencash, duke vizituar institucione të huaja akademike, por asnjë prej tyre nuk kishte përfituar direkt nga ky mobilitet. Nga të dhënat e tabelës 20, fq. 19 në aneksin e tabelave përmbledhëse (dok. Nr. 4 në dosjen e ngarkuar në ASCAL për këtë program studimi) numri i mobilitetit të studentëve nga dhe prej programit të studimit në vitet e fundit (pa specifikuar konkretisht periudhën) është 0 (zero).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		<p>X</p>		

<p>Standardi III.8 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	<p>Nga vizita e mjediseve institucionale, sikurse edhe syllabuset e përmbajtura në aneksin 20 dhe konfirmimi prej intervistave me studentët, institucioni ofron mjedise shumë të mira laboratorike dhe ka marrëdhënie me disa kompani për kryerjen me sukses të praktikave profesionale.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 3. Praktikantët profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë</p>	<p>Nga konsultimi me aneksin 20 dhe anekse 15 & 16, takimet me pedagogë dhe studentë, sikurse edhe sekretarinë mësimore, konstatohet ekuivalentimi me kredite.</p>

studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Nga aneksi nr. 52 (model tip raport praktike mësimore) nuk mund të konkludohet me bindje të arsyeshme se procesi ezaurohet në praktikë, vetëm që ai parashihet shkresërisht në dokumentacionin institucional.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.9	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Për vlerësimin e këtij kriteri, GVJ iu referuan aneksit 18 (nenet 49 & 50), aneksit 20 (planit mësimor dhe kurrikulës) dhe vizitës në sekretarinë mësimore. Ndonëse RVB i është referuar Rregullores Institucionale (nenet 102-107) dhe rregulloreve të departamenteve përkatëse në plotësimin e këtij kriteri, GVJ nuk i gjeti këto dokumente në dosjen e ASCAL, as në kërkimet ekstra shkresore në prezencën online të institucionit në adresën http://kub.edu.al/ . Dokumentet e konsultuara parashikojnë hartimin e procedurës dhe bërjen publike të saj, por GVJ nuk iu vu në dispozicion një praktikë konkrete e realizimit të saj nga struktura e KUB.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Nga takimet me stafin akademik dhe studentët, sikurse inspektimi i infrastrukturës logjistike dhe akademike (bibliotekë fizike dhe virtuale), konstatohet se studentëve iu krijojnë të gjitha kushtet e nevojshme për një studim të mirëfilltë diplome/provimi përfundimtar dhe mbrojtje të suksesshme të saj/tij. Në dosjen në ASCAL, aneksin 33, ilustron një praktikë e orientimit të studentëve për mbrojtjen e diplomës në MPE.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri(! Masteri është 1-vjeçar) viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Nga aneksi 33 depozituar në ASCAL, i cili përmban një ilustrim të orientimit të studentëve për diplomim, nuk kuptohet mirë nëse bëhet fjalë për një tezë konkrete (mungon data, firmat e komisionit, nr. I protokollit, etj.) apo është një ilustrim për qëllime të depozitimit të dokumenteve të nevojshme për akreditim në ASCAL.
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të	Nga vizitat me studentët dhe pedagogët u konfirmua bashkëpunimi i ndërsjellë për mbrojtjen me sukses të diplomës.

studimit/diplomave.				
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.		Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi.		
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.		Nga intervistat me stafin dhe studentët, konstatohet potenciali dhe pohohet asistenca në këtë drejtim. KUB ka pedagogë që lidhin mjaft mirë teorinë me praktikën. Gjithsesi gjurma konkrete e një aistence të tillë mungoi. Edhe në raportin e RVB-së është e pamundur të gjurmohet referenca për plotësimin me sukses të këtij kriteri.		
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.		Nga dokumentet e konsultuara, sikurse nga inspektimi i regjistrave të studentëve në sekretarinë mësimore, kriteri përmbushet plotësisht.		
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.		Nga dokumentet e konsultuara, sikurse nga inspektimi i regjistrave të studentëve në sekretarinë mësimore, kriteri përmbushet plotësisht. Aneksi 39, ndër dokumentet e depozituara në ASCAL, ilustron modelin e diplomës dhe suplementin e saj që lëshohet nga institucioni. Ky model është në përputhje me kërkesat e ministrisë përgjegjëse për arsimin.		
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.		Nga dokumentet e konsultuara, sikurse nga inspektimi i regjistrave të studentëve në sekretarinë mësimore, kriteri përmbushet plotësisht.		
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.		Nga dokumentet e konsultuara, sikurse nga inspektimi i regjistrave të studentëve në sekretarinë mësimore, kriteri përmbushet plotësisht.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Nga konsultimi me aneksin 29, aneksin 20 dhe aneksin 40, sikurse dhe vizitën në zyrën e burimeve njerëzore pranë institucionit, GVJ konstaton se, nga përzgjedhja rastësore e dosjeve për anëtarët e stafit akademik, të dhënat për anëtarët e personelit akademik janë të plota dhe të përditësuara. Mbetet për t’u standartizuar formati i CV-ve, që u pohua se është në proces.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Nga konsultimi me aneksin 40 (kontratë tip pune), statutin e institucionit (faqja online e institucionit), si edhe duke iu referuar bazës ligjore e nënligjore në fuqi, GVJ konstaton se është cënuar Kodi i Punës në rekrutimin e stafit akademik, sikurse edhe baza nënligjore e Ministrisë përgjegjëse për arsimin. Konkretisht: a) Pjesa II, neni 4, pika 4 e Kontratës Tip të Punës për stafin akademik cilëson se: “Kohëzgjatja javore e punës është si rregull jo më pak se 40 orë”. Në Kodin e Punës, i ndryshuar, neni 83, specifikohet se kohëzgjatja normale e javës së punës është jo më shumë se 40 orë; b) Pjesa II, neni 4, pikat 2 dhe 3 cilësojnë se: “Kohëzgjatja e ditës së punës është normalisht 8 orë” dhe se “Java e punës është 6 ditë”. Të kombinuara, këto dy pika nënkuptojnë një ngarkesë javore pune në masën 48 orë, në kundërshtim me nenin 83 të sipërcituar. Nga intervistat me përgjegjësat e departamenteve (GVJ kërkoi takim me administratorin e IAL, si përfaqësues ekonomik i tij, por ky takim nuk u mundësua) u pohua se java e punës është parashikuar me 6 ditë për shkak se jo gjithnjë pedagogët shpenzojnë të plotë 8-orarëshin e ditës së punës dhe se çdo diferencë “orar i planifikuar në kontratë – orar i realizuar</p>

	<p>konkretisht” gjatë ditëve të punës, kompesohet ditën e shtunë, pa tejkalar 40 orarëshin e parashikuar me Kod Pune. b)Pjesa I, neni 2, pika 2 specifikon se ngarkesa mësimore vjetore është jo më pak se 350 orë fizike mësimore në auditor, pa detajuar mëtej specifikimet e mëtejshme sipas gradës së personelit akademik, ndonëse neni 46 i statutit institucional, pika 2 e tij thekson se normimi i ngarkesës mësimore dhe konvertimi i saj bëhet me urdhëra dhe udhëzime të Senatit Akademik, mbështetur në urdhërat dhe udhëzimet e ministrit përgjegjës për arsimin. Udhëzimi nr. 29, dt. 10.09.2018 i Ministrit përgjegjës për arsimin specifikon një maksimum prej 195 orësh në auditor, duke e detajuar sipas kategorive me bazë gradën shkencore. Është e vërtetë që Ligji 80/2015, neni 59, pika 8 e lë në dorë të IAL-së jopublike përcaktimin e ngarkesës mësimore vjetore dhe se udhëzimi nr. 29, njeh edhe 200-300 orë tejkallim ngarkese vjetore, por tejkallimi i ngarkesës ka lidhje me shpërblimin financiar të punonjësit akademik dhe motivimin e tij direkt në punë, jo vetëm për mësimdhënie, por edhe për kërkim-shkencor. E kombinuar me pikat 3 & 4 te po të njëjtit nen në kontratën tip të punës (<i>mosplotësimi i ngarkesës së specifikuar në kontratë ul të ardhurat epedagogut dhe se mbingarkesa deri në 20% nuk paguhet</i>), krijohet bindja e arsyeshme që rekrutimi i stafit akademik (më saktë hallka kontraktuese në procesin rekrutues) nuk kryhet në përputhje me bazën ligjore e nënligjore në fuqi dhe se aktet rregullatore të institucionit duhet të specifikojnë në mënyrë ligjërish shterruese marrëdhënien e punës dhe rrjedhimisht atë financiare për ngarkesën; c)Në Ligjin 80/2015 (neni 39, pika 5), sikurse në statutin institucional të KUB (neni 48) kontrata e punës për personelin akademik dhe ndihmës-akademik parashihet të nënshkruhet nga Rektori në cilësinë e punëdhënësit, ndërkohë që në aneksin 40 (kontrata tip e punës për personelin akademik) depozituar në ASCAL, nënshkrues është administratori i institucionit.</p>
<p>Kriteri 3 Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kriteret e posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Nga dokumentacioni i dosjes së depozituar në ASCAL nga ana e Institucionit është e pamundur të arrihet në një konkluzion për këtë kriter. GVJ iu drejtua në rrugë ekstra shkresore statutit institucional në Internet të KUB-it, konkretisht nenit 44 që parasheh procedurën e punësimit akademik dhe neneve 52 & 53 që parashikojnë punësimin e personelit ndihmës-akademik dhe administrativ. Të gjitha këto nene i referohen rregullores institucionale “Për marrëdhëniet e punës”, rregullore e cila nuk gjendet e depozituar në ASCAL dhe as në faqen online të institucionit. Pas takimit dhe vizitës në IAL (dt. 15.07.2020), ku GVJ i vunë në dukje përfaqësuesve të institucionit mangësitë me</p>

	dokumentet e depozituara, u premtua prej tyre plotësimi dhe korigjimi i dokumentacionit.			
Kriteri 4 Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Nga intervistat me pedagogët që lëvrojnë kurrikulën e programit të aplikuar për akreditim, konsultimin me aneksin 20 & 29 dhe tabelat përmbledhëse depozituar në ASCAL (dok. nr. rendor 4), sikurse dhe konsultimin me dosjet e stafit akademik në zyrën e burimeve njerëzore, procedura e rekrutimit sa i përket specifikimeve të kriterëve dhe përputhjes me vendin e synuar të punës, duket në përputhje me objektivat e institucionit dhe programin për të cilin kërkohet akreditim. Konkretisht, në përputhje me nenin 59, pika 6 e Ligjit 80/2015 dhe nenin 43, pika 5 e statutit institucional, të gjithë pedagogët e angazhuar në programin e aplikuar për akreditim mbajnë gradë minimalisht të ciklit pasardhës kundrejt programit ku janë angazhuar në mësimdhënie.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efikente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Duke iu referuar aneksit 11 (relacion teknik për mjediset dhe infrastrukturën e KUB), vizitës të mjedisëve fizike e virtuale, takimit me stafin dhe drejtuesit, konstatohet se mjedisi dhe mundësitë për kryerjen profesionale të detyrave janë mëse të mjaftueshme dhe në përputhje me bazën ligjore e nënligjore në fuqi (VKM 418, dt. 10.05.2017 dhe Udhëzimin nr. 1, dt. 14.01.2020). Të njëjtën gjë konfirmojnë edhe të dhënat e tabelave 16.1 dhe 16.2 në fqt. 16-18 të aneksit mbi tabelat përmbledhëse, ku janë kryer edhe përlllogaritjet përkatëse.
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Nga aneksi nr. 53, 55 dhe 62 është e pamundur të konkludohet se si e përmbush institucioni angazhimin e tij sa i përket kualifikimit të vazhdueshëm të stafit akademik që mbulon dhe administron programin e studimit. Konkretisht, aneksi 53 (analiza për FE-KUB 2018-2019) ka si rubrikë të tij nr. 4 (fq. 11) kërkimin shkencor për këtë viti akademik. Nga sa shihet në këtë rubrikë, nga 14 konferenca shkencore të renditura, 10 prej tyre i përkasin periudhës 2013-2016, pra pa lidhje me periudhën për të cilët raportohet aktualisht. 3 nga 4 konferencat e mbetura klasifikohen si konferenca studentore, pra me pak ose aspak ndikim në kualifikimin e mëtejshëm të stafit akademik. Në vijim të kësaj

	<p>rubrike përmenden formularët që plotësohen çdo vit nga pedagogët efektivë të KUB në fillim dhe në fund të vitit akademik. Formulari tip i këtij lloji është ilustruar në aneksin 12 të dokumenteve të depozituara në ASCAL, por as në platformën virtuale dhe as si aneks i analizës periodike të aktivitetit të FE-KUB nuk janë përfshirë formularët konkretë të plotësuar nga pedagogët efektivë të këtij fakulteti, ose të paktën të atyre që mbulojnë programet e studimit të aplikuara për akreditim. Në vijim të mëtejshëm të rubrikës 4 në aneksin 53 konstatohet se për të ardhmen parashihen promovime librash, leksione të hapura etj., një pjesë e të cilave të parashikuara për periudhën 2017-2018, ndërkohë që raporti është hartuar në shtator 2019. I njëjti dokumentacion (<i>copy-paste</i>) i rubrikës 4 së aneksit 53 gjendet edhe në aneksin nr. 43 (raporti vjetor institucional KUB 2018-2019), fq. 37-49.</p> <p>Nga tabela 19, fq. 19 e aneksit mbi tabelat përmbledhëse konstatohet se në vitet e fundit (pa u specifikuar konkretisht periudha) numri i botimeve të sftatit <i>full time</i> në KUB (në funksion të programit të studimit të aplikuar për akreditim) është 20, numri i projekteve të fituara 1 dhe numri i aktiviteteve shkencore të organizuara 4.</p> <p>Nga vizita e mjedisëve të fakultetit (biblioteka, akses online në artikuj, libra dhe softë aplikative) konstatohen investime të qenësishme për rritjen potenciale profesionale të personelit. GVJ kërkoi që pjesë e agjendës së takimeve të bëhej edhe administratori i institucionit, me synimin që të pyetj pikërisht se sa ishte buxheti i alokuar për kërkim shkencor, si ndahej ai sipas zërave dhe prioriteteve dhe në çfarë forme shpërndahej ai. Ky takim nuk u mundësua nga IAL.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Nga dokumentet e depozituara në ASCAL dhe vizitave në IAL, nuk konstatohet ekzistenca e programeve me këtë synim. Institucioni ka bërë investime në teknologjinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies, nisur dhe nga situata me pandeminë. Gjithashtu, në aneksin 53 për analizën e aktivitetit 2018-2019 përmenden edhe leksione të hapura mbi digjitalizimin e sistemit arsimor, por GVJ nuk gjeti gjurmë të miratimit apo implementimit të programeve specifike për metodat inovative. Në hartimin e RVB-së, GVJ të brendshëm të institucionit i është referuar aneksit 42 në dokumentacionin e ngarkuar në ASCAL. Ky aneks përmban vetëm kopertinën e dokumentit (1 faqe).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përbushjen e</p>	<p>Nga konsultimi me aneksin 20 & 29, sikurse edhe nga takimi me pedagogë dhe drejtues të institucionit, detyrimi ligjor për raportin 70/30 në përqindje i pedagogëve të brendshëm kundrejt atyre të jashtëm (cilësuar në VKM nr. 418, dt. 10.05.2017, pika 2, gërma</p>

objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	“b”, niveli “ii” dhe pohuar i plotësuar në raportin e RVB-së në fq. 5të tij) nuk plotësohet. Ky fakt u pohua nga dekani i FE-KUB, i cili e vlerësoi këtë raport në nivelin 60/40 në favor të pedagogëve të brendshëm të institucionit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Referuar aneksit 11, dhe bisedave me studentët, kriteri plotësohet në përputhje me kërkesat ligjore (VKM nr. 418, dt. 10.05.2017 dhe Udhëzimit nr. 1, dt. 14.01.2020 të titullarit të MASR) dhe madje tejkalohet. Në përputhje me risqet më të fundit të pozura nga tërmeti dhe pandemia, institucioni ka marrë masat e duhura antisizmike dhe distancimit fizik e higjienës së shtuar.
Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Referuar vizitës në IAL dhe njohurive specifike tëGVJ, kërkesat e këtij kriteri plotësohen dhe tejkalohen në terma absolutë dhe relativë nga institucioni kandidat për akreditim në këtë program. Infrastruktura hard dhe soft e institucionit është bashkëkohore, e licensuar konform ligjeve dhe në përputhje me nivelin e njohurive të stafit akademik e ndihmës akademik. U konstatuan një numër i mjaftueshëm kompjuterësh, projektorësh, sisteme audio dhe routerash për lidhje në Internet. Interneti në Ethernet dhe Ëi-Fi ishte funksional.
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave	Nga vizita në sallat e laboratoreve u konstatuan softe të licensuara për kryerjen me sukses të programit mësimor. Kompjuterët ishin të parametrave optimalë për nevojat e punës dhe mësimdhënies.

formues të programit të studimit në tërësi.									
Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.	Nga vizita, institucioni kishte dy laboratorë të pajisur më së miri në këtë drejtim, për programet për të cilat ka aplikuar për akreditim.								
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe institucione të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	Institucioni e shtrin aktivitetin e tij në dy godina, të cilat janë të pajisura me të gjitha hapësirat, aparaturat dhe dijen e nevojshme të stafit për t'i operuar ato në funksion të mësimdhënies, praktikave profesionale dhe çdo aktiviteti tjetër me natyrë akademike, profesionale e praktike.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Nga vizita e mjediseve të institucionit, konstatohet se KUB disponon dhe vë në dispozicion të studentëve 2 biblioteka mësimore brenda mjediseve të tij, sikurse edhe bibliotekën virtuale, me kredenciale personale të studentit për login.
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e	Gjatë vizitës në ambientet e bibliotekës, konstatohet se kërkesat e këtij kriteri për tipet e ndryshme të literaturës fizike përmbushen plotësisht. Problemi në këtë drejtim qëndron tek niveli i ulët i shfrytëzimit të tyre nga ana e studentëve, për shkak të numrit dhe interesit kërkimor e profesional.

të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.									
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Institucioni, sikurse është cituar vazhdimisht më lart, disponon dhe ofron akses online për studentët e tij në biblioteka virtuale, për të cilat paguan vetë, duke ua ofruar pa pagesë studentëve të programit të studimit.								
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Nga pikëpamja e infrastrukturës teknologjike, KUB është për t'u marrë shembull. Biblioteka është e pajisur me programe dhe pajisje të tjera që bëjnë të mundur shkarkimin, printimin, analizimin dhe raportimin apo dërgimin e informacioneve të nevojshme.								
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Nga dokumentet e konsultuara nuk identifikohet njëplan i tillë i detajuar, por aneksi 31 paraqet në formë tabelare një raport mbi përditësimet dhe periodiket në bibliotekë. Gjithashtu, në aneksin 45 (miratim buxheti nga Bordi i Administrimit për vitin 2019-'20) në pikën 9 përmendet miratimi i buxhetit për botimet studimore- kërkimore-shkencore për personelin akademik të KUB, por nuk specifikohet asgjë më tej në këtë drejtim.								
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	Nga intervistat me stafin akademik dhe administrativ, mësimi në KUB zhvillohet paradite dhe pasdite për ciklet e ndryshme të studimit. Në këtë mënyrë, kombinuar edhe me faktin që Bibliotekat nuk përdoren për mësimdhënie dhe KUB kishte salla me bollëk për leksione e seminiare, GVJ krijoi bindjen e arsyeshme se bibliotekat janë në dispozicion të studentëve në orare shërbimi të përshtatshme, në përputhje me nevojat dhe numrin e studentëve. Njëkohësisht, për shkak të disponimit të bibliotekës online, oraret e aksesimit të informacionit nga studentët janë fleksibël dhe çlirojnë kapacitetet për përdorimin optimal të mjediseve fizike të 2 bibliotekave.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni	Për vlerësimin e këtij kriteri, GVJ konsultuan kryesisht anekset

<p>disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>49, 55, 56, 57, 58 nga dokumentet e depozituara në ASCAL, statutin e institucionit nga faqja online e tij dhe vizitën në sekretarinë mësimore. Nga sa më lart rezultojnë se institucioni ka ngritur të gjitha strukturat e nevojshme menaxheriale të drejtimit akademik dhe administrativ në përputhje me Ligjin për arsimin e lartë dhe aktet e dala në zbatim të tij. Këto struktura administrojnë informacionin akademik i cili, nga konspektimi i regjistrit të studentëve, mbahet i plotë, me kujdes dhe në përputhje me proceverbalet e lëndëve përkatëse; sikurse administrojnë edhe informacionin administrativ, që përmban kontratën me studentin, numrin e matrikullimit dhe dokumente të tjera të natyrës administrative e financiare. Ruajtja dhe përditësimi i këtyre informacioneve bëhet manualisht dhe elektronikisht, në përputhje me kërkesat e Ligjit dhe statutin institucional.</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Nga konsultimi i dokumenteve të mësipërme dhe vizita në drejtorinë e burimeve njerëzore brenda institucionit konstatohet se menaxhimi i brendshëm mban një dokumentacion të plotë të stafit akademik dhe jo akademik, sikurse edhe pedagogëve të ftuar për realizimin e programit. Ky dokumentacion ruhet manualisht dhe elektronikisht, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga testimi që iu bë përgjatë vizitës sëGVJ aksesimit të informacionit dhe nivelit të këtij aksesimi, konstatohet se informacioni dhe dokumentet për studentët e stafin akademik të angazhuar në programet e studimit të aplikuar për akreditim, aksesohen sipas hierarkisë dhe funksioneve menaxheriale. Kështu, studentët kanë akses për pedagogët dhe anasjelltas në nivele akademike, ndërkohë që strukturat administrative kishin akses tek dy palët e mësipërme në lidhje me aspektet financiare dhe të tjera të natyrës administrative.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Nga vizita në institucion, meqënëse dokumentet e ngarkuara në ASCAL dhe ato të publikuara në faqen online të institucionit nuk ishin të disponueshme, GVJ konstatoi prezencën e platformave virtuale të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit, të përmirësuara edhe për shkak të kushteve të diktuar nga pandemia. Platformat ishin tëpersonalizuara sipas funksionit:veçmas për anën akademike dhe veçmas për atë administrative.</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton</p>	<p>Nga konsultimi me anekset 58, 59, 60 dhe 61 konstatohet se njësia e garantimit të cilësisëka përcaktuar procedura për të</p>

monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	monitoruar në kohë reale dhe vazhdimisht aktivitetin akademik. Nga dokumentet e ngarkuara në anekset e mësipërme nuk mund të nxirret një përfundim i saktë për frekuencën e kontrolleve dhe raportimeve, por nga bisedat me stafin akademik dhe studentët pohohet se ky proces është optimal. Sa i përket aspektit administrativ, insitucioni ka instaluar kamera dhe sisteme sigurie për të garantuar dhe raportuar në kohë mbi sigurinë dhe kujdesin e shërbimeve të ofruara. Mungoi takimi me administratorin për të kuptuar më tej mbarëvajtjen e monitorimit të proceseve administrative.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	Nga inspektimi i prezencës online të këtij institucioni në faqen e tij zyrtare në http://kub.edu.al/?lang=en , konstatohet se ky kriter përmbushet, ndonëse në disa raste përmbajtja e linqeve të caktuara vijon të mbetet në gjuhën shqipe, edhe pse gjuha e përzgjedhur është anglishtja.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Nga dokumentet e depozituara në ASCAL dhe duke ritheksuar se, kërkohet specifikisht takim me administratorin e institucionit, si përfaqësues i drejtimit ekonomiko-financiar të tij dhe ky takim nuk u mundësua nga IAL, është e pamundur të konkludohet mbi kërkesat e këtij kriteri. Grupi i ekspertëve të brendshëm që ka hartuar RVB-në përmend në vlerësimin e këtij kriteri bilance të institucionit, pasqyra të ardhura-shpenzimesh dhe pasqyra të kapitalit të pronarit, por pa cituar referencën konkrete ndaj tyre. E vetmja referencë është tabela në fq. 18 tek aneksi i tabelave përmbledhëse, e cila në fakt përmban vetëm të dhënat totale në përqindje se si janë gjeneruar fondet, pa dhënë asnjë shpjegim për kostot. I vetmi dokument ku konstatohet një vlerë financiare është kontrata me studentin (aneksi 51), që specifikon pagesën për këtë program. Në këto kushte, është e pamundur të vlerësohet objektivisht ky kriter.
Kriteri 2. Plani i financimit të	Sa më lart, nuk disponohet asnjë informacion relevant në këtë

<p>një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>drejtim.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Nga bisedat me dekanin e FE-KUB gjatë vizitës në institucion, pohohet se auditimi i KUB realizohet nga kompania “Grant Thornton”. Në asnjë dokument të depozituar në ASCAL apo rubrikë të RVB-së nuk gjenden informacione të mëtejshme për kërkesat e këtij kriteri.</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Sikurse më lart, nuk disponohet asnjë informacion mbi bazën e të cilit të konkludohet.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë</p>	<p>Nuk është ofruar asnjë informacion nga institucioni për të konkluduar mbi këtë aspekt.</p>

financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Nga konsultimi me anekset 15, 16, 18, 49, 55 dhe faqen online të institucionit, http://kub.edu.al/, konstatohet se janë hartuar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi: Statuti, Rregulloret, Plani Strategjik dhe dokumentet shkresore mbështetëse, sieder formularët e punës (template) për dizenjimin dhe monitorimin e politikave dhe procedurave.</p> <p>Gjurmët e zbatimit të këtyre politikave konfirmohen nga vizita në sekretarinë mësimore, sikurse edhe biseda me kampionin e studentëve.</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga konsultimi me dokumentet e cituar më lart, konstatohet se vlerësimi në aplikim, pranimi, mësimdhënia dhe diplomimi i studentëve në programin e aplikuar për akreditim kryhet mbi parimet e mosdiskriminit mbi çdo lloj karakteristike individuale, barazisë dhe të drejtave universale. Kriteri për pranim dhe diplomim i referohet meritës në arritjet universitare të ciklit paraardhës (pranim) dhe kryerjes së studimeve (diplomim).</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Referuar dokumenteve të sipërcituara, si edhe aneksit 20 mbi syllabuset (vlerësimi i dijeve të nxëna), aneksit 22 (model vendimi mbi ekuivalentim dhe transferim kreditesh) dhe aneksit 25 (rregullore e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve, ndonëse nuk gjendet dokumenti, por vetem kopertina e tij, sikurse edhe me disa rregullore te tjera të përmendura më lart në raport) krijohet bindja e arsyeshme se kriteret për këtë rubrikë janë lehtësisht të kuptueshme dhe aksesueshme nga publiku.</p> <p>Nga konsultimi me faqen online të institucionit, http://kub.edu.al/akademia/#1576583097649-4941ebe1-84b, përmbahet një informacion i shkurtër për transferimin e studimeve për të interesuarit, por kur klikohet linku “më shumë informacion”, faqja rikthehet në <i>home page</i>, duke mos dhënë më shumë informacion.</p> <p>Në hartimin e RVB-së, grupi i ekspertëve të brendshëm i është referuar edhe prezencës në rrjetet sociale të KUB për aksesimin e informacionit nga të interesuarit. Meqënëse segmenti i targetuar i klientelës së KUB është mosha e re, një praktikë e tillë është mjaft e dobishme. Nga konsultimi me këto faqe sociale: https://www.facebook.com/www.kub.edu.al, https://instagram.com/</p>

	<p>kolegjiuniversitar_i_biznesit?igshid=6nhc69794qej, https://www.linkedin.com/in/universitetibiznesit/, konstatohet se informacioni i ngarkuar është i plotë, i përditësuar dhe lehtësisht i kuptueshëm e i aksesueshëm.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>Nga dokumentet e depozituara në ASCAL konstatohet se nuk përmbahen materiale që dokumentojnë kërkesat e këtij kriteri. Në bazë të Ligjit 80/2015, Udhëzimeve të përvitshme të ministrit përgjegjës për arsimin, si edhe statutit institucional (nenit 59, pika 4) kriteret hartohen dhe propozohen nga njësitë bazë, miratohen nga Senati dhe i përcillen MASR-së dhe QSHA-së. IAL nuk ka kërkesa të veçanta, përveç kritereve të vendosura nga MASR.</p> <p>Nga konsultimi me prezencën në rrjetet sociale të institucionit, konstatohet se publikohen kriteret për pranimin në këtë kolegji, por gjithsesi, këto gjurmë nuk kanë rëndësinë e dokumenteve zyrtare.</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit</p>	<p>Nga konsultimi me aneksin 48 (politika e marketingut, që përsëri përmban vetëm kopertinën e dokumentit, por jo materialin e plotë), si edhe nënankset 48/1, 48/3 dhe 48/4, konstatohet se institucioni bën marketing të produkteve të tij lidhur me këto programe studimi, duke udhëzuar publikun. Në faqet e mësipërme sociale të institucionit, konstatohet një prezencë e mirë e udhëzimeve dhe orientimeve për të interesuarit.,</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi V.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Meqënëse ky program studimi parashihet të ezaurohet brenda një viti të vetëm akademik, kërkesat e këtij kriteri për avancim nga një vit në tjetrin nuk është e aplikueshme.</p> <p>Nga konsultimi me syllabuset e lëndës (aneksi 20), konstatohet se në rubrikën e vlerësimit të dijeve përmbahen të plota procedurat për përparimin akademik në vitin mësimor.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të</p>	<p>Referuar statutit dhe rregulloreve institucionale (për aq sa janë ngarkuar në ASCAL dhe aksesohen në faqen online të institucionit) informacioni në lidhje me kërkesat e këtij kriteri plotësohet tërësisht nga institucioni. Takimet me studentët e konfirmuan një fakt të tillë.</p>

pjesshme.									
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Ndonëse ky kriter është vetëm riformulim i kriterit 1 të po këtij standardi, përsërisim se nga konsultimi me aneksin 20, anekset 15, 16 dhe 20, si edhe takimi me pedagogë e studentë, konstatohet se studentët kanë plotësisht mundësinë të informohen mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të tyre. Informacioni është i publikuar dhe lehtësisht i aksesueshëm për këtë qëllim.								
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Nga dokumentacioni i ngarkuar në ASCAL, konsultimi me statutin në faqen online, sikurse edhe me paketën udhëzuese të diplomës po aty (ndonëse aksesimi i saj kërkon një llogari studenti në KUB dhe nuk aksesohet nga kushdo), si dhe takimet me pedagogë e studentë, konfirmohet përmbushja e kërkesave për informim të këtij kriteri nga ana e institucionit.								
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Nga konsultimi me prezencën online të institucionit (faqe zyrtare dhe rrjete sociale) konstatohet se institucioni në mënyrë sistematike dhe rigorozë organizon takime fizike dhe virtuale me të interesuar për studentë të ardhshëm, sikur harton broshura udhëzuese për kriteret, kushtet dhe avantazhet e regjistrimit në këtë IAL.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Nga konsultimi me anekset 15, 16, si dhe kryesisht aneksin 20, studentët kanë mundësinë të informohen hollësisht për detajet e programit të studimit të përzgjedhur. Nga takimi me studentët konfirmohet një informim i tillë paraprak.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë	Nga konsultimi me aneksin 20, konstatohet se syllabuset, kurrikula dhe plani mësimor përmbajnë në detaje informacionin për veprimtaritë akademike, praktike e profesionale të parashikuara.

formuese.									
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Nga aneksi 54 (raporti i punësimit të studentëve), aneksi 20 dhe zyra e karrierës, konstatohet se informacioni për kërkesat e këtij kriteri është i disponueshëm. Nga takimi me studentët konfirmohet informimi sipas kërkesave të të interesuarve. Përmes Zyrës së Këshillimit dhe Karrierës, studentëve iu jepet informacion mbi mundësitë e punësimit .								
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Nga takimet me studentët konfirmohet vënia në dispozicion e këtij informacioni në rrugë fizike dhe elektronike. Para fillimit të çdo semestri akademik, institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion të detajuar mbi organizimin dhe zhvillimin e procesit mësimor.								
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë	Nga takimi me stafin dhe studentët, u konstatua se, edhe për shkak të pandemisë, informacioni ishte lehtësisht i disponueshëm edhe në distancë, sikurse i gjurmueshëm nga të gjitha strukturat menaxheriale të përfshira (pedagogët për mësimdhënien, NjSBC për kontrollin dhe sekretaria e administrata për regjistrimin dhe raportimin)								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishtme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	Institucioni dhe njësitë përgjegjëse mbajnë statistika vjetore mbi numrin e studentëve aktualë dhe të diplomuar në Programin e studimit Master Profesional në Ekonomi. Nga vizita në sekretarinë mësimore, të dhënat për studentët që vijonin ndjekjen e programit të studimit, ishin të plota dhe të mbajtura me kujdes, si nga pikëpamja sasiore, ashtu edhe ajo cilësore.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe	Nga takimi me sekretarinë mësimore, sikurse referuar aneksit të tabelave përmbledhëse (dok. nr. 4 në materialet e depozituara në ASCAL), institucioni mban statistika të sakta dhe të plota në përmbushje të kërkesave të këtij kriteri, për numrin e studentëve të regjistruar në këtë program studimi, tërheqjet nga programi dhe largimi para përfundimit të programit, gjithashtu edhe për

largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	studentët të cilët nuk arrijnë të përfundojnë me sukses vitin akademik.			
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	Nga vizita në sekretarinë mësimore, inspektimi rastësor i regjistrit të studentëve, konstatohet se të dhënat për ecurinë akademike regjistrohen dhe ruhen korrektësisht. Këto të dhëna përputheshin me ecurinë e përmbajtur në procesverbal.			
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Nga vizita në sekretarinë mësimore dhe inspektimi me zgjedhje rastësore i të dhënave elektronike të studentëve, konstatohet ruajtja elektronike e të dhënave, aksesimi i tyre sipas hierarkisë dhe funksionit të personit të interesuar, si edhe siguria e tyre përmes platformave mbrojtëse (antivirus, firewall, etj).			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	Referuar tabelës 21, fq. 19, në aneksin e e tabelave përmbledhëse, sikurse edhe aneksit 53 (analiza e aktivitetit të FE-KUB, 2018-2019) konstatohet hartimi i analizave periodike në hyrje dhe në dalje të studentëve. Referuar aneksit 54 (punësimi i studentëve), konstatohet raportimi mbi punësimin e studentëve dhe përpjekjet për përmirësimin e treguesve të performancës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore	Ligji i arsimit të lartë e lë në tagër të vetë IAL-së (për IAL-të jopublike) modalitetin e angazhimit të studentëve në zgjedhjet dhe pjesëmarrjen e tyre në strukturat drejtuese të institucionit ku studiojnë. Nga statuti i KUB (shkëputur nga faqja online e institucionit) në nenin 17, pika 2, cilësohet se studentët përfaqësohen në senat me 1 anëtar. Ky anëtar vjen nga këshilli studentor, i cili në statut shtjelohet në nenin 73. Mënyra e

të vetë IAL-ve.	krijimit të këtij këshilli dhe rrjedhimisht mënyra e përzgjedhjes së anëtarit të këtij këshilli që do të përfaqësojë studentët në senat, shtjellohet, sipas statutit, në rregulloren institucionale. Sikurse është cituar më lart, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion në platformën e ASCAL, kjo rregullore nuk është ngarkuar. Gjithashtu, në 62 dokumentet e ngarkuar për këtë program, asnjë dokument nuk i referohet pjesëmarrjes së studentëve në organet vendim-marrëse. Rrjedhimisht është e pamundur të gjykohet mbi kërkesat e këtij kriteri.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Sikurse cituar më lart, mungesa e dokumentacionit e bën të pamundur konkludimin për kërkesat e këtij kriteri.
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesëshme të mëparshme.	Nga konsultimi me aneksin 20, si edhe intervistat me stafin pedagogjik dhe drejtuesit e institucionit, ngarkesa e parashikuar mësimore për studentët është normale. Edhe studentët e konfirmuan një fakt të tillë. Po kështu, duke iu referuar anekseve 22 dhe 25 që trajtojnë transferimet e studentëve dhe ekuivalentimin e dijeve të tyre, konstatohet se procedurat për transferim janë joburokratike dhe të mirëpritura.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Nga konsultimi me aneksin 20, sikurse bisedat me pedagogët që lëvrojnë lëndët, krijohet bindja e arsyeshme se hartimi, implementimi dhe përmirësimi i programeve të studimit është më tepër funksion i lëndëve që zhvillohen në universitete publike sesa produkt i bashkëpunimit me studentët, nevojat individuale të KUB dhe krijimit të një <i>niche</i> -je në tregun e arsimit të lartë e më tej të punësimit. Kjo është një praktikë e vëtëkuptueshme nisur nga numri i studentëve që studiojnë në këtë program dhe pjesën e tregut që zë institucioni në përthithjen e studentëve.
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe	Nga aneksi 56 dhe 58 konstatohet dokumenti tip dhe një ilustrim i vjeljes së mendimeve të studentëve për kërkesat e këtij kriteri. Nga bisedat me studentët konfirmohet që studenti gëzon të

ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	drejtën e shprehjes së mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të provimit. Çdo student ka të drejtën e ankimimit të rezultatit të provimit, rishikimit të tezës dhe reflektimit nga ana e njesisë dhe pedagogut përgjegjës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.6	
Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Në bazë të Ligjit 80/2015, krijimi i strukturave studentore për IAL-të jopublike parashihet në statutin institucional. Nga konsultimi online me këtë statut, konstatohet se nenet 73, 74 dhe 77 shprehen për krijimin e këshillave studentorë, zyrën e studentit dhe këshillimit të karrierës, si edhe sekretarisë mësimore, respektivisht. Nga dokumentacioni i depozituar në ASCAL, procedurat për shërbim dhe informim të studentëve konstatohen në anekset 15, 16, 18 dhe 49 që tjerin përmbajtjen e rregulloreve të programeve, FE-KUB dhe sekretarisë. Për zyrën e karrierës nuk disponohet informacion në dosjen ASCAL, por nga takimi me pedagogët dhe drejtuesit e institucionit pohohet verbalisht performanca e saj procedurale dhe rezultative. Nga vizita në mjediset e bibliotekave dhe asistencës logjistike me akses në Internet, fotokopje, etj., ishin funksionale.
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. .	Në ditët e sotme, ku informimi përmes rrjeteve sociale e bën të lehtë aksesimin e informacionit, kërkesat e këtij kriteri përmbushen lehtësisht. Kështu, KUB ka ngritur një rrjet Intra dhe Ekstra Net për informim, asistim dhe këshillim, si për procesin mësimor, ashtu edhe për aktivitete të tjera që organizohen nga institucioni.
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e	Sikurse cituar më lart, statuti parasheh ngritjen e kësaj zyre të karrierës, por nga dokumentacioni në ASCAL nuk disponohet një informacion i dedikuar për të. Një dokument i firmosur nga punonjësit e kësaj zyre në KUB (tutoriati dhe karriera) është

<p>karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>aneksi 54 që flet për raportin e punësimit të studentëve për vitet 2017-2018 dhe 2018-2019. Nga ky aneks nuk mund të konkludohet sasia dhe cilësia e me të cilën ZSKK orienton studentët në lidhje me praktikat profesionale dhe tregun e punës.</p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>Nga aneksi 54 më lart, referuar analizave të bëra, ZSKK ndjek studentët pas diplomimit, mban të dhëna mbi sasinë e punësimit të tyre, sikurse edhe për cilësinë (të punësuar në profesion ose jo) dhe ua vën në dispozicion të interesuarve në nivel studentit dhe drejtuesit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	
<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Në përputhje me Ligjin 80/2015 (neni 103), VKM nr. 531, dt. 11.09.2018 (Kodi i Cilësisë), statutin institucional (Kreu IX), si edhe duke iu referuar aneksit 55 (rregullorja e NjSBC-KUB) konstatohet se është ngritur struktura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë dhe janë parashikuar rregullat e procedurat për funksionimin e saj. Në planin strategjik institucional (versioni anglisht online) gjenden politika të përgjithshme lidhur me cilësinë.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Referuar anekseve 55-62 të cilat i referohen aktiviteteve të vazhdueshme të NjSBC-së konstatohen dokumentet tip për vjeljen e mendimeve të studentëve, raportet periodike mbi cilësinë dhe dokumentet tip të ushtrueshme mbi kontrollin e mësimdhënies, provimeve dhe kërkimit-shkencor. Nga dokumentet e depozituara nuk evidentohet një strategji e dedikuar për cilësinë, por, sikurse përmendur më lart, ajo është përkufizuar në mënyrë të përgjithshme në planin strategjik institucional. Rregullat për përfshirjen e studentëve dhe ekspertëve të jashtëm parashihen në statut dhe rregulloren e NjSBC-së.
Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	Nga dokumentet e përmbajtura në anekset 1-9 të dosjes ASCAL, sikurse edhe të anekseve 55-62, konstatohen procedurat e aplikuar për licensim dhe akreditim konform ligjit për arsimin e lartë, si edhe instrumentet operationale e taktike për garantimin e cilësisë. Nga aneksi 9 në veçanti konstatohen disa rekomandime për të dyja profilet e programit të aplikuar për akreditim, të cilat në një masë të konsiderueshme konvergojnë me gjetjet dhe konkluzionet edhe të këtij raporti.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek	Gjurmë të një politike të tillë, që normalisht i përket planit strategjik për cilësinë, nuk u gjetën në dokumentet e depozituara në ASCAL. Procedurat e ndjekjes dhe monitorimit periodik të

procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	cilësisë parashihen në rregulloren përkatëse të NjSBC dhe letrat e punës të hartuara për këtë qëllim. Përsa i përket evidentimit në kulturën institucionale të cilësisë, nga vizita në IAL konfirmohet niveli i mirë i saj në infrastrukturën logjistike, mbështetur në atë teknologjike dhe humane, niveli i kënaqshëm i saj në drejtimin akademik (literaturë, aplikim i teknologjisë në tema konkrete mësimore) dhe nivel nën mesataren sa i përket hartimit të dokumenteve strategjike. IAL kryen anketime dy herë në vit me studentët, gjithashtu bën edhe vizita gjatë orëve të mësimin.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.	Nga dokumentet e depozituara në ASCAL, specifikisht aneksi 55, neni 4, pika 1 e dokumentit të përmbajtur në të (rregullorja e NjSBC-së), konstatohet njësi përgjegjëse për përmbushjen e kërkesave të këtij kriteri, që është NjBSC.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	Nga konsultimi me anekset 57 dhe 61 (raporti për procesin mësimor 2018-2019 dhe fletë kontrolli për njehsimin dhe cilësinë e syllabuseve) konstatohen mekanizmat për vjeljen e informacionit mbi monitorimin periodik të syllabuseve. Gjithsesi, nga dokumenti tip i depozituar për vlerësimin e cilësisë së syllabuseve dhe raporti përkatës, nuk konstatohen gjurmë konkrete se si realizohet ky proces. Në aneksin 57 nuk përmbahen të dhëna për këqyrjen e cilësisë së syllabuseve, por vetëm të mësimdhënies nga ana e pedagogëve.
Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	Nga konsultimi me bazën dokumentare të depozituar në ASCAL nuk gjenden gjurmë të ndonjë metodologjie vlerësimi në këtë drejtim. Mënyra se si përpunohen të dhënat e NjBSC-së për matjen dhe vlerësimin përmes një sistemi vlerësimi të ecurisë së programeve të studimit nuk gjendet as në raportet periodike, siç është ai i përfshirë në aneksin 57. Konkretisht, 7 nga 8 pyetjet e drejtuara studentëve përmes pyetësorëve në të dy semestrat, përgjatë vitit akademik 2018-2019, vlerësojnë vetëm anën logjistike të mësimdhënies dhe vetëm njëra prej tyre (pyetja 3)

	vlerëson pjesërisht aspektin akademiko-profesional. Në vlerësimin tabelar të përmbledhur në fund nuk i janë dhënë peshat përkatëse pyetjeve dhe as nuk konkludohet me një parametër agregat kundrejt syllabusit specifik, por vetëm kundrejt pyetjes specifike. Gjithashtu, vlerësimet pikësore nuk shoqërohen me analiza, për një vlerësim kuptimor të asaj që është matur.			
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Nga konsultimi me dokumentet e sipërcituara, konstatohet se raportet e NjSBC i janë përcjellë Rektorit dhe Dekanit të institucionit. Drejtuesit kanë lënë gjurmë në dokument, duke dëshmuar se procesi i përcjelljes nuk është fiktiv.			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	Ng konsultimi me dokumentet e mësipërme, nuk gjenden gjurmë të analizave për të kuptuar mangësitë (atje ku ka) dhe identifikuar mënyra për t'i minimizuar apo shmangur ato. Në gjykimin e GVJ, procesi është rutinor dhe jo udhëheqës në ndërtimin e strategjive dhe planeve për të kuptuar dobësitë dhe rritur shanset për sukses.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Nga shqyrtimi i dokumenteve të përmendura në standartin më lart, vlerësimi nga NjSBC konstatohet se kryhet në mënyrë periodike (për çdo semestër gjatë vitit akademik 2018-2019, sikurse shfaqet në aneksin 57). Ky vlerësim është përfshirë në bazën dokumentare të depozituar për akreditim në ASCAL, sikurse i është përcjellë dhe strukturave drejtuese për vetë-vlerësim institucional. Gjithashtu, vetë-vlerësimet periodike janë përfshirë si referenca edhe në RVB-në e përgatitur nga grupi i ekspertëve të brendshëm për programet e aplikuar për akreditim.
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të	Për kryerjen e vlerësimeve, institucioni ndërthur disa metoda të niveleve të ndryshme. Konkretisht në nivel operacional: pyetësorë për studentët, inspektime dhe kontrole të befashme

<p>ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>për mësimdhënien dhe testimin e studentëve; në nivel taktik: raportime tek drejtuesit, masa penalizuese dhe përshkallëzuese për shkelje të ndryshme, trajnime; në nivel strategjik: akreditime periodike.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacionin e ngarkuar në ASCAL, sikurse edhe nga takimet me stafin pedagogjik e studentët, konfirmohet vlerësimi i vazhdueshëm dhe periodik, direkt, për kërkesat e përmbajtura në këtë kriter. Sikurse theksuar më lart, procesi vlerësues, sikurse raportohet në dokumentet e depozituara në ASCAL, fokuson më së shumti aspektin logjistik, sesa atë akademiko-profesional. Nisur nga kushtet e arsimit të lartë, pjesa e tregut që zë KUB në këtë arsim dhe lloji i programeve të aplikuara për akreditim, një fokusim i tillë në procesin vlerësues është i kuptueshëm.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga</p>	<p>Sikurse theksuar në kriterin 2 më lart, institucioni përdor pyetësorë e anketime për vjeljen e mendimeve të stafit akademik dhe të studentëve, sa i përket vlerësimit të dijeve dhe kompetencave të përfituara nga programi. Lidhur me punëdhënësit dhe institucionet e tjera, nga dokumentacioni i depozituar në ASCAL, nuk konstatohen sondazhe të kësaj natyre.</p>

ky program.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Kriteri 1 dhe 2 i standartit VI.1 më lart specifikojnë kërkesat për ekzistencën e politikave, procedurave dhe strukturave që do të dizenojnë dhe implementojmë garantimin e cilësisë. Konkretisht: Në përputhje me Ligjin 80/2015 (neni 103), VKM nr. 531, dt. 11.09.2018 (Kodi i Cilësisë), statutin institucional (Kreu IX), si edhe duke iu referuar aneksit 55 (rregullorja e NjSBC-KUB) konstatohet se është ngritur struktura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë dhe janë parashikuar rregullat e procedurat për funksionimin e saj. Në planin strategjik institucional (versioni anglisht online) gjenden politika të përgjithshme lidhur me cilësinë. Referuar anekseve 55-62 të cilat i referohen aktiviteteve të vazhdueshme të NjSBC-së konstatohen dokumentet tip për vjeljen e mendimeve të studentëve, raportet periodike mbi cilësinë dhe dokumentet tip të ushtrueshme mbi kontrollin e mësimdhënies, provimeve dhe kërkimit-shkencor. Nga dokumentet e depozituara nuk evidentohet një strategji e dedikuar për cilësinë, por, sikurse përmendur më lart, ajo është përkufizuar në mënyrë të përgjithshme në planin strategjik institucional. Rregullat për përfshirjen e studentëve dhe ekspertëve të jashtëm parashihen në statut dhe rregulloren e NjSBC-së.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Në nenin 2, gërma “c” të rregullores nr. 07, dt. 26.11.2018, përmbajtur në aneksin 55 të dokumenteve të depozituara, cilësohet përbërja e NjSBC-së, ku përfshihen pedagogët, një student dhe një ekspert i jashtëm, në total 5. Nenet 3 dhe 4 të këtij dokumenti detajojnë përgjegjësitë në grup dhe individuale të kësaj njësie. Nga konsultimi i aneksit 57 që përmban raportin periodik të kësaj strukture, cilësohet në faqen 1, se NjSBC përbëhet nga 7 anëtarë, ku identifikohet një anëtar student, por jo eksperti i jashtëm (nuk cilësohet). Nga fakti që raporti i është përcjellë strukturave më të larta drejtuese të institucionit, mund të dilet në</p>

	konkluzionin se puna e kësaj njësie kryhet me përgjegjësi, për të shmangur gabimet në vendim-marrje.			
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.	Në përputhje me Ligjin për arsimin e lartë dhe statutin institucional, NJSBC perbehet nga: <ol style="list-style-type: none"> 1. Kryetari, i cili është nga FE 2. Zv. Kryetari nga Fakulteti i Drejtësisë 3. Një anëtar nga FE (ndihmës akademik) dhe Përgjegjës i Marrëdhënieve me Publikun në KUB 4. 2 Anëtarë nga Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale 5. 1 anëtar përfaqësues i studentëve. 			
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimin duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Nga takimet me studentët, pedagogët, sikurse edhe me përfaqësues të NJSBC dhe drejtues të institucionit, nuk u konstatuan ankesa apo raportime në këtë drejtim. Njëkohësisht, nga baza dokumentare e depozituar nuk konstatohen elementë që të krijojnë dyshime për trajtim diskriminues në përfshirje dhe aktivizim sa i përket proceseve periodike vlerësuese. NJSBC synon dhe mbikëqyr arritjet e standardeve, në bashkëpunim me të gjitha hallkat përgjegjëse të IAL-së, duke patur në fokus studentin.			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimin dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vryera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	Sikurse theksuar më lart në kriterin 2, NJSBC e ka të përcaktuar në statut (neni 82) dhe rregulloren e saj, pjesëmarrjen e një eksperti të jashtëm, nga 5 në total të parashikuar. Nga i vetmi raport i depozituar (aneksi 57) është e pamundur të identifikohet cili është eksperti i jashtëm, ndër 7 anëtarët e paraqitur si anëtarë të NJSBC. Nga kryqëzimi i të dhënave me dokumentet e depozituara nëASCAL (tabela e stafit të brendshëm të institucionit) konstatohet se 2 (dy) anëtarë të NJSBC-së, sikurse përmbahen në aneksin 57, nuk janë punonjës si staf akademik i brendshëm.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për	Nga konsultimi me prezencën online të institucionit, konstatohet se NJSBC ka një faqe të dedikuar për të, ku janë pasqyruar në mënyrë transparente raportet e sigurimit të cilësisë ndër vite. Në

programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	këtë hapësirë virtuale nuk gjenden dokumente të strategjive dhe politikave në këtë drejtim. Edhe nga dokumentet e depozituara në ASCAL mungon një plan strategjik i mirëfilltë për cilësinë, por elementë të rregullimit të saj gjenden në statut, plan strategjik institucional dhe rregulloren e NjSBC-së.			
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Nga raportet e publikuara online, konfirmohet paraqitja konform kërkesave të këtij kriteri e informacionit për vlerësimet e programeve të studimit.			
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Nga dokumentet e depozituara, sikurse edhe nga inspektimi online i raporteve, mungon analiza dhe plani i masave për korrektimin e të metave dhe plotësimin e mangësive.			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Në mungesë të një analize të thelluar dhe plani respektiv masash, nuk mund të sigurohet efektiviteti dhe impakti për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk gjenden gjurmë të veprimtarive të tilla.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në
“Ekonomi” me dy profile: “Kontabilitet Financë” dhe “Menaxhim Biznesi” i Institucionit të
Arsimit të Lartë Kolegji Universitar “I Biznesit”**

Pikat e forta dhe afirmime

1. Për programin e studimit laboratorit është i pajisur me infrastrukturën e nevojshme.
2. Numri i marrëveshjeve dhe bashkëpunimeve që ka institucioni janë të përshtatshme dhe ndihmojnë në mbarëvajtjen e këtij program studimi.

Pika të dobta

1. Ngarkesa mësimore mbulohet nga stafi PAE në masën 62%
2. Nuk ka një studim të mirëfilltë tregu për programin e studimit, për të kuptuar saktë pozicionin e tij dhe rrjedhimisht përgatitur e implementuar një vizion në linjë me kushtet aktuale dhe të pritshme.
3. Nuk ka transparencë në planet e veta financiare për të mbështetur dhe përmirësuar programin e studimit.
4. Literatura e detyruar dhe e rekomanduar e parashikuar në syllabuset e lëndëve është e vjeter dhe e pa përditësuar me literaturë bashkëkohore.
5. Dokumentacioni i venë në dispozicion të GVJ për këtë program studimi nuk është i përditësuar dhe i sakte
6. Angazhimi i stafit akademik në kërkimin shkencor është i ulët
7. Mungesa e një plani masash për korektimin e të metave dhe plotësimin e mangësive për këtë program studimi.

Rekomandime

1. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që institucioni të rekrutojë staf akademik për këtë program studimi me qëllim mbulimin e ngarkesës në masën 70% nga PAE dhe si rrjedhojë rregullimin e raportit PAE/PAK në masën 70%
2. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon të bëhen studime tregu parësore (nga vetë institucioni) për të kuptuar konkurrencën, identifikuar avantazhet e disavantazhet dhe rritur shanset për sukses.
3. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon të rritet transparenca e planeve financiare dhe të përcaktohen prioritetet për alokim fondesh, në përputhje me prioritetet akademike dhe ato administrative.
4. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon të financohen me prioritet kërkimi shkencor, mësimdhënia nga pedagogët sipas ligjeve në fuqi dhe përditësimi i literaturës së detyrueshme dhe asaj të rekomanduar.
5. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon të përmirësohet dhe saktësohet dokumentacioni rregullues për këtë program studimi.
6. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon të hartohet një plan masash për korektimin e të metave dhe plotësimin e mangësive për këtë program studimi.

**Conclusions of the Evaluation of the second cycle study program Professional Master in
“Economy” with two profiles: “Finance Accounting” and “Business Management”, of High
Education Institution Kolegji Universitar “I Biznesit”**

Strengths and affirmations

1. The laboratories for this study programme are very well equipped.
2. The quantity and quality of agreements and collaborations are adequate and add value in accomplishing the objectives of this study programme.

Weaknesses

1. The lecturing positions are fulfilled by internal academic staff at a rate of approximately 63% of the whole.
2. There is no proper market research regarding the needs of this study programme, in order to fully and correctly understand the niche this programme aims to fill and therefore to design and implement a vision in line with actual and forthcoming conditions.
3. There is a lack of transparency in financial planning as how this process assists and improves the study programme.
4. The recommended and optional academic literature, as prescribed by the respective syllabuses, is at some instances outdated and not fully suited to Albanian reality.
5. The documentation made available to the External Assessment Experts, regarding this study programme, was not up to date and sometimes lacking.
6. Academic staff engagement in scientific research is considered to be low.
7. There is a lack of corrective measures plan to identify and address the weaknesses of this study programme.

Recommendations

1. External Evaluatin Group recommends the institution should recruit more academic staff in order to properly cover the lecturing positions, as the bylaw explicitly states, at a minimum threshold of 70% internal academic staff.
2. External Evaluatin Group recommends the institution should carry out its own primary market research, so as to properly comprehend the competitors, identify its advantages and disadvantages and improve its chances for success.
3. External Evaluatin Group recommends more transparency on financial plans, as well as stating the priorities on funds allocation in line with academic and administrative objectives.
4. External Evaluatin Group recommends the research should be a priority when it comes to financing. Also, measures should be taken regarding the proper financial treatment of pedagogues and updating the academic literature.
5. External Evaluatin Group recommends that the documents supporting the regulatory processes should be corrected and improved.
6. External Evaluatin Group recommends that should draft and approve a corrective measures plan to address the deficiencies of this study programme.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT		X		
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X	
VLERËSIMI TËRËSOR			X	